


REPUBLIKA E SHQIPĒRISË
KRYEMINISTRIA
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 590 prot.

Tiranë, më 29. 1 2021

U R D H Ë R

Nr. 3, datë 29.01.2021.

PËR

MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR
PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK

Në mbështetje të neneve 9, pika 2, dhe 27, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 20, të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit, për zbatimin e këtij udhëzuesi, gjatë procesit të konsultimit publik të projektligjeve dhe të projekteve të dokumenteve strategjike.
3. Ngarkohen Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, në bashkëpunim me Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë në Kryeministri, të koordinojnë dhe të monitorojnë zbatimin e udhëzuesit, për të siguruar qasje të harmonizuar në të gjitha fazat e procesit të konsultimit publik, në përputhje me procedurat dhe afatet kohore të përcaktuara në udhëzues.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Engjëll AGACI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

**UDHËZUES
PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK**

Janar 2021

Tabela e përbajtjes

<u>HYRJE</u>	4
<u>SHTYLLAT DHE PARIMET THEMELORE TË KONSULTIMIT PUBLIK.....</u>	4
SHTYLLAT THEMELORE TË EFEKTIVITETIT TË KONSULTIMIT PUBLIK.....	4
PARIMET THEMELORE TË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK	6
<u>ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I KONSULTIMIT PUBLIK</u>	7
PËRGJEGJËSITË E MINISTRIVE DHE ORGANEVE TË TJERA PUBLIKE	7
MBIKËQYRJA DHE MBËSHTETJA E PËRGJITHSHME	7
MEKANIZMI DHE KOORDINIMI PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK	8
HAPAT KRYESORË NË PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK.....	8
<u>PËRGATITJA E PLANIT VJETOR TË KONSULTIMEVE PUBLIKE NGA INSTITUCIONET</u>	10
RËNDËSIA E PLANIFIKIMIT VJETOR TË KONSULTIMEVE PUBLIKE.....	10
PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT VJETOR TË AKTEVE PËR KONSULTIM PUBLIK.....	10
KRITERET PËR PËRFSHIRJEN E AKTEVE NË PLANIN VJETOR TË KONSULTIMEVE PUBLIKE.....	12
<u>PLANI I KONSULTIMEVE INDIVIDUALE PËR PROJEKTAKTET</u>	13
PËRCAKTIMI I AFATIT KOHOR	13
IDENTIFIKIMI I AKTORËVE KRYESORË	14
PËRZGJEDHJA E METODAVE	16
SIGURIMI I BURIMEVE TË NEVOJSHME	19
IDENTIFIKIMI I MËNYRËS SË MBLEDHJES SË PËRGJIGJEVE	19
PARASHIKIMI I MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT.....	19
<u>PËRGATITJA E SHËNIMIT SHPJEGUES PËR KOSULTIMIN PUBLIK.....</u>	20
<u>FILLIMI I KONSULTIMEVE</u>	21
<u>MBLEDHJA DNE ANALIZA E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE</u>	22
<u>RAPORTIMI MBI REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTAKTET</u>	23
PROCESI I PËRGATITJES SË RAPORTIT INDIVIDUAL TË KONSULTIMIT PUBLIK.....	25
<u>VLERËSIMI I PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK.....</u>	27

PËRGATITJA E RAPORTIT (GJASHTË-MUJOR) VJETOR TË MINISTRIVE/INSTITUCIONEVE QENDRORE NE VARESI TE KRYEMINISTRIT	27
PROCESI I PËRGATITJES SË RAPORTIT (GJASHTË-MUJOR) VJETOR TË MINISTRIVE/ INSTITUCIONEVE QENDRORE NE VARESI TE KRYEMINISTRIT PËR KONSULTIMET	28
FORMATI I RAPORTEVE GJASHTË-MUJORE DHE VJETORE TË MINISTRIVE/ INSTITUCIONEVE QENDRORE NE VARESI TE KRYEMINISTRIT PËR KONSULTIMET	29
PËRGATITJA E RAPORTIT PERFORMANCES (GJASHTË-MUJOR) VJETOR TË QEVERISË QENDRORE PËR KONSULTIMET PUBLIKE	31
PROCESI I PËRGATITJES SË RAPORTIT VJETOR TË PERFORMANCES PËR KONSULTIMET PUBLIKE	31
STRUKTURA E RAPORTIT VJETOR TË PERFORMANCESPËR KONSULTIMET PUBLIKE	33
TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCES PËR MONITORIMIN E PROGRESIT NË ZBATIMIN E STANDARDEVE TË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK.....	33
SHTOJCA	36
SHTOJCA 1: UDHËZUES PËR PËRGATITJEN E PLANIT VJETOR TË KONSULTIMEVE PUBLIKE.....	36
SHTOJCA 2: MODELI I PLANIT TË KONSULTIMIT INDIVIDUAL PËR PROJEKTAKTET.....	43
SHTOJCA 3: MODEL PËR BAZËN E TË DHËNAVE TË PALËVE TË INTERESIT/EKSPERTËVE	45
SHTOJCA 4: MODELI PËR SHËNIMIN SHPJEGUES TË DOKUMENTIT TË KONSULTIMIT PËR SHPALLJEN E PROJEKT-AKTEVE. 46	
SHTOJCA 5: UDHËZUES PËR MINISTRITË PËR PËRGATITJEN E RAPORTIT (GJASHTË-MUJOR) VJETOR SEKTORIAL PËR KONSULTIMET PUBLIKE.....	48
SHTOJCA 5A: STRUKTURA E PJSËS NARRATIVE TË RAPORTIT (GJASHTË-MUJOR) VJETOR PËR KONSULTIMET E KRYERA PUBLIKE TË MINISTRIVE/ INSTITUCIONEVE QENDRORE NE VVARESI TE KRYEMINISTRIT.....	56
SHTOJCA 5B: PASQYRË E TABELËS SË RAPORTIT (GJASHTË-MUJOR) VJETOR TË MINISTRIVE PËR KONSULTIMET PUBLIKE	58
SHTOJCA 5C: TABELA E PIKËVE- INDEKSI I CILËSISË SË PERFORMANCES INSTITUCIONALE NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT E LIGJIT PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK	60
SHTOJCA 5D: STRUKTURA E RAPORTIT PËR REZULTATET E KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKTAKTET E MINISTRIVE/INSTITUCIONEVE QENDRORE NE VARESI TE KRYEMINISTRIT.....	61
SHTOJCA 6: UDHËZUES PËR PËRGATITJEN E RAPORTIT TË PERFORMANCES PËR KONSULTIMET PUBLIKE	62
SHTOJCA 6A: PASAPORTA E TREGUESVE PËR MONITORIMIN E PROGRESIT NË ZBATIMIN E STANDARDEVE TË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK.....	66

HYRJE

Objktivi kryesor i këtij dokumenti është të udhëzojë dhe mbështesë ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat, për të përgatitur, planifikuar, organizuar, kryer dhe raportuar për procesin e konsultimit publik të projektave legjislative dhe politikave.

Udhëzuesi ka gjithashtu, për qëllim të rrisë qartësinë dhe hapjen e procesit të konsultimit publik për grupet e interesit, komunitetin e biznesit dhe qytetarët, dhe t'i ndihmojë ata të kuptojnë se si planifikohen dhe zbatohen politikat qeveritare.

Procesi i konsultimeve publike në Shqipëri rregullohet nga ligji nr.146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", si dhe nga vendimi nr.584, datë 28.8.2003, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar. Në sektorë të caktuar konsultimi publik është i rregulluar shprehëmisht në ligje të veçanta gjithashtu. Në mars 2018 u miratuan rregullat përfshirjen e vlerësimit të ndikimit rregulator (VNR) në sistemin e politikëbërjes në Shqipëri dhe tashmë qeveria ka filluar zbatimin e tyre. Konsultimi publik dhe vlerësimi i ndikimit rregulator janë mjete të rëndësishme për politikëbërjen e bazuar në të dhëna.

Udhëzimi është hartuar në bazë të kuadrit ligor që rregullon konsultimin publik, si dhe praktikës së konsultimit publik për politikat publike në Shqipëri, dhe ofron modele dhe standarde përmirësimin e cilësisë dhe zbatimin e konsultimit publik.

Versioni fillestari i këtij Udhëzuesi është përgatitur nga SIGMA, e cila ka mbështetur edhe sistemin e vlerësimit të ndikimit rregulator në Shqipëri. Paketa e Udhëzuesit është rishikuar dhe zgjeruar në mënyrë thelbësore përmes aktiviteteve të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "Asistenca Teknike përmirësimin e kornizës rregullatore dhe konsultimin publik", gjatë të cilit nëpunës të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, kanë marrë pjesë në një numër aktivitetesh përgatitur e kapaciteteve për standarde konsultimeve publike dhe testimini e modeleve të reja për planifikimin dhe raportimin e rezultateve të konsultimeve publike. Ky Udhëzues pasqyron mësimet e nxjerra nga nëpunës të ministrive gjatë zbatimit të projektit të asistencës teknike të BE-së.

Udhëzuesi përmban standarde dhe parimet kryesore të konsultimit publik, procedurat dhe kornizën institucionale për koordinimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë së konsultimit publik, rregullat përfshirë mbledhjen dhe analizën e komenteve të marra, si dhe hartimin e raporteve vjetore (dhe gjashtëmuore) të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, mbi rezultatet e konsultimeve publike.

Ky Udhëzues është një instrument dinamik, i cili do të përdoret nga nëpunës të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, në punën e tyre të përditshme. Ai do të përditësohet sipas nevojës, në bazë të përvojave të mbledhura përgjatë komunikimeve të vazhdueshme me grupet e interesit në formimin dhe zbatimin e politikave publike.

SHTYLLAT DHE PARIMET THEMELORE TË KONSULTIMIT PUBLIK

Shtyllat themelore të efektivitetit të konsultimit publik

Konsultimi publik dhe bashkëpunimi me grupet e interesit hapin rrugën drejt rregullave të mira dhe vendimeve politike efektive, me cilësi të lartë në përbajtje, por edhe të përdorshme dhe të kuptueshme përfshirë njerëzit. Si rezultat, ato e bëjnë më të lehtë jetën e përditshme të qytetarëve dhe nuk kërkojnë ndryshime të shpeshta. Rregullat duhet të pasqyrojnë nevojat e shoqërisë dhe dinamikën e jetës. Vetëm nëse realizohen të dy segmentet, njerëzit janë të gatshëm t'i pranojnë dhe të bazojnë jetën e tyre në to.

Vendime të ndryshme mund të ndikojnë individët dhe komunitetet në mënyra të ndryshme, duke ndërhyrë në të drejtat e tyre dhe duke ndikuar në cilësinë e jetës. Kuptohet, kjo mund të çojë edhe në kundërshti, rezistencë ose refuzim. Bashkëpunimi me publikun në fazën e hershme të hartimit të rregullave mund të parandalojë konfliktet e mundshme në një fazë të mëvonshme në praktikë. Për më tepër, përfshirja e hershme është veçanërisht e nevojshme për të fituar argumente shtesë, qëndrime, mendime, informacione, si dhe reflektim kritik, i cili padyshim kontribuon në një cilësi më të mirë të rregullit.

Përfshirja e publikut nuk është një proces që duhet të drejtohet paralelisht ose i pavarur nga hapat e tjerë në hartimin e rregullave, të tillë si vlerësimi i situatës në fushën rregullatore, identifikimi i arsyeve për miratimin e rregullit, vendosja e objektivave dhe kërkimi i zgjidhjeve, si dhe përzgjedhja për alternativat e duhura, bazuar në gjykimin e thelluar të pasojave të tyre mjedisore, ekonomike dhe sociale, etj. Ajo ndërthuret ngushtë me të gjithë këto hapa. Ato kanë të përbashkët qëllimin për të fituar një rregull të mirëkonsideruar që gjëzon mbështetje të gjerë publike dhe që mund të zbatohet në mënyrë efektive, por edhe më shumë se kaq. Konsultimi me publikun shihet si një nga mjetet themelore për të arritur objektivat. Përpjekjet e deritanishme drejt hartimit të rregullave të hapura dhe gjithëpërfshirëse janë vetëm një pjesë e përpjekjeve të përgjithshme drejt politikëbërjes së bazuar në të dhëna, të cilat udhëhiqen sipas motos që qeveritë duhet të hartojnë politika që zgjidhin probleme, politika që shikojnë përpara dhe hartohen duke u bazuar në të dhëna, në vend të politikave që janë përgjigje ndaj presioneve afatshkurtra dhe politikave që trajtonë shkaqet dhe jo simptomat.

Përvoja tregon se zhvillimi i suksesshëm i pjesëmarrjes së publikut kërkon veprim përgjatë këtyre tre linjave:

- Standardizimi i procesit të konsultimit duke zhvilluar një kornizë rregullatore të thjeshtë, por gjithëpërfshirëse;
- Punë e qëndrueshme për forcimin e kulturës pjesëmarrëse së hartuesve të rregulloreve dhe vendimmarrësve (administrata publike dhe zyrtarët e zgjedhur);
- Fuqizimi i shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë kryesorë.

Vetëm një kombinim i të tre këtyre linjave çon në rezultate efektive. Së pari, standardizimi është një pjesë thelbësore që ndihmon hartuesit e ligjeve dhe politikave në planifikimin dhe zbatimin e proceseve në mënyrën më të përshtatshme dhe efektive. Ai ndihmon në orientimin e hartuesve të politikave duke e bërë punën e tyre shumë më të lehtë dhe me më pak kosto. Për më tepër, grupet e interesit dhe publiku i gjerë është i orientuar për atë që mund dhe duhet të pritet nga procesi i konsultimit. Kjo i ndihmon ata të përgatiten më mirë për procesin, dhe të kontribuojnë në cilësinë përfundimtare të rregullave që synohen të hartohen.

Së dyti, standartet dhe rregullat kanë kuptim vetëm kur ato ndiqen dhe respektohen. Forcimi i kulturës së pjesëmarrjes është të paktën po aq i rëndësishëm sa standardizimi. Mbi të gjitha, angazhimi i fortë për politikëbërje të hapur dhe gjithëpërfshirëse mund të ndihmojë në kompensimin e mangësive të mundshme të standardeve dhe rregullave, dhe më e rëndësishmja, hap rrugën drejt inovacionit. Prandaj, është me rëndësi të madhe për qeveritë që të promovojnë pjesëmarrjen civile në mënyrë sistematike, të mbështesin administratën duke forcuar kapacitetet e saj dhe duke i siguruar asaj burime të mjaftueshme. Gjithashtu, është e rëndësishme që qeveritë të bëjnë publike praktikat e mira dhe emrat e personave të angazhuar për realizimin e këtyre praktikave. Kjo ndihmon shumë për përqafimin e qasjeve proaktive dhe eksplorimin e mënyrave të reja për ndërveprimin me publikun.

Së treti, dialogu është më i suksesshëm kur pala tjetër është e kualifikuar dhe e përgatitur në mënyrë të përshtatshme. Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë jo vetëm që nuk

duhet të pengohet, por duhet të inkurajohet dhe mbështetet në mënyrë sistematike. Kjo përfshin investime të planifikuara dhe të qëndrueshme në forcimin e kapaciteteve të tyre në njojjen dhe kuptimin e politikës dhe avokimit.

Parimet themelore të procesit të konsultimit publik

Në mënyrë që procesi i konsultimeve publike të jetë i suksesshëm, ai duhet të bazohet në parimet kryesore vijuese:

Përfshirja në procesin e politikëbërjes. Procesi i konsultimit duhet të jetë pjesë e domosdoshme e ciklit të politikëbërjes. Ai duhet të harmonizohet plotësisht me procedurat dhe mjetet e tjera të përdorura gjatë zhvillimit të politikave. Angazhimi proaktiv i palëve të interesuara zgjeron mbledhjen e të dhënave, plotëson boshllëqet e këtyre të fundit dhe kontribuon në shqyrtimin dhe kuptimin më të mirë të përfitimeve dhe kostove të politikës së propozuar dhe ndërhyrjeve legjislative. Konsultimi publik duhet të jetë pjesë integrale e çdo vlerësimi të ndikimit rregulator dhe politikëbërjes së bazuar në të dhëna.

Efikasiteti dhe proporcionaliteti. Konsultimet publike duhet të planifikohen me kujdes në mënyrë që të sjellin vlerë të shtuar për rregullamë të mira. Duhet të tregohet kujdes i veçantë për një qasje të qëllimtë në këtë proces, d.m.th. për përgjedhjen e palëve të interesuara, kanaleve të informacionit dhe metodave të konsultimit sipas çështjes në fjalë dhe kompleksitetit të saj. Çështjet më komplekse kërkojnë një qasje më komplekse, më shumë kohë, larmi metodash dhe palësh të interesuara, ndërsa çështjet më pak komplekse mund të kërkojnë më pak kohë, larmi metodash apo palësh të interesuara.

Mosdiskriminimi dhe gjithëpërfshirja. Të gjithë zërat, përfshirë ato të disavantazhuarve dhe më pak të privilegjuarve, duhet të dëgjohen dhe të merren parasysh.

Transparenca, gjurmueshmëria dhe reagimi. Publiku duhet të informohet në lidhje me qëllimin e konsultimeve, tiparet kryesore të rregullave ose politikave të konsultuara. Publiku duhet të përfshihet në proces duke iu bërë të ditura mënyra e konsultimit, metodat e përdorura, afati i konsultimit, si dhe komentet e marra dhe qëndrimi institucional për komentet e publikut.

Duhet të kryhen në kohën e duhur. Duhet të ketë kohë të arsyeshme në dispozicion për shkëmbimin e informacionit, shqyrtimin e projektaktit dhe përgatitjen e komenteve dhe propozimeve. Proseset e konsultimit të realizuara brenda një kohe të shkurtër dhe hartimi i ligjeve në një kohë të shkurtër duhet të jenë përjashtim dhe të përdoren vetëm në rrethana të përcaktuara mirë.

Barazia gjinore dhe pjesëmarrja e barabartë e të gjitha grupeve, duke përfshirë ato me interesa dhe nevoja të veçanta, të tillë si: të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara ose pakicat.

Aksesi përmes përdorimit të një gjuhe të qartë dhe mjeteve të përshtatshme të pjesëmarrjes, në internet ose jo.

Proaktiviteti. Ndërsa konsultimet e efektshme publike ofrojnë ekspertizë të jashtme falas dhe mund të ndihmojnë në nxitjen e mbështetjes publike për legjislacionin që pritet të miratohet, vendimmarrësit duhet në mënyrë aktive t'i qasen grupeve të interesit dhe t'i ftojnë ato të marrin pjesë në proceset e konsultimit. Autoritetet publike duhet të nxisin pjesëmarrjen duke ofruar masa mbështetëse të llojeve të ndryshme për palët e interesuara me qëllim që ato të përfshihen në mënyrë aktive në proceset e konsultimit.

Qeverisja e Hapur. Promovimi i transparencës, mbështetja e pjesëmarrjes qytetare, shfrytëzimi i teknologjive të reja brenda dhe jashtë administratës publike për të mbështetur inovacionin.

ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I KONSULTIMIT PUBLIK

Përgjegjësitë e ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit

Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit që iniciojnë projektligje dhe projektakte normative, janë përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e konsultimit publik, në përputhje me rregullat dhe kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni dhe ky Udhëzues.

Çdo institucion ka një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik, i/e cili/a është përgjegjës/e për koordinimin e përgjithshëm të konsultimit të realizuar nga institucioni. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve për njoftimin dhe konsultimin publik janë si më poshtë:

- Shërbejnë si pika kryesore kontakti të institucionit përkatës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për konsultimin publik dhe udhëzimeve të përfshira në këtë Udhëzues;
- Përgatisin planin vjetor të konsultimit të institucionit duke konsultuar dhe konsoliduar planet e politikave të të gjithë strukturave të institucionit përkatës;
- Përgatisin raporte gjashtë-mujore dhe raportin vjetor për konsultimet e realizuara nga institucioni përkatës;
- Ofrojnë mbështetje për nëpunësit përgjegjës për zbatimin efektiv të proceseve të konsultimit publik (p.sh. përgatitja e planeve të konsultimit, përzgjedhja e metodave, identifikimi i palëve të interesuara, zhvillimi i dokumenteve të konsultimit, cilësia e raportimit për konsultimet për cdo akt etj.) me qëllim rritjen e efektivitetit dhe harmonizimin e këtyre proceseve brenda institucionit;
- Mbledhin dhe strukturojnë komentet e marra gjatë konsultimeve individuale;
- Publikojnë raportet e konsultimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP).

Mbikëqyrja dhe mbështetja e përgjithshme

Kryeministria ushtron funksionin e mbikëqyrjes dhe mbështetjes për proceset e konsultimeve publike. Ajo është përgjegjëse për:

- kontrollin e cilësisë (efektivitetin dhe efikasitetin e proceseve, shqyrtimin e komenteve dhe ndikimit të tyre në politikën ose aktin përkatës);
- mbikëqyrjen e proceseve (monitorimi i përputhshmërisë së proceseve këshillimore me legjislacionin, duke pasur edhe mundësinë e refuzimit ose të propozimit të refuzimit të projekt-raportit në rast të mosrespektimit të dispozitave të ligjit për konsultimin publik);
- përgatitjen dhe botimin e planeve vjetore të konsultimit të qeverisë në RENJKP duke mbledhur, koordinuar dhe konsoliduar planet vjetore të institucioneve;
- koordinimin e procesit (raportimi vjetor për mbarëvajtjen e procesit të konsultimit, identifikimi i përmirësimeve të nevojshme);
- mbështetjen profesionale për institucionet (ndërtimi i kapaciteteve dhe koordinimi i koordinatorëve për njoftimin dhe pjesëmarrjen duke mbështetur nëpunësit përgjegjës në institucionin publik, ofrimin e këshillave dhe mbështetjes konkrete për koordinatorët, ofrimin e trajnimeve); dhe

- promovimin e konsultimit dhe angazhimit të palëve të interesit në hartimin e politikave në përgjithësi (vënia në vëmendje të praktikave më të mira, promovimi i mekanizmave dhe metodave të ndryshme këshillimore, osei mekanizmave të ankimit).

Mekanizmi dhe koordinimi për procesin e konsultimit publik

Qeveria shqiptare ka aprovuar mekanizmin e qasjes së gjerësektoriale me urdhrin e Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018 “Për zbatimin e qasjes së gjerë (ndër) sektoriale dhe krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të integruar (ndër) sektorial”.

Urdhi mundëson riorganizimin dhe zbatimin e qasjes sektoriale në të gjithë sektorët (në krahasim me urdhrin e vitit 2015 të zbatuar në sektorët pilot), në mënyrë që të menaxhohen dhe koordinohen politikat sektoriale në përputhje me Sistemin e Integruar të Planifikimit (SPI), bazuar në parimet e mirëqeverisjes përmes menaxhimit sektorial dhe grupevetë koordinimit.

Procesi i konsultimit publik është pjesë e ciklit të politikëbërjes në përputhje me funksionet e Grupeve të menaxhimit të integruar të politikave/Komiteteve drejtuese të sektorit dhe Grupeve tematike.

Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS) u mundëson koordinatorëve/nëpunësve përgjegjës në ministri dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, të përgatisin raportin e konsultimit publik brenda modulit të veçantë IPSIS dhe përmes procesit të punës të përcaktuar në manualet përkatëse, të paraqesin raportin për miratim pranë niveleve të përcaktuara. Pasi raporti miratohet përmes IPSIS, ai mund të eksportohet dhe publikohet në RENJKP dhe t'u shpërndahet palëve të interesuara të interesit dhe publikut më të gjerë. Përveç sistemit të përbashkët të informacionit, Departamentet në Kryeministri gjithashtu, realizojnë takime të ndryshme koordinuese dhe aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve për ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit si mundësi shtesë për shkëmbimin e përvojave dhe sigurimin e shkëmbimit të rregullt të praktikave të mira dhe krijimin e një rrjeti të mbështetjes së ndërsjellë dhe komunikimit mes zbatuesve të procesit të konsultimit publik në ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

Hapat kryesorë në procesin e konsultimit publik

Duke marrë parasysh kuadrin aktual ligjor dhe institucional për konsultimet publike në Shqipëri, por edhe praktikat e mira përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane, hapat e mëposhtëm konsiderohen të jenë thelbësorë për të siguruar zbatimin efektiv të standardeve të procesit të konsultimit publik për projektet ligjore dhe politikat, si dhe sa i përket kontrollit efektiv qendor të cilësisë së konsultimeve publike:

Nr	Veprimi	Përgjegjësia
1	Përgatitja e planit vjetor të konsultimeve publike nga ministritë/ dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit	Projekt-raporti i përgatitur nga Ministria/dhe institucionet qëndrore në varësi të Kryeministrit dhe i dorëzuar tek Sekretari i Përgjithshëm për miratim

2	Përgatitja e planit individual të konsultimit për secilin akt në planin vjetor (përcaktimi i një afati kohor të saktë të aktiviteteve të konsultimit, identifikimi i palëve të interesuara, burimet e nevojshme, etj.)	Ministrinë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat
3	Përgatitja e dokumentit të konsultimit për secilin akt në planet vjetore (shtjellimi i qëllimit, kontekstidhe çështjeve kryesore për konsultim)	Ministrinë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat
4	Fillimi i konsultimeve publike përmes Regjistrat Elektronik dhe metodave të tjera të konsultimeve/aktiviteteve	Ministrinë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat
5	Mbledhja dhe analizimi i reagimeve/komenteve	Ministrinë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat
6	Përgatitja dhe shpërndarja e Raportit mbi Konsultimet Publike	Projekt-raporti i përgatitur nga Ministria dhe i dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm në Kryeministri
7	Vlerësimi i procesit	Ministrinë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat
8	Përgatitja e Raportit Vjetor Ministror mbi Konsultimet Publike të zhvilluara	Projekt-raporti i përgatitur nga Ministrinë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat dhe i dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave
9	Përgatitja e Raportit Vjetor të Performancës për Konsultimet Publike	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Departamenti Rregulator dhe i Përputhshmërisë, Kryeministria

Harta e procesit për konsultimin publik për secilin akt paraqitet si më poshtë:



PËRGATITJA E PLANIT VJETOR TË KONSULTIMEVE PUBLIKE NGA MINISTRITE DHE INSTITUCIONET QENDRORE NE VARESI TE KRYEMINISTRIT

Rëndësia e planifikimit vjetor të konsultimeve publike

Zhvillimi i një qasjeje të integruar për planifikimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike mbi projektaktet dhe politikat është një hap thelbesor në përmirësimin e transparencës, zhvillimit dhe koordinimit të politikave, si një nga parimet kryesore të reformës së administratës publike në procesin e pranimit në BE.

Me qëllim sigurimin e planifikimit në kohë të burimeve të përshtatshme dhe të nevojshme për zbatimin e konsultimeve publike, ministritë/dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit do të duhet të hartojnë një plan vjetor të akteve që do t'i nënshtronen konsultimit publik. Plani vjetor i akteve për konsultimin publik duhet të harmonizohet me Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve (vjetor), i cili ofron një përbledhje të akteve, përmes të cilave qeveria synon të zbatojë programin qeveritar, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, angazhimet e mëparshme ligjore kombëtare dhe ndërkombe të sektoriale dhe ndërsektoriale.

Duke marrë parasysh një numër sfidash në zbatimin e konsultimeve publike në përputhje me kërkesat e ligjit nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", si dhe performancën në lidhje me treguesit e cilësisë së konsultimeve publike si komponent i rëndësishëm i monitorimit të përgjithshëm të reformës së administratës publike, përgatitja në kohë e Planit Vjetor të Konsultimeve Publike mundëson koordinim më të mirë të punës brenda ministrite dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe mbështetje më efektive nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, në Kryeministri për zhvillimin e përgjithshëm të ligjeve dhe politikave me ndikim të rëndësishëm ekonomik, financiar, social dhe mjedisor.

Për më tepër, diskutimi mbi Planin Vjetor të Konsultimeve Publike, së bashku me Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve në forume konsultative të nivelit të lartë, siç janë Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave, Komitetet Drejtuese Sektoriale dhe Grupet Tematike, konsiderohet një vlerë e shtuar në procesin e përmirësimit të kapaciteteve për zhvillimin dhe bashkëpunimin e përgjithshëm të politikave, si parim themelor i reformës së administratës publike.

Me qëllim mbështetjen dhe forcimin e kapaciteteve për nëpunësit e administratës publike në zhvillimin e një Plani Vjetor të Konsultimeve Publike të konsoliduar, më poshtë paraqitet pëershkrimi i procesit të hartimit të planit vjetor, sqarimi i kriterieve përfshirjen e akteve në Plan, ndërsa të gjitha detajet mbi planin vjetor të konsultimeve dhe modeli përkatës paraqiten të detajuara në Shtojcën 1.

Procesi i hartimit të Planit Vjetor të Akteve për Konsultim Publik

1. Në përputhje me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave "Për hartimin e Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve", Programi i Përgjithshëm Analistik i Projektakteve shërben si bazë për hartimin e Planit Vjetor të Konsultimeve Publike.

2. Prandaj, pas miratimit të Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve nga Këshilli i Ministrave, brenda muajit janar të çdo viti, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, pritet të zhvillojnë planin vjetor të konsultimit, së bashku me planin e masave për kryerjen e procesit të vlerësimit të ndikimit rregulator. Pas paraqitjes së planeve vjetore të konsultimit nga të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje (DZHM) përgatit komente dhe sugjerime të mundshme për përmirësimin e planeve dhe i paraqet ato për mendim tek Departamenti Rregulator dhe i Përputhshmërisë (DRRP) në Kryeministri.
3. Pas përfshirjes së komenteve të DZHM dhe DRRP në Kryeministri, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit i dërgojnë versionet përfundimtare të planeve të konsultimit DZHM-së.
4. DZHM-ja përgatit versionin përfundimtar të konsoliduar të Planit Vjetor të konsultimeve publike që përfshin planet e konsultimit të të gjitha ministritëve dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe e dërgon atë zyrtarisht te të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit përmes një shkresë zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

Me qëllim sigurimin e përgatitjes së kohës dhe me efektivitet të konsultimeve publike, afati për përgatitjen e Planit Vjetor të Konsultimeve Publike është brenda 30 ditëve pune pas miratimit të Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve.

Gjatë vitit, në mënyrë periodike, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Departamenti Rregulator dhe i Përputhshmërisë, në Kryeministri orientojnë zbatimin e Planit Vjetor të Akteve për Konsultim Publik, duke marrë parasysh nevojën për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të procesit të konsultimit publik.

Më poshtë paraqitet një përbledhje hap pas hapi e procesit të hartimit të Planit Vjetor të Konsultimeve Publike nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit:

1. Pas miratimit të Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve nga Këshilli i Ministrave gjatë janarit të çdo viti, DZHM-ja u dërgon kërkesën të gjitha ministritëve dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit për të paraqitur planet vjetore të konsultimit, duke përdorur modelin në Shtojcën 1 të këtij Udhëzuesi.
2. DZHM-ja organizon një takim koordinues (ose sesion *on-line*) me përfaqësues të të gjitha ministritëve dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, anëtarë të rrjetit të koordinatorëve për konsultime publike, me qëllim që të sigurojë koordinim efektiv dhe në kohë nga të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit.
3. Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit përgatisin projekt-planet vjetore të konsultimit dhe i paraqesin ato pranë DZHM-së.
4. DZHM-ja ofron komente për hartimin e planeve vjetore dhe i paraqet ato në DPRRP-së përmendim.
5. Pas marrjes së mendimit nga DRRP-ja, DZHM-ja përcjell komentet tek ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit me kërkesën për të paraqitur versionet përfundimtare të planeve vjetore.
6. DZHM-ja miraton versionin përfundimtar të konsoliduar të Planit Vjetor të Konsultimit dhe i paraqet atë zyrtarisht tek ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

7. Plani vjetor i konsoliduar i Konsultimeve Publike i ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit publikohet në faqen përkatëse të internetit, si dhe në Regjistrin Elektronik për Njoftime dhe Konsultime Publike, në përputhje me standardet themelore të transparencës, hapjes dhe përfshirjes së procesit të zhvillimit të politikave.
8. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit për publikimin e versionit të konsoliduar të Planit Vjetor të Konsultimeve Publike në faqet përkatëse të internetit, si dhe Agjencia Kombëtare për Shoqerinë e Informacionit (AKSHI) për ta publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimeve Publike.

Kriteret përfshirjen e akteve në Planin Vjetor të Konsultimeve Publike

Gjatë procesit të përzgjedhjes së projektligjeve që do të përfshihen në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve, dhe me qëllim identifikimin e ligjeve, akteve nënligjore ose iniciativave strategjike politike që do të përfshihen në projekt-Planin Vjetor të Konsultimeve Publike, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, duhet të marrin parasysh kriteret e mëposhtme:

- detyrimet e marra në kuadër të Planit Kombëtar për Integrin Evropian;
- detyrimet që burojnë nga angazhime të ndryshme ligjore kombëtare dhe ndërkontinentale;
- detyrimet që rrjedhin nga masat e ndryshme të parashikuara në strategjite sektoriale dhe ndërsektoriale;
- dispozitat e ligjit nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", veçanërisht kufizimet përkatëse siç parashikohen në nenin 4 të ligjit;
- objektivat e përcaktuara në Programin e Qeverisë 2017-2021;
- përparësitë specifike të Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave;
- kërkesat nga grupe interesi që mund të shërbejnë si burim i rëndësishëm i informacionit përfshirë të interesit të lartë publik lidhur me iniciativa specifike legislative dhe të politikave.

Për të vlerësuar nëse një akt duhet të paraqitet përfshirës i konsultimit publik, është e nevojshme të merren parasysh si kriteret e përfshirjes, të renditura më poshtë:

Kriteret e përfshirjes, të përcaktuara si përfshirje në nenin 4 të ligjit:

- çështjet e sigurisë kombëtare, përfshirët që do ato përbëjnë një sekret shtetëror, sipas ligjit përfshirës i informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror";
- marrëveshje ndërkontinentale, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- aktet administrative individuale dhe aktet me karakter normativ, përvëçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;
- aktet normative me fuqinë e ligjit të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- çështje të emergjencave civile.

Kriteret e përfshirjes shërbejnë si bazë përfshirës i konsultimit publik (sipas nenit 1 të ligjit):

- ka grupe sociale/ekonomike që do të ndikohen nga politika e propozuar;
- ka organizata/grupe që do të përfshihen në zbatimin e politikës;
- ka organizata/subjekte që duhet të konsultohen në bazë të kërkesave ligjore përfshirës i posaçme të politikës;

- ka grupe me interesa/qëllime të lidhura drejtpërdrejt me politikën e propozuar;
- politika e propozuar prezanton detyrime/të drejta/përgjegjësi të reja për qytetarët ose personat juridikë;
- media tregon interes të lartë për çështjen e propozuar.

Kur vendoset se cili akt duhet të planifikohet për konsultim publike, përgjegjësia e ministritive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit është të përcaktojnë qartë se cilat kritere përjashtimi zbatohen, por edhe të vlerësojnë/testojnë aktin e propozuar sipas kritereve të përfshirjes, të cilat tregojnë ekzistencën e një interesit të lartë publik.

Modeli për Planin Vjetor të Konsultimeve Publike përmban tabelën përkatëse me një numër kategorish që duhet të plotësohen, në përputhje me udhëzimet e dhëna në Shtojcën 1.

PLANI I KONSULTIMEVE PËR PROJEKTAKTET

Çdo proces konsultimi duhet të fillojë me zhvillimin e një plani konsultimi për çdo projektakt. Ky plan konsultimi shërben si një hartë për një zbatim efikas dhe efektiv të procesit të konsultimit dhe mundëson monitorimin e procesit. Prandaj, plani përcakton:

- afatin kohor të procesit të konsultimit;
- audiencën e synuar (d.m.th. palët e interesuara që do të ftohen në mënyrë aktive të marrin pjesë në proces);
- metodat e konsultimit;
- burimet financiare, njerëzore dhe burimet e tjera të nevojshme për zbatimin e procesit;
- mënyrën e mbledhjes së përgjigjeve; dhe
- aktivitetet për monitorimin dhe vlerësimin e procesit.

Një plan i tillë duhet të përgatitet individualisht për secilin akt, që do të konsultohet në përputhje me ligjin. Gjatë fazës së planifikimit, institucioni duhet gjithashtu, të vendosë nëse do të realizojë konsultime paraprake me palët e interesit për projektaktin që synon të hartojë para fillimit të procesit të hartimit të tij, apo do të konsultojë projektaktin vetëm pasi ai të jetë në një fazë më të konsoliduar.

Modeli për planin e konsultimit paraqitet në Shtojcën 2, ndërsa një shpjegim i hollësishëm i aspektit metodologjik të planit të konsultimit jepet më poshtë.

Përcaktimi i afatit kohor

Kur përcaktohet afati kohor, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit duhet të përcaktojnë kohën e nevojshme për:

- 1) planifikimin dhe organizimin e konsultimeve;
- 2) zbatimin;
- 3) mbledhjen dhe analizën e komenteve; dhe
- 4) përgatitjen e një raporti.

Planifikimi duhet të jetë realist dhe proporcional dhe duhet të parashikohet kohë e mjaftueshme për të gjitha aktivitetet e sipërcituara, përgatitjen e tyre, shkëmbimin e informacionit, koordinimin, etj.

Ministrítë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrít duhet gjithashtu, të planifikojnë kohë të mjaftueshme për të mundësuar fleksibilitetin e nevojshëm dhe ndryshimet që mund të ndodhin gjatë procesit. Duhet gjithashtu, të merret parasysh se çështjet më komplekse, gjithëpërfshirëse ose të ndjeshme politikisht do të kërkojnë më shumë kohë ndërsa çështjet më pak komplekse mund të kërkojnë më pak kohë. Ministrítë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrít duhet gjithashtu, të marrin në konsideratë numrin e komenteve që mund të priten, pasi një numër i madh komentesh mund të marrin më tepër kohë për analiza dhe përgatitjen e raportit.

Kur përcaktohet afati kohor, ministrítë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrít duhet të marrin në konsideratë kërkesat ligjore në lidhje me afatet për dorëzimin e raporteve gjatë një konsultimi në formën e shkruar/elektronik të detyrueshëm dhe të planifikojnë në përputhje me rrethanat.

Identifikimi i aktorëve kryesorë

Identifikimi i aktorëve kryesorë duhet të realizohet me qëllim përfshirjen sa më shumë të tyre. Ministrítë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrít nuk duhet të kufizohen vetëm tek aktorët me të cilët tashmë bashkëpunojnë. Përkundrazi, duhet të konsiderojnë me kujdes se kë do ndikojë politika e re, dhe cilët janë aktorët që mund të jenë të rëndësishëm në hartimin e politikës së re, bazuar në njoħuritë dhe përvojën e tyre.

Për grupe të caktuara të palëve të interesit, mund të jetë e parashikuar në legjislacion që të tilla grupe duhet të informohen dhe të përfshihen në hartimin e akteve (p.sh. komunitetet lokale, organizatat e personave me aftesi të kufizuar, të rinjtë, etj.). Për identifikimin e aktorëve të tjerë, ministrítë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrít duhet: (i) të përdorin listat e grupeve të interesit që kanë marrë pjesë në hartimin e propozimeve të akteve të mëparshme ose të ngjashme, (ii) të kontrollojnë regjistrat e komenteve dhe propozimeve të dërguara nga organizata ose individë para se të fillojë të hartohet projektakti, të kontrollojë me kë punon në përgjithësi ministria/ institucionet qendrore (kush ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme, takime, etj.), dhe (III) mundësishët të kërkojnë ndihmë nga organizata të ndryshme ombrellë dhe shoqata (të tilla si dhomat e tregtisë, rrjetet e organizatave joqeveritare, zyrat qendrore të sindikatave, etj.).

Konsultimet e mundshme paraprake duhet të përfshijnë të paktën grupet e ekspertëve dhe shoqatat përfaqësuese (shoqatat e biznesit, sindikat, OSHC-të ombrellë, grupet e studimit, institutet kërkimore, etj.) nga fusha në fjalë. Nëse ministrítë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrít vlerësojnë se procesi i hartimit dhe cilësia e projektaktit do të përfitonin nga konsultimet e hapura paraprake me publikun, mund të organizojnë edhe konsultime të tilla.

Konsultimet mbi projektaktin duhet të kenë një shtrirje sa më të gjerë. Kjo është koha për të kontrolluar integritetin, mjaftueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e zgjidhjeve të propozuara, më specifisht të tekstit legjislativ, si dhe për të identifikuar çdo përbajtje që mund të ketë kundërshti, me qëllim që të sigurohet që propozimi të ketë mbështetjen dhe legitimitetin më të gjerë publik.

Qëllimi i identifikimit të palëve të interesit është që: i) të përcaktojë në kohë grupe, organizata, individë që mund të preken nga projektaki apo politika e synuar; ii) të parashikojë llojin e ndikimit të mundshëm të aktorëve të caktuara në projektakt, dhe iii) të zhvillojë strategjinë për të fituar

mbështetjen më efektive për politikën e ardhshme dhe parandalimin e pengesave të mundshme në zbatimin e saj.

Procesi i identifikimit të palëve kryesore të interesit, duhet të fillojë me përgatitjen e listës zyrtare të palëve të interesuara që do të përfshihen në një proces konsultimi, me theks në çështjet vijuese:

- grupet e interesit që preken nga politika;
- grupet e interesit që do të përfshihen në zbatimin e politikës;
- organizata, objektivat e veprimtarisë së të cilave ndërlidhen drejtpërdrejtë me politikën e synuar;
- subjekte që duhet të konsultohen për një fushë të veçantë të politikës, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi;
- ‘opinionbërësit’ të cilët mund të ndikojnë në formimin e mendimit të liderëve politikë dhe publikut mbi qëllimet e politikës.

Një nga metodat e përdorura shpesh për identifikimin e palëve të interesuara paraqitet më poshtë si “matrica e analizës së palëve të interesuara”.

Matrica e analizës së palëve të interesuara bazohet në dy komponentët kryesorë:

- 1) fuqia ose ndikimi i palëve të interesuara; dhe
- 2) interesi i palëve të interesuara në politikën e propozuar.

Palët e interesit me fuqinë ose ndikimin më të lartë të mundshëm të perceptuar dhe interesin më të lartë në politikën e propozuar, konsiderohen të jenë “palët kryesore të interesit”, përfshirje/dIALOGU i përparuar, konsultimi i përqendruar në hartimin e politikës.

Matrica e analizës së palëve të interesuara

PALËVE I lartë	PALËT DYTËSORE (pushtet ilartë, interes iulët) – konsultim i hapur dhe informim proaktiv	PALËT KRYESORE (KYÇE) (pushtet ilartë/ndikim i lartë, interes i lartë) –partneritet, përfshirje/dialogu i përparuar, konsultimi i përqendruar në hartimin e politikës.
	Palët e interesuara me fuqi/ndikim të ulët dhe interes të ulët - informim proaktiv	PALËT DYTËSORE (pushtet/ndikim i ulët, interes i lartë) - konsultim i hapur dhe informim proaktiv
I ulët	INTERESI	I lartë

Kjo metodë e identifikimit të palëve të interesuara nuk vë në pikëpyetje barazinë e aksesit të palëve të ndryshme të interesit në dialogun me institucionet, por më tepër u mundëson këtyre të fundit të zhillojnë një qasje më strategjike për identifikimin në kohë të palëve të interesuara.

Identifikimi i palëve të interesuara për konsultime më të përqendruara, si përmes seminareve, komiteteve të punës ose diskutimeve të synuara, këshillohet të mbështeten në kriteret e propozuara nga Komisioni Evropian në Komunikimin e tij të vitit 2002 mbi Parimet e Përgjithshme dhe Standardet Minimale të Konsultimeve Publike me Palët e Interesuara, si vijon:

- nevoja për përvojë specifike, ekspertizë ose njohuri teknike, kur është e zbatueshme;
- historiku i pjesëmarrësve në konsultat e mëparshme;
- nevoja për një ekilibër të duhur, kur është e nevojshme, ndërmjet përfaqësuesve të:
 - o subjekteve me karakter social dhe ekonomik;
 - o organizatave ose kompanive të mëdha dhe të vogla;
 - o grupeve të popullsisë në përgjithësi apo grupeve specifike të synuara (p.sh. gratë, të moshuarit, të papunët ose pakicat kombëtare);
- nevoja për të përfshirë interesa të grupeve jo të organizuar, kur është e përshtatshme;
- ndikimi më i gjerë i politikës në fusha të tjera të politikës (p.sh. interesat mjedisore ose politika e konsumatorit).

Rekomandohet që ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat të zhillojnë bazën e të dhënavë për palët e interesuara/ekspertët për konsultime për projekt iniciativat ligjore/politike në fushat e tyre të përgjegjësisë. Kjo bazë e të dhënavë mund të përditësohet pas çdo konsultimi publik të përfunduar. Qëllimi i një baze të tillë të dhënash është të sigurojë shpërndarjen proaktive të informacionit në të gjitha fazat e procesit të konsultimit publik dhe, më posaçërisht, të sigurojë shtrirjen/komunikimin më të mirë të konsultimeve të hapura dhe mobilizimin e pjesëmarrjes më të madhe të palëve të interesuara.

Përveç të dhënavë të përgjithshme mbi kategorinë dhe detajet e kontaktit të organizatës, kjo bazë e të dhënavë duhet të lejojë strukturimin më të mirë të palëve të interesuara sipas fushës së veprimtarisë së tyre dhe të politikës së përgjithshme (për shembull, mbrojtja e mjedisit, të drejtat e njeriut, kultura, rinia, arsimi, financat publike, etj.), apo dhe fushës së tyre specifike të ekspertizës e cila është e rëndësishme për iniciativën ligjore/politikat e ministrisë/ institucionet qendrore, regjistrimin e pjesëmarrjes së tyre të mëparshme në grupe pune për hartimin e nismave ligjore/ politikave të ministrisë dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, si dhe kontributin e mëparshëm në proceset e konsultimit publik të realizuar nga institucioni.

Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat përdorin modelin e paraqitur në Shtojcën 3 të këtij Udhëzuesi përgatitjen/mirëmbajtjen e bazës së të dhënavë të palëve të interesit/ekspertëve.

Përzgjedha e metodave

Sipas ligjit, metodat kryesore të konsultimeve janë e-konsultimet përmes Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP-së) dhe takimeve publike. Sidoqoftë, ministritë/ institucionet qendrore mund të përdorin metoda shtesë, të tilla si takime të synuara me palët e interesuara, konferenca, sondazhe të opinioneve, panele me qytetarë, etj.

Për konsultimet paraprake me palët kryesore të interesit, më të përshtatshme janë metodat e tillë që mundësojnë diskutimin ndërmjet ekspertëve, të tillë si fokus grupe dhe seminare.

Rregulli kryesor që duhet të ndiqet gjatë zgjedhjes së metodave të konsultimit është që ato të përshtaten me çështjen në fjalë, objektivat e përcaktuara dhe palët e identikuara të interesit. Konsideratë e veçantë duhet t'u kushtohet nevojave dhe preferencave të grupeve të veçanta, të tillë si: të moshuarit, të rinjtë ose personat me aftësi të kufizuara. Disa palë të interesuara, për shembull, ndjekin konsultimin me shkrim (p.sh. akademia, grupet e interesit); disa mund të kenë qasje të vështirë në komunikimin elektronik (p.sh. të moshuar, grupe të margjinalizuara) dhe të tjerët thjesht dëshirojnë të paraqesin mendimet e tyre verbalisht dhe jo me shkrim.

Ministratë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit duhet të marrin parasysh edhe numrin e palëve të interesuara. Me qëllim arritjen e ndikimit dhe përfshirjes sa më të gjërë në procesin e konsultimit, duhet të përdoren metoda të ndryshme konsultimi, dhe jo vetëm ato të konsultimeve në grupe të vogla, grupe interesi ose konsultime vetëm me ekspertë.

Gjatë zgjedhjes së metodave, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit, gjithashtu, duhet të marrin parasysh afatin e planifikuar për miratimin e politikës ose projektaktit dhe mundësitet financiare, të burimeve njerëzore dhe teknike. Disa metoda mund të kërkojnë më shumë burime sesa të tjerat dhe institucioni duhet të sigurohet që i ka ato në dispozicion kur zgjedh metodën.

Shkurtimisht, zgjedhja e metodës së konsultimit ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e sasinë e kontributeve të publikut. Bazuar në praktikat e mira krahasuese, rekomandohet të merren parasysh kriteret e mëposhtme për përzgjedhjen e metodave të konsultimit:

- *efikasiteti* (të përshtatshme për periudhën kohore, burimet njerëzore dhe financiare të cilat janë në dispozicion për zbatimin e konsultimeve) dhe
- *përshtatshmëria për një grup të synuar* (stili i komunikimit, niveli i informacionit, disponueshmëria në kohë dhe hapësira e palëve të interesuara).

Më posaçërisht, vlerësimi i përshtatshmërisë së metodave të konsultimit për grupet e synuara duhet të bazohet në pyetjet e mëposhtme:

- Cilët persona/grupe të synuara kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në konsultimet publike në rast të përdorimit të kësaj metode?
- Për cilat grupe kjo metodë nuk është e përshtatshme?
- Cilat janë metodat alternative për përfshirjen e grupeve?
- A ka ndonjë organizatë/shoqatë ombrellë që mund të ndihmojë në mbledhjen e mendimeve nga organizata të tjera?

Skema e mëposhtme mund të ndihmojë gjithashtu, në zgjedhjen e metodave të përshtatshme:

Pikat e fortë dhe dobëta të disa metodave më të zakonshme të konsultimit:

Metoda	Pikat e forta	Pikat e dobëta
Konsultime me shkrim	<ul style="list-style-type: none"> Mënyrë e mirë për të marrë pikëpamje për çështje komplekse nga palët e interesuara Komente në internet ose mundësia e dorëzimit të tyre Mund të shoqërohet me pyetje kontekstuale Lejon kohë që të përgatiten përgjigjeve të menduara 	<ul style="list-style-type: none"> Disa grupe mund të kenë mungesë të burimeve për analizë dhe përgjigje të plotë Përgatitja e përgjigjeve mund të marrë kohë Përgjigjet mund të mos janë plotësisht përfaqësuese dhe mund të janë të vështira për t'u analizuar
Mjetet e TIK-ut	<ul style="list-style-type: none"> Kosto shumë e ulët e publikimit në Internet Mund të prekë një audiencë të gjërë 	<ul style="list-style-type: none"> Mungesa e aksesit universal Mundësia e problemeve teknike
	<ul style="list-style-type: none"> Lehtëson mbledhjen më të lehtë të përgjigjeve Lejon prezantimin interaktiv të materialeve konsultuese Informacioni mund të përditësohet/ndryshohet relativisht shpejt 	<ul style="list-style-type: none"> Informacioni duhet të projektohet dhe prezantohet ndryshe në internet TI-ja nuk është një zgjidhje për të gjitha aspektet e konsultimit – disa përgjigje ende jepen dhe analizohen jo elektronikisht
Komititet këshillimore (këshillat publik)	<ul style="list-style-type: none"> Burim i mirë i këshillave për çështje komplekse sociale ose teknike Ekspertiza e njohur e komisioneve ndihmon në informimin e proceseve të vendimmarrjes Mund të ndihmojë në krijimin e një politike më të përshtatshme, veçanërisht kur merren me çështje komplekse ose të diskutueshme të politikës. 	<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi i dinamikës së qetë të brendshme brenda një grupi mund të jetë e vështirë Është i nevojshëm një mandat dhe afat kohor i qartë Komititet e përhershme këshillimore kanë nevojë për kohë dhe burime për të siguruar funksionimin efektiv.
Sondazhet e bazuara në pyetësor	<ul style="list-style-type: none"> Të mira për pyetje më të gjata dhe më komplekse Mund t'i drejtohen një audience të synuar dhe përfaqësuese Lejon audiencën të gjejë kohë për të përfunduar sondazhin Lejon një përgjigje të mirëmenduar ndaj subjekteve të vulnerabël 	<ul style="list-style-type: none"> Pyetësorët kanë nevojë për hartim të kujdeshëm Ka pak kontroll mbi atë se kush e plotëson atë Shkalla e përgjigjes mund të jetë e ulët

Sigurimi i burimeve të nevojshme

Kur planifikohen burimet e duhura financiare dhe njerëzore dhe kërkesat materiale për zbatimin e konsultimeve, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të parashikojnë sa kohë do u nevojitet për organizimin e konsultimeve, cili është numri i personelit që duhet të caktohet për të kryer konsultime dhe nëse konsultimet kërkojnë disa burime të tjera, p.sh. mjetet financiare për të marrë me qera ambiente të tjera nëse takimet publike do të organizohen në një nivel lokal, etj.

Një planifikim i tillë duhet të marrë parasysh parimin e proporcionalitetit, të jetë realist dhe nuk duhet të nënverësojë burimet e nevojshme. Çdo hap (planifikimi, përfshirja e ekspertëve të jashtëm, analiza e komenteve të marra, përgatitja e reagimeve dhe vlerësimi i procesit) kërkon kohë të caktuar.

Nëse nuk ka burime të mjaftueshme për zbatimin e të gjitha metodave të parashikuara të konsultimit në dispozicion, procesi duhet të rregullohet në përputhje me rrethanat.

Identifikimi i mënyrës së mbledhjes së përgjigjeve

Mënyrat e mbledhjes së përgjigjeve duhet të përcaktohen që kur planifikohet procesi, sepse ato do të përdoren në raport me të gjitha metodat e përcaktuara.

Qëllimi i identifikimit të mënyrës së mbledhjes së përgjigjeve është të sigurojë shqyrtimin e gjurmueshmërisë së secilit prej komenteve. Metoda e mbledhjes së komenteve varet nga metodat e konsultimit. Në rast të një konsultimi me shkrim dhe elektronik, kjo detyrë është mjaft e thjeshtë, ndërsa në rast të takimeve publike, seminareve, konferencave, etj. ministria/institucionet qendrore në varësi të Kryeministrat duhet të planifikojnë paraprakisht se si do të përfshijnë komentet në procesverbal/konkluzione, shënimet takimesh, etj. Nëse përdoren metoda të ndryshme konsultimi, duhet gjithashtu të sigurohet që të gjitha komentet të mblidhen me të njëtin kujdes.

Parashikimi i monitorimit dhe vlerësimit

Qëllimi i monitorimit të zbatimit është të lejojë institucionin përgjegjës të ndjekë nëse procesi i konsultimit po zhvillohet sipas planit dhe rezultatet e pritura të tij janë duke u arritur, në mënyrë që ai të mund të reagojë dhe rregullojë procesin nëse devijohet ndjeshëm nga plani.

Për të mbledhur të gjithë informacionin e dobishëm, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të monitorojnë procesin si të tillë - zbatimin në lidhje me aktivitetet e planifikuar, afatet kohore dhe burimet dhe cilësinë e tij - si janë zbatuar aktivitetet dhe nëse janë realizuar rezultatet. Planifikimi i monitorimit duhet të jetë realist. Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të monitorojnë vetëm ata tregues që ndihmojnë për të arritur një zbatim efikas dhe efektiv.


Për të siguruar që monitorimi është bërë me cilësi të mirë, institucioni ka nevojë të:

- integrojë aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit në planin e konsultimit;
- përcaktojë burimet, mjetet dhe mekanizmin për mbledhjen e informacionit në lidhje me suksesin e procesit të konsultimit;
- mbledhë vazhdimisht të gjitha të dhënat e nevojshme;
- analizojë të dhënat e mbledhura në të gjitha momentet kryesore (fazat e procesit).

Për marrjen e informacionit mbi procesin e konsultimeve, duhet të përdoren mjetet e mëposhtme të monitorimit:

- pyetësorët e vlerësimit (për marrjen e mendimit të pjesëmarrësve për ngjarjet e organizuara dhe metodat e pjesëmarrjes të përdorura);
- lista e pjesëmarrësve (për të monitoruar numrin dhe gamën e aktorëve të përfshirë);
- raportet e aktivitetit (raport gjithëpërfshirës mbi aktivitetin dhe komentet e marra);
- takimet e brendshme të nëpunësvetë përfshirë.

Skema e monitorimit, vlerësimit dhe përshtatjes së procesit:



Plani i konsultimit gjithashtu, duhet të parashikojë vlerësimin e brendshëm në fund të të gjithë procesit (kur dhe me kë).

Një vlerësim i tillë jep informacion të vlefshëm për objektivat e arritura dhe palët e interesit të prekura. Është gjithashtu e rëndësishme nga perspektiva e zhvillimit kapaciteteve, pasi mundëson zbulimin e aspekteve pozitive, si dhe negative, të cilat më pas mund të përmirësohen në të ardhmen.

PËRGATITJA E SHËNIMIT SHPJEGUES PËR KOSULTIMIN PUBLIK

Ligji kërkon që në fillim të konsultimeve duhet të sigurohet informacioni i mjaftueshëm për të garantuar kuptueshmërinë e çështjeve për të marrë përgjigje të informuara.

Përsa më sipër, kjo kërkon hartimin dhe publikimin e Shënimit Shpjegues për Konsultimin Publik dhe raportit të VNR-së krahas projektaktit.

Një mundësi shtesë për t'u siguruar që palët e interesuara i kuptojnë çështjet është përgatitja e një Shënim shpjegues për çdo projekt-akt kur paraqitet për konsultim publik.

Shënim shpjegues për çdo projekt-akt duhet të sigurojë informacione logistike, si dhe çështje të lidhura me konsultimet.

Secili dokument konsultativ duhet të përfshijë Shënimin shpjegues me informacione lidhur me:

Informacione logistike

- Informacion mbi publikun e synuar/grupet e interesit;
- Informacion mbi kohëzgatjen e konsultimeve;
- Informacion se si mund të përgjigjet publiku/palët e interesuara (p.sh. në internet, përmes postës elektronike, postës);
- detajet e kontaktit të koordinatorit të ministrisë/ institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit për njoftimin publik dhe konsultimin për mbledhjen e rekomandimeve dhe komenteve mbi projekt-aktin;
- datat dhe vendet e takimeve publike, nëse ato organizohen.

Informacioni i lidhur me çështjen

- qëllimi i projekt-aktit të ri/politikës ku përfshihet informacion mbi historikun (gjendja, problemet);
- çështjet kryesore të shqyrtuara;
- ndryshimet kryesore të parashikuara dhe/ose alternativat e mundshme me ndikimin e tyre të parashikuar.

Shënim shpjegues i dokumentit të konsultimit duhet, veçanërisht në rastet e akteve gjithëpërfshirëse dhe komplekse, të përbajë edhe një sërë pyetjesh konkrete për palët e interesuara për çështjet kryesore të shqyrtuara (p.sh., 'A jeni dakord që duhet të ndërmerren veprime të mëtejshme për të parandaluar/rritur ...', 'A jeni dakord se ne e kthejmë këtë në një vepër penale ...', 'A jeni dakord me përkufizimin tonë të ri për....', etj.).

Në rastet, kur ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, kërkojnë të dhëna shtesë në lidhje me gjendjen dhe ndikimin e mundshëm të projektaktit të ri, duhet të përfshihet edheko pyetje (p.sh. 'Cili do të ishte ndikimi i propozimeve tona në biznesin tuaj, organizatat', 'A ka organizata juaj ... ', etj.).

Shënim shpjegues i dokumentit të konsultimit duhet të përgatitet në një gjuhë të thjeshtë, të quartë dhe të kuptueshme dhe të shmangë shkurtimet. Ai duhet të btohet në Regjistrin Elektronik, së bashku me projektaktin e publikuar për konsultim.

Modeli i Shënimit shpjegues të dokumentit të konsultimit, paraqitet në Shtojcën 4 të këtij Udhëzuesi.

FILLIMI I KONSULTIMEVE

Konsultimet për projektaktet fillojnë me publikimin e shënimit shpjegues të dokumentit të konsultimit, raportit të VNR-së dhe dokumente të tjera përkatës, së bashku me projektaktin, në RENJKP. Dokumente të tjera të rëndësishëm mund të përfshijnë çdo analizë dhe sondazh të lidhur, raporte mbi rezultatin e konsultimeve të mëparshme, nëse ka ndodhur konsultimi paraprak, dhe ndonjë dokument tjetër që mund të ndihmojë publikun të kuptojë çështjet kryesore të aktit të konsultuar.

Sipas ligjit, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat mund të informojnë palët e interesuara për konsultime përmes kanaleve të tjera të komunikimit, nëse e konsiderojnë të nevojshme. Kanale të tilla mund të përfshijnë postën elektronike, postimet, njoftime në media etj. Mënyra të tilla komunikimi dhe njoftimesh duhet të përdoren gjithashtu për konsultime paraprake kur audiencia e tyre e synuar nuk është publiku i gjerë.

Në çdo rast, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të informojnë në mënyrë aktive të paktën palët kryesore të interesit për fillimin e procesit. Ftesa me postë elektronike dhe botimi në faqen e internetit shpesh nuk janë të mjaftueshme për të térhequr interes. Prandaj, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të përdorin ftesa të posaçme dhe të marrin në konsideratë çfarë e térheq veçanërisht interesin e aktorëve të veçantë e lidhje me projektaktin dhe t'i theksojë këto pyetje në këtë ftesë.

Personat që konsultohen duhet të kenë kohë të mjaftueshme për të kuptuar çështjet dhe për të qenë në gjendje të japid përgjigje të informuara. Sipas ligjit, afati i përgjithshëm për dorëzimin e komenteve për projektaktet është 20 ditë pune. Në rast të akteve veçanërisht komplekse dhe të rëndësishme, d.m.th. politikave dhe reformave legjislativ shumë gjithëpërfshirëse, afati mund të zgjatet deri në 40 ditë pune. Gjatë caktimit të afateve, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të marrin parasysh ligjet specifike dhe procedurat e tyre gjatë konsultimeve publike, përfshirë edhe afatet.

Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat mund të zgjasin afatin për dorëzimin e komenteve ose të përsërisin konsultimet, nëse cilësia e komenteve të paraqitura nuk është e kënaqshme ose nëse komentet e marra adresojnë çështje shtesë të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e konsultimeve fillestare.

Për konsultimet paraprake me shkrim, afati sipas ligjit është 20 ditë pune.

Nëse, përvëç konsultimeve publike me shkrim, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat organizojnë edhe takime publike, ligji kërkon që ato të janë të hapura dhe që të gjithë pjesëmarrësit të kenë mundësinë të shprehin mendimet e tyre mbi çështjet e diskutuara. Sipas ligjit, nëpunësi i ministrisë dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, përgjegjës për hartimin e politikës/projektaktit, duhet të mbajë procesverbalin e mbledhjes. Kur organizojnë takimin publik, zyrtarët publikë duhet të marrin parasysh kohën se kur e kanë më të përshtatshme palët e interesuara të marrin pjesë në takim. Vendi i takimit duhet të konsiderojë aktin në fjalë. Nëse çështjet kanë të bëjnë me nivelin lokal, atëherë duhet të organizohen disa takime në të gjithë vendin.

Nëpunësi/ja përgjegjës/e i/ministrisë dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet gjithashtu të mbajnë procesverbal për çdo takim apo aktivitet konsultativ të organizuar përgjatë procesit të konsultimit.

MBLEDHJA DNE ANALIZA E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE

Sipas ligjit, komentet që janë marrë gjatë konsultimeve duhet të mblidhen dhe strukturohen nga koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik në ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat, që kanë iniciuar procesin e konsultimeve. Nëse komentet e marra para se të fillojë hartimi, nuk janë konsideruar ende dhe kështu nuk janë pasqyruar në projektakt, në këtë fazë duhet të shqyrtohen së bashku me komentet e marra gjatë konsultimeve zyrtare.

Koordinatori/ja duhet të strukturojë komentet sipas çështjeve të ngritura dhe/ose pyetjeve të vendosura në shënimin shpjegues të dokumentit të konsultimit.

Me qëllim realizimin e një analize dhe raportimi më efektiv të rezultateve të konsultimeve publike, komentet duhet të strukturohen në përputhje me modelin e paraqitur në Shtojcën 5, sipas rendit në vijim:

1. çështjet e konsultuara/adresuara: koordinatori/ja do të rendisë çështjet/pyetjet që janë konsultuar ose adresuar nga palët e interesit;
2. komente të grupuara: koordinatori/ja do të mbledhë komente të ngjashme sipas se cilës çështje;
3. palët e interesuara: koordinatori/ja do të rendisë të gjithë palët e interesuara që komentojnë për çështjen ose grupin specifik të çështjeve.

Sipas ligjit, komentet e bashkuara duhet të shqyrtohen nga zyrtarët përgjegjës publikë. Bazuar në analizën dhe diskutimin e tyre, do të merret një vendim i qartë, nëse komentet e bashkuara pranohen, pranohen pjesërisht ose refuzohen. Për secilin vendim, duhet të jepet një arsyetim, dhe ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të përditësojnë projektaktin në përputhje me komentet e pranuara.

Pasqyra e komenteve të marra dhe veçanërisht arsyetimi i komenteve të refuzuara është pjesa më e rëndësishme e raportit individual për secilin projektakt, pasi është thelbësore për të treguar ndikimin e konsultimeve publike. Prandaj, ky komponent i procesit të përgjithshëm të konsultimeve publike kërkon qasjen dhe vëmendjen e duhur.

RAPORTIMI MBI REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTAKTET

Përgatitja e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike mbi projektaktet ligjore dhe të politikave, konsiderohet të jetë një nga hapat më thelbësorë për ta bërë procesin e konsultimit publik kuptimplotë, i cili ka një ndikim të madh në besimin e qytetarëve në raport me punën e institucioneve.

Cilësia e reagimit të ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat, ndaj kontributeve të marra nga publiku i interesuar, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në motivimin dhe vullnetin e palëve të interesuara për të marrë pjesë në konsultimet e hapura publike.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se nen 19, i ligjit parashikon që projektaktet e paraqitura në Këshillin e Ministrave duhet të shoqërohen me raport individual, duke përfshirë një përbledhje të rekondimeve të pranuara. Nëse rekondimet e palëve të interesuara nuk pranohen, atëherë ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të japid përbledhtazi arsyet e mospranimit dhe të informojnë palët e interesuara për këtë, përmes një raporti.

Vendimi nr.584, datë 28.8.2003, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar përcakton që, në rastin e projektakteve, të cilat duhet të konsultohen me publikun, institucionet janë të detyruara të përgatisin një Shënim Shpjegues që duhet të përbajë informacione për: "personat dhe institucionet që kanë kontribuar në plotësimin e projektaktit, shpjegimet në lidhje me identifikimin e palëve të interesit që marrin pjesë në konsultim, kohëzgjatjen e procesit të konsultimit, çështjet e diskutuara dhe komentet e shprehura nga palët e interesit, si dhe përfshirjen ose jo të komenteve të palëve të interesit në projektakt" (pikat 18/b dhe 19/ë, të VKM nr.584, datë 28.8.2003, të ndryshuar).

Meqenëse raportet mbi rezultatet e konsultimeve për aktet individuale ofrojnë bazën për raportin (gjashtë-mujor) vjetor të konsultimeve publike të realizuara nga institucioni, është e rëndësishme të harmonizohet përbajtja e të gjitha raporteve.

Përbledhja e raportit individual të konsultimit për secilin projektakt

Më poshtë jepet përbledhja e përbajtjes së raportit individual të konsultimit për secilin projektakt. Modeli i strukturuar paraqitet si pjesë e Shtojcës 5d të këtij Udhëzuesi.

1. Titulli i projekt-aktit

2. Kohëzgjatja e konsultimeve (*specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike*)

3. Metodat e konsultimit (*renditni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, siç janë konsultimet elektronike, takimet publike, seancat e organeve këshillimore, etj.), dhe ofroni informacione mbi kohën e realizimit dhe kohëzgjatjen e tyre. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse ato janë organizuar*).

4. Palët e interesuara të përfshira (*Shënoni të gjithë palët e interesuara, ose organizata ose individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit, duke përfshirë palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit*).

Pasqyra e komenteve të marra me arsyetimin e komenteve të pranuara/të refuzuara (*Organizoni komentet/propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën; gruponi komente të ngashme së bashku dhe renditini palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për këtë vendim*.)

Meqenëse ligji vë theksin në përbledhjen e rekomandimeve të pranuara, kjo nënkupton që raportimi duhet të ndjekë qasjen "e fokusuar" të analizës së komenteve të marra dhe raportimit të komenteve të pranuara/refuzuara si në raportet individuale të konsultimit, ashtu edhe në raportet (gjashtë-mujore) vjetore. Komentet mund të paraqiten në mënyrë kolektive, pasi ato të strukturohen dhe konsiderohen, siç tregohet në tabelën më poshtë.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri..., kushtet për regjistrimin e..., rregulli i..., etj.)	Komenti (strukturonidhe përblydhni komente identike/të ngashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngashme)	Vendimi (I pranuar/ I pranuar pjesërisht/ I refuzuar)	Arsyetimi

Nuk ka një afat të përcaktuar ligjërisht për publikimin e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike në Regjistrin Elektronik dhe shpërndarjen e tij te të gjithë ata që paraqiten komentet e tyre me shkrim. Sidoqoftë, rekomandohet që të publikohet dhe shpërndahet raporti përpara se projektakti të dërgohet për miratim.

Meqenëse ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit janë përgjegjëse për procesin e konsultimit publik për projektaktin, pasi të janë analizuar komentet e marra dhe ketë kryer përditësimin e projektaktit, raporti për rezultatet e konsultimeve publike duhet të vihet në

dispozicion të publikut të interesuar, në kohën kur akti dërgohet për procedura bashkërendimi dhe miratimi, së bashku me reportin dhe dokumentet e tjera të kërkuara, në zbatim të VKM-së nr.584, datë 28.8.2003, të ndryshuar.


Kur projektakti me paketën shoqëruese të materialeve dërgohet nga ministritë për miratim, ai duhet të përfshijë reportin individual të detyrueshmë të konsultimit. Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri gjithashtu, duhet të sigurojë që të gjitha projektaktet të shoqërohen nga raporti i konsultimit.

Pavarësisht nga ndryshimet ose ndryshimet e mundshme të mëtejshme të projektaktit, bazuar në kontributet nga komisionet parlamentare, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit janë përgjegjëse për informimin e publikut mbi rezultatet e konsultimit publik lidhur me përprojektaktin që paraqitet për konsultim.

Procesi i përgatitjes së reportit individual të konsultimit publik

Me qëllim sigurimin e një qasjeje të integruar për përgatitjen dhe publikimin e reportit individual mbi rezultatet e konsultimit publik për projektaktin, është e rëndësishme të sigurohet përdorimi efektiv i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar (IPSiS) dhe më veçanërisht modulit të tij për raportimin e konsultimit publik, në përputhje me manualin e sistemit për përdoruesit.

Më poshtë paraqiten hapat e rekomanduar të punës për përgatitjen, miratimin dhe shpërndarjen e reportit individual për konsultimin publik mbi projektaktin aktual ose politikën aktive.



Bazuar në komentet dhe rekomandimet e mbledhura nga koordinatori/ja për konsultimet publike, eksperti përgjegjës i politikave në ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit përgatit reportin e konsultimit publik për aktin/dokumentin e propozuar të politikës përmes IPSIS duke ndjekur këto hapa:

- zgjedh Seksionin e Raportit të Konsultimit Publik në panelin e navigacionit IPSIS për Raportin mbi projektaktet e planifikuara;
- shton masën ligjore të propozuar (aktin/dokumentin e politikës);
- plotëson fushat e nevojshme (Dokumentin e Projektaktit/Politikës; Kohëzgjatjen e Konsultimit; Aktivitetet e Konsultimit; Palët e interesuara të përfshira; Komentet dhe sugjerimet e marra).

Pasi eksperti përgjegjës i politikave në ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat tek përgatisë projekt-raportin e konsultimit publik, projektakti duhet të paraqitet për shqyrtim tek drejtori përgjegjës në institucion. Pas shqyrtimit cilësor të projektaktit, drejtori e paraqet projekt-raportin e konsultimit tek Sekretari i Përgjithshëm/titullari i cili është përgjegjës për miratimin e projekt-raportit në nivelin e ministrisë. Sekretari i Përgjithshëm/titullari i institucionit ia përcjell projekt-raportin dy Departamenteve në Kryeministri (DZHM/DRRP) përmendim.

Bazuar në manualin IPSIS, tabela më poshtë përbledh hapat kryesorë në procesin e miratimit të raportit përmes sistemit IPSIS, i cili lejon një kontroll qendror e të qëndrueshëm të cilësisë së raporteve të konsultimit publik.

Procesi i miratimit të projekt-raportit të konsultimit publik përmes IPSIS

Gjendja	Veprimi	Roli i veprimit	Rezultati i veprimit
Projekt-Raporti i Konsultimit Publik	Paraqit	specialisti/ja i/e politikave	Dorëzuar nga specialisti/ja i/e Politikave
Dorëzuar nga specialisti/e i/e Politikave	Paraqit	Drejtori/e	Dorëzuar nga Drejtori/e
Dorëzuar nga Drejtori/e	Paraqit	Sekretar/e i/e përgjithshëm	Dorëzuar nga Sekretari/ja i/e Përgjithshëm
Dorëzuar nga Sekretari/e i/e Përgjithshëm	Aprovon	Koordinatori/e i/e DZHM	Miratuar nga DZHM dhe DRRP
Miratuar nga DZHM dhe DRRP	Aprovon	Drejtori/e i/e Drejtorisë së DZHM	Miratuar nga Drejtori/e i/e Drejtorisë së DZHM
Miratuar nga Drejtori/e i/e Drejtorisë së DRRP	Aprovon	Drejtori i Njësisë	Miratuar nga Drejtori/e i/e Njësisë

Burimi: Sistemi I\i Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar (IPSI) - Manuali i Përdoruesit

Pasi raporti të miratohet zyrtarisht nga të gjitha nivelet hierarkike përmes IPSIS, koordinatori i konsultimit publik në ministrinë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat nxjerr raportin nga IPSIS dhe e publikon atë në RENJKP. Më në fund, eksperti përgjegjës i politikave shpërndan raportin e publikuar tek të gjithë pjesëmarrësit e konsultimit publik dhe publikut të gjerë përmes postës elektronike dhe/ose faqes në internet të ministrisë dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat. Për më tepër, të gjithë përdoruesit e regjistruar të Regjistrat Elektronik duhet të njoftohen për publikimin e raportit të konsultimit publik për aktin e konsultuar.

Për përgatitjen e raportit, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat përdorin modelin e raportit në Shtojcën 5d të këtij Udhëzuesi.

VLERËSIMI I PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK

Vlerësimi i procesit të konsultimit publik është i rëndësishëm në nivelin e konsultimeve individuale për secilin projektakt ligjor ose politikë, por edhe në nivelet e performancës (gjashtë-mujore) vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat dhe performancës së përgjithshme (gjashtë-mujore) vjetore të qeverisë qendrore, në lidhje me zbatimin e standardeve për konsultimet publike.

Vlerësimet në të gjitha këto nivele mund të bëhen bazuar në sistemin e monitorimit dhe raportimit që prezantohen me këtë Udhëzues, duke marrë parasysh kornizën aktuale ligjore dhe politikat e konsultimit publik.

Më konkretisht, këto udhëzime të hollësishme përbajnjë një seri treguesish të rinj kryesorë të performancës në lidhje me aspekte të ndryshme të konsultimeve publike (referencë:pasaporta e treguesve në Shtojcën 6a të këtij Udhëzuesi), me synimin për të siguruar një bazë solide përmatjen e produkteve, rezultateve, por edhe ndikimin e konsultimeve publike.

Për më tepër, pas përfundimit të procesit të konsultimit për secilin projektakt ligjor ose politik, rekomandohet që konsultimi i zbatuar të vlerësohet jozyrtarisht nga ekipi që ka koordinuar procesin. Vlerësimi duhet të bazohet në informacionin e mbledhur përmes aktiviteteve të monitorimit, siç është shtjelluar tashmë në Modelin për Planin e Konsultimit Publik (Shtojca 2), ku ky lloj monitorimi dhe vlerësimi i brendshëm parashikohet si përbërës integral i planifikimit të procesit të konsultimit, me një sërë treguesish sasiorë dhe cilësorë që ndihmojnë ministritë/ dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat për të vlerësuar së brendshmi përshtatshmërinë e objektivave të përcaktuara, identifikimin dhe përfshirjen e palëve të interesit, metodat e zbatuara, burimet njerëzore dhe financiare të investuara, etj.

Një vetëvlerësim i brendshëm mund të rrisë më tej besueshmërinë e proceseve, pasi tregon se pjesëmarrja ka rezultuar me progres dhe se aktorët e saj janë të gatshëm të mësojnë përmes proceseve të bashkërenduara. Është e këshillueshme të ndahen gjetjet e vlerësimit me ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat, duke kontribuar në përmirësimin e përgjithshëm të proceseve pjesëmarrëse brenda administratës publike.

PËRGATITJA E RAPORTIT (GJASHTË-MUJOR)/VJETOR TË MINISTRIVE/INSTITUCIONEVE QENDRORE NE VARESI TE KRYEMINISTRIT PËR KONSULTIMET

Ka një tendencë në rritje nga qeveritë për të paraqitur ndikimin e përgjithshëm të konsultimeve publike në nivelin vjetor dhe për të përpunuar, deri në çfarë mase kontributet nga qytetarët, OSHC-të, bizneset dhe përfaqësuesit e tjerë të publikut të interesuar janë marrë parasysh në periudha të caktuara (gjashtë-mujore/vjetore).

Kjo është theksuar veçanërisht në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE, të vendeve kandidate dhe kërkesave të reja të monitorimit për të avancuar progresin në fushën e reformës së administratës publike, veçanërisht në lidhje me cilësinë e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, por gjithashtu edhe cilësinë e mjedisit dhe zhvillimit të politikave me shoqërinë civile.

Detyrimi ligjor i ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat për të përgatitur raporte vjetore mbi konsultimet publike përcaktohet në nenin 20, të ligjit nr.146/2014 "Për

njoftimin dhe konsultimin publik". Ky nen përcakton që institucionet janë të detyruara të hartojnë dhe publikojnë reportin vjetor mbi transparencën e procesit të vendimmarrjes, i cili duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm: i) Numrin e akteve të miratuar nga organi përkatës publik gjatë vitit përkatës; ii) Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, iii) Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuara dhe refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes; iv) Numrin e takimeve publike të organizuara.

Raporti vjetor duhet të publikohet në Regjistrin Elektronik për njoftim dhe konsultimet publike dhe faqet e internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, por gjithashtu, të shpërndahet në përputhje me nenin 11, të ligjit.

Me qëllim sigurimin e përgatitjes efektive dhe në kohë të raporteve vjetore, ky Udhëzues udhëzon ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit të përgatisin raporte gjashtë mujore dhe vjetore mbi konsultimet publike.

Përgatitja e raportit gjashtë mujor dhe vjetor duhet të bazohet në të dhënrat e mbledhura nga rapportet individuale të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, të përgatitura për secilin prej akteve brenda kompetencës së ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, që janë aprovuar ose për të cilat janë kryer konsultime publike gjatë vitit (ose gjashtë muaj në rastin e raporteve gjashtëmujore). Cilësia e raporteve gjashtë mujore dhe vjetore varet kryesisht nga cilësia e raporteve individuale të konsultimit mbi projektaktet dhe monitorimi sistematik i procesit të konsultimit publik.

Në sektionet në vijim shpjegohet procesi i përgatitjes së raporteve gjashtë mujore dhe vjetore, si dhe metoda e pikëzimit për matjen e cilësisë së performancës institucionale të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftim dhe konsultimet publike. Gjithashtu, shpjegohet formati i raportimit me anekset përkatëse që përmbajnë modelin për pjesët narrative të raportit (gjashtë mujor) dhe vjetor, si dhe modeli i pasqyrës së tabelës të të dhënave për konsultimet e kryera nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit.

Procesi i përgatitjes së raportit (gjashtë-mujor) vjetor të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit për konsultimet

Përgatitja e raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore për konsultimet publike të realizuara nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit duhet të menaxhohet nga koordinatori/ja i/e caktuar për konsultime publike, me mbështetjen e të gjitha drejtoreve përkatëse. Procesi duhet të kalojë përmes hapave të mëposhtëm:

Hapat/aktivitetet kryesore në hartimin e raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore të konsultimit

Aktiviteti	Afati
DZHM dërgon kërkesa për ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit për të paraqitur raportet (gjashtë-mujore) vjetore	31 dhjetor për raportet vjetore 30 qershor për raportet gjashtë-mujore
Koordinatorët në ministri dhe institucione qendrore, në varësi të Kryeministrit:	15 janar për raportet vjetore

<ul style="list-style-type: none"> - mbledhin të gjitha raportet individuale për konsultimet e bëra për projekt-aktet, si dhe të dhënrat për të gjitha aktet e miratuarë gjatë vitit përkatës - sintetizojnë informacionin sipas kategorive të kërkua të formatin e rekomanuar të raportit gjashtë-mujor dhe vjetor (përfshirë të dhëna për e-konsultimet elektronike të organizuara, takime publike, por edhe të dhëna për kontributet e mbledhura përmes seancave të organeve këshillimore ose grupeve të punës të mbajtura gjatë procesit të hapur të konsultimeve publike, etj) -konsultojnë raportet e GMPI-ve ose grupeve tematike para përfundimit të projekt-raporteve (gjashtë-mujore) vjetore 	10 korrik për raportin gjashtë-mujor
Përgatitja e projekt-raportit (gjashtë-mujor) vjetor dhe dërgimi i tij tek DZHM/DRRP për komente	20 janar për raportet vjetore 15 korrik për raportet gjashtë-mujore
DZHM/DRRP jep komente për projekt-raportet	25 janar për raportet vjetore 20 korrik për raportet gjashtë-mujore
Miratimi i raportit raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat dhe dërgimi i tij tek DZHM/DRRP përmes njofitimit zyrtar	31 janar për raportet vjetore 25 korrik për raportet gjashtë-mujore
Publikimi i raportit gjashtë-mujor dhe vjetor në regjistrin elektronik dhe në faqen e internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat	31 janar për raportet vjetore 25 korrik për raportet gjashtë-mujore

Cilësia e raportit gjashtë-mujor dhe vjetor varet në masë të madhe nga qendrueshmëria e mbledhjes së të dhënave nga secili konsultim publik i kryer gjatë vitit dhe për secilën metodë konsultimi, si dhe nga cilësia e raporteve individuale në rezultatet e konsultimeve për projek-aktet. Prandaj, rekandomohet që ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat, të jenë në përputhje me kërkesat e modelit të parashikuar në Shtojcën 5b të këtij Udhëzuesi.

Formati i raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore për konsultimet, i ministrive/dhe institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrat

Raporti gjashtë-mujor dhe vjetor i ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat përbëhet nga: i) Pjesa narrative, e cila duhet të ndjekë strukturën e unifikuar (Shtojca 5a), si dhe ii) Tabela (Shtojca 5b) e cila përmban të gjitha të dhënrat që janë përpunuar dhe shpjeguar më tej në seksionet narrative, përfshirë rezultatin e performancës institucionale për aktin që i nënshtronhet konsultimeve publike, bazuar në pasaportën e indikatorëve në Shtojcën 5c.

Meqenëse qëllimi i raportit gjashtë-mujor dhe vjetor i ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat mbi konsultimet publike të zhvilluara ka qëllim të paraqesë ndikimin e

përgjithshëm të konsultimeve publike gjatë vitit të kaluar (apo gjashtë muajve), por gjithashtu, të tregojë nivelin e hapjes dhe transparencës së institucioneve publike, rekomandohet struktura e mëposhtme e pjesës narrative të raportit vjetor (shih udhëzime më të hollësishme në Shtojcën 5a):

-
1. Përbledhja ekzekutive
 2. Analiza e konsultimeve të kryera në (gjashtë muaj) një vit
 - 2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike
 - 2.2. Metodat e konsultimit
 - 2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve
 - 2.4. Palët e interesit të përfshira
 - 2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra
 - 2.6. Raportet mbi konsultimet
 - 2.7. Vetëvlerësimi i ministrisë/institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e Ligjit për njoftim dhe konsultimet publike (bazuar në kartelën në Shtojcën 5c)
 3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësítë për të ardhmen
-

Përveç raportit narrativ, pasqyra e të gjitha të dhënavë përkatëse në Raportin gjashtë-mujor dhe vjetor mbi Konsultimet Publike duhet të pasqyrohet dhe në tabelë me kategoritë e mëposhtme:

- Numri
- Lloji i Aktit
- Titulli i Projekt-Aktit
- Projektligjet me raportin VNR-së
- Aktet e përfshira në a) Programin Analistik, b) PKIE, c) Dokumentet strategjike të sektorit
- Akti është konsultuar (Po ose Jo / arsyen për përjashtime)
- Numri i aktorëve joqeveritarë të emëruar si anëtarë të organeve këshillimore ose grupevetë punës për hartimin e aktit
- Metodat e konsultimit
- Numri i pjesëmarrësve në procesin e konsultimit
- Numri i pjesëmarrësve kontribues
- Numri i komenteve të pranuara
- Numri i komenteve të miratuaraplotësish
- Numri i komenteve të miratuarar pjesërisht
- Numri i komenteve të refuzuara
- Numri i raporteve të VNR-së që u ndryshuan/përditësuan bazuar në informacionin/të dhënat e marra gjatë konsultimit publik
- Kohëzgjatja e procesit të konsultimit
- Publikimi i raportit të konsultimit

- *Pikët e performancës institucionale - Indeksi i cilësisë së konsultimeve*

Udhëzime të hollësishme për plotësimin e kësaj tabele jepen në Shtojcën 5 të këtij Udhëzuesi.

PËRGATITJA E RAPORTIT TE PERFORMANCES (GJASHTË-MUJOR) VJETORE (GJITHPERFSHIRESE) E QEVERISË QENDRORE PËR KONSULTIMET PUBLIKE

Përgatitja e raportit vjetor të performancës mbi rezultatet e konsultimeve publike është një hap i rëndësishëm në ndërtimin e një sistemi të unifikuar monitorimi, raportimi dhe vlerësimi të konsultimeve të kryera publike dhe demonstrimin e ndikimit të përgjithshëm të pjesëmarrjes së publikut në proceset e hartimit të politikave.

Investimi i përpjekjeve shtesë në shtjellimin se në çfarë mase janë marrë parasysh kontributet nga qytetarët, OSCH-të, bizneset dhe përfaqësuesit e tjerë të publikut të interesuar gjatë vitit të kaluar, paraqet një hap të rëndësishëm në ndërtimin e besimit të publikut.

Mbledhja, analiza dhe prezantimi sistematik i të dhënavës përkatëse mbi produktet dhe rezultatet e konsultimeve publike të kryera nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat sjell një kuptim dhe vlerë shtesë për angazhimin e qytetarëve dhe palëve të interesit, por gjithashtu forcon potencialin për një kontroll qendror efektiv të cilësisë së konsultimeve dhe përhapjes së kulturës së hartimit të politikave të bazuara në të dhëna/evidenca.

Vëmendja gjithnjë e më e madhe tek transparenca e bërjes së politikave është në përputhje me reformat në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, veçanërisht në kontekstin e kërkesave për reformën e administratës publike, mirëqeverisjen, sundimin e ligjit, si dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

Baza për zhvillimin e raportit vjetor të performancës për konsultimet publike duhet të ndërtohet gjatë gjithë vitit, përmes koordinimit sistematik dhe monitorimit të konsultimeve publike të kryera nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat dhe duke u siguruar që çdo konsultë individuale publike të mbështetet nga raporte të qendrueshme, prova të rëndësishme dhe burime të verifikueshme të informacionit.

Për të mundësuar një matje më të avancuar të progresit për zbatimin e standardeve të konsultimit publik, pasaporta e treguesve është përfshirë në Shtojcën 6a, duke siguruar një përshkrim të hollësishëm metodologjik të matjes së secilit tregues kryesor të performancës.

Qëllimi është të sigurohen detaje të mëtejshme operacionale në lidhje me mbledhjen e të dhënavës dhe kërkesën e matjes dhe procesin e treguesve për të arritur një monitorim efektiv të progresit. Zbatimi i një sërë treguesish duhet të sigurojë një bazë të fortë për forcimin e kornizës së monitorimit dhe të bëjë të mundur përgatitjen e një progres raporti vjetor për zbatimin e standardeve të konsultimeve publike.

Është e rëndësishme të përcaktohen qartë kërkesat specifike të të dhënavës, procesi i llogaritjes dhe metodat e secilit tregues, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe zyrtarëve në këtë proces, veçanërisht bashkëpunimi midis Kryeministrisë dhe ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit.

Procesi i përgatitjes së raportit vjetor të performancës për konsultimet publike

Përgatitja e raportit vjetor të performancës për konsultimet publike duhet të bazohet në një koordinim të ngushtë të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes (DZHM) dhe

Departamentit Rregulator dhe Përputhshmërisë (DRRP) dhe ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit.

Tabela më poshtë jep një përbledhje të hapave/aktivitetave kryesore në përgatitjen e raportit vjetor të performancës për konsultimet publike.

Aktiviteti	Afati
DZHM dërgon kërkesa tek ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit për të dorëzuar raporte (gjashtë-mujor) vjetore mbi konsultimet publike sipas modelit të dakordësuar	31 dhjetor për raportet vjetore
Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit i dërgojnë projekt-raportet (gjashtë-mujor) vjetore DZHM/DRRP për komente	20 janar për raportet vjetore
DZHM dërgon projekt-raportin në DRRP për komente të mundshme	24 janar për raportet vjetore
DZHM/DRRP u dërgon ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit komentet mbi projekt-raportet	25 janar për raportet vjetore
Raportet (gjashtë-mujor) vjetore të miratuara nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit i dërgojnë DZHM/DRRP përmes njoftimit zyrtar dhe linket e publikuara në regjistrin elektronik dhe faqen e internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit	31 janar për raportet vjetore 25 korrik për raportet gjashtë-mujore
DZHM/DRRP përgatit një raport të plotë vjetor mbi konsultimet e kryera publike, bazuar në raportet (gjashtë-mujor)/vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit	10 shkurt për raportin vjetor
DZHM/DRRP finalizon raportin vjetor të performancës për konsultimet e kryera publike	15 shkurt për raportin vjetor

Pasi miratohet, raporti vjetor i performancëspër konsultimet publike publikohet gjerësisht përmes Regjistrit Elektronik për Njoftim dhe Konsultimet Publike dhe mjeteve të tjera të rëndësishme të komunikimit.

Cilësia e raportit vjetor të konsultimit të qeverisë qendrore varet kryesisht nga qendrueshmëria e mbledhjes së të dhënave nga secili konsultim publik i kryer, gjatë vitit dhe për secilën metodë të konsultimit, si dhe nga cilësia e raporteve individuale për rezultatet e konsultimeve mbi projekt-aktet. Prandaj, u rekomandohet ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit të mbajnë dhe përditësojnë vazhdëmisht bazat e të dhënave për secilin konsultim individual. Kjo gjithashtu, përfshin konsultimin paraprak me palët e interesit mbi projekt-raportet e VNR-së, qoftë përmes takimeve me grupe ekspertësh dhe shoqata përfaqësuese në terren ose përmes konsultimeve paraprake të hapura me publikun.

Struktura e raportit vjetor të performancës për konsultimet publike

Bazuar në raportet e marra (gjashtë-mujore) vjetore të ministritive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit për konsultimin, si dhe treguesit kryesorë të zgjedhur të performancës, por gjithashtu, duke marrë parasysh komentet e mundshme të DZHM/DRRP (në lidhje me konsultimet e mbajtura mbi raportet e VNR-së), DZHM/DRRP përgatit projekt-raportin vjetor të performancës i cili duhet të ndjekë strukturën e përgjithshme të dhënë më poshtë, në përputhje me treguesit kryesorë të përcaktuar në Shtojcën 6a.

1. Hyrje
2. Shpeshtësia e konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitë
3. Numri i konsultimeve publike për projektligjet me VNR
4. Shpeshtësia e përdorimit të kriterieve të përjashtimit/përjashtimeve nga konsultimet publike për akte në a) Programin Analistik, b) PKIE, c) dokumentet strategjike sektoriale
5. Kohëzgjatja e konsultimeve publike për projektligjet, dokumentet strategjike dhe të politikave
6. Përdorimi i Regjistratit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për konsultime mbi projektligjet dhe strategjitet
7. Organizimi i takimeve publike si mjet i konsultimit publik mbi projektligjet dhe strategjitet
8. Shkalla e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, joqeveritarë të përfshirë në hartimin ose konsultimet mbi projektligjet, dokumentet strategjike dhe politikat si anëtarë të grupeve të punës/organeve këshillimore
9. Numri i pjesëmarrësve që kontribuojnë në konsultimet publike për projektligjet dhe strategjitet me komentet dhe rekomandimet e tyre
10. Raportimi mbi rezultatet e konsultimeve - përgjegjësia institucionale ndaj komenteve/rekomandimeve të marra për konsultimet publike mbi projektligjet dhe strategjitet
11. Shkalla e pranimit të kontributeve të palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitet
12. Numri i raporteve të VNR-së që u ndryshuan/përditësuan bazuar në informacionin/të dhënët e marra gjatë konsultimit publik
13. Performanca institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftim dhe konsultimet publike
14. Niveli i kënaqësisë së palëve të interesuara/publikut me cilësinë e procesit të konsultimit publik
15. Konkluzione dhe rekomandime

Treguesit kryesorë të performancës për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik

Raporti vjetor i performancës për konsultimet publike të kryera, duhet të bazohet në treguesit kryesorë të performancës që janë përfshirë në këtë Udhëzues, bazuar në praktikat e mira evropiane dhe ndërkombëtare. Qëllimi i pasaportës së treguesve të dhënë në Shtojcën 6a, është të përcaktojë listën e treguesve për një matje më të avancuar të progresit në zbatimin e

standardeve të procesit të konsultimit publik, së bashku me përshkrimin e hollësishëm metodologjik të matjes së treguesve të vendosur.

Kjo metodologji siguron një bazë për përgatitjen e progres raportit vjetor të performancës për konsultimet e zhvilluara publike, duke marrë parasysh treguesit kryesorë më të përpunuar të performancës.

Monitorimi i progresit të ministrive/institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit në përbushjen e treguesve të vendosur kërkon një koordinim të avancuar të politikës qendrore DZHM/DRP, veçanërisht në lidhje me sigurimin e një bazemë sistematike të të dhënave.

Treguesit e mëposhtëm janë propozuar për të matur progresin në zbatimin e standardeve të konsultimeve publike në periudhën e ardhshme:

- Indeksi i frekuencës së konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitet
- Numri i konsultimeve publike të kryera për projektligjet me VNR
- Indeksi i përdorimit të kriterieve të përjashtimit/përjashtimet nga konsultimet publike për akte në Programin Analistik,
- Indeksi i përdorimit të kriterieve të përjashtimit/përjashtimet nga konsultimet publike për akte në PKIE
- Indeksi i përdorimit të kriterieve të përjashtimit/përjashtimet nga konsultimet publike për akte në strategjitet sektoriale (matje e veçantë për kategorinë)
- Niveli i përputhshmërisë me kohëzgjatjen e kërkuar të konsultimeve publike për projektligjet, dokumentet strategjike dhe politikat
- Indeksi i përdorimit të Regjistrat Elektronik për Njoftim dhe Konsultimin Publik për konsultime mbi projektligjet dhe strategjitet
- Indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike si mjet i konsultimit publik mbi projektligjet dhe strategjitet
- Shkalla e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, joqeveritarë si anëtarë të emëruar të grupeve të punës/organeve këshillimore në hartimin dhe/ose konsultimet mbi projektligjet, dokumentet strategjike dhe politikat
- Numri i pjesëmarrësve që kontribuojnë në konsultimet publike për projektligjet dhe strategjitet me komentet dhe rekomandimet e tyre
- Indeksi i përgjegjësisë institucionale ndaj komenteve/rekomandimeve të marra për konsultimet publike mbi projektligjet dhe strategjitet
- Shkalla e ndikimit (pranimit) të kontributeve të palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik mbi projektligjet dhe strategjitet
- Indeksi i performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftim dhe konsultimet publike
- Numri i raporteve të VNR-së që u ndryshuan/përditësuan bazuar në informacionin/të dhënat e marra gjatë konsultimit publik
- Niveli i kënaqësisë së publikut me cilësinë e procesit të konsultimit publik

Për secilin tregues përfshihen elementët e mëposhtëm:

- Titulli i treguesit

- Lloji i treguesit (Ndikimi/produkti/rezultati)
- Referenca me dokumentet strategjike të sektorit
- Referenca e lidhur me shtyllën e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)
- Referenca te qëllimi i politikës së lidhur me strategjitet sektoriale
- Referenca me objektivin specifik të dokumentit strategjik (nëse ka)
- Burimi i monitorimit të treguesve të performancës (p.sh. raportet e vlerësimit, faqet e internetit, etj.)
- Institucioni kryesor (njësia, drejtoria) përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e treguesit, si dhe institucionet pjesëmarrëse
- Përshkrimi i metodologjisë së matjes së treguesit
- Frekuencia e Matjes, si për vlerën aktuale, ashtu edhe për vlerën e synuar sipas raportimit dhe monitorimit
- Natyra e Treguesit (Kumulative/Rritëse ose Aggregate)
- Formula për llogaritjen e vlerës së treguesve (vetëm për treguesit aggregatë)
- Ndarja e të dhënave (Treguesit përbledhës)
- Vlerat fillestare dhe të synuara (sipas vitit)
- Referenca te Qëllimet e Zhvillimit të Qendrueshëm (QZHQ)
- Fushat e tjera të lidhura me Standartet

SHTOJCA

Shtoja 1: Udhëzues për përgatitjen e Planit Vjetor të Konsultimeve Publike

Hyrje

Zhvillimi i një qasje të integruar për planifikimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike për projekt-iniciativat ligjore dhe politike është një hap thelbësor në përmirësimin e transparencës, hapjes dhe gjithëpërfshirjes së zhvillimit dhe koordinimit të politikave, si një nga komponentët kryesorë të reformës së administratës publike në procesin e pranimit në BE.

Me qëllim sigurimin e planifikimit në kohë të burimeve të përshtatshme të nevojshme për zbatimin e konsultimeve publike, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit pritet të hartojnë një plan vjetor indikativ të konsultimeve publike. Plani vjetor duhet të harmonizohet me Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve Vjetore, i cili ofron një përbledhje të akteve përmes të cilave, qeveria synon të zbatojë programin e qeverisë, Planin Kombëtar për Integrin Evropian, angazhimet ligjore kombëtare dhe ndërkontinentale të bëra në vitet e kaluara, dhe strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale.

Duke marrë në konsideratë një sërë sfidash në zbatimin e konsultimeve publike në përputhje me kërkesat e ligjit nr.146/2014, "Mbi njoftimin dhe konsultimin publik", si dhe performancën ende të papërshtatshme në lidhje me treguesit e pritshëm të cilësisë së konsultimeve publike, si komponent i rëndësishëm i monitorimit të reformës së përgjithshme të administratës publike, përgatitja në kohë e Planit Vjetor të Konsultimeve Publike do të mundësonte koordinim më të mirë të punës brenda ministrive/institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe mbështetje më efektive nga DZHM/DRRP për zhvillimin e përgjithshëm të ligjeve dhe politikave me ndikim të rëndësishëm ekonomik, financiar, shoqëror dhe mjedisor.

Për më tepër, diskutimi i ardhshëm mbi Planin Vjetor të Konsultimeve Publike, së bashku me Programin Analistik në forume këshillimi të nivelit të lartë, të tilla si Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave, Komitetet Drejtuese Sektoriale dhe Grupet Tematike, do të konsideroheshin një vlerë e shtuar në procesin e përmirësimit të kapaciteteve për zhvillimin dhe bashkëpunimin e përgjithshëm të politikave, si parim themelor i reformës së administratës publike.

Ky Udhëzues synon të ndihmojë të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, në hartimin e një Planit Vjetor të mirë të Konsultimeve Publike. Pjesa e parë ka të bëjë me procesin e hartimit të planit vjetor, e dyta sqaron kriteret përfshirjen e akteve në Plan, ndërsa pjesa e tretë jep detaje mbi formatin e planeve vjetore të konsultimeve, për të siguruar një kuptim të harmonizuar të modelit të dhënë dhe e të dhënavë të kërkuar.

Procesi i hartimit të Planit Vjetor

Në përputhje me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave "Për hartimin e Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve", Programi i Përgjithshëm Analistik shërben si bazë për hartimin e Planit Vjetor të Konsultimeve Publike. Prandaj, pas miratimit të Programit Analistik të Projektakteve nga Këshilli i Ministrave gjatë janarit të çdo viti, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, pritet të hartojnë planin vjetor të konsultimeve, së bashku me planin e masave për kryerjen e procesit të vlerësimit të ndikimit. Pas dorëzimit të planeve vjetore të konsultimeve nga të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, DZHM/DRRP ndërkontinentale Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes (DZHM)

përgatit komente dhe sugjerime të mundshme për përmirësimin e planeve. Pas përfshirjes së komenteve të DZHM-së, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat, dërgojnë versionet përfundimtare të planeve të konsultimit tek DZHM-ja. DZHM-ja përgatit versionin përfundimtar të konsoliduar të Planit Vjetor të Konsultimeve Publike, i cili përfshin planet e konsultimit të të gjitha ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat dhe e dërgon atë zyrtarisht në të gjitha institucionet përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

Me qëllim përgatitjen në kohë dhe me efektivitet të konsultimeve publike, afati i përfundimit të hartimit të Planit Vjetor të Konsultimeve Publike parashikohet të jetë brenda 30 ditëve pune nga data e miratimit të Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve.

Gjatë vittit, në mënyrë periodike, DZHM monitoron zbatimin e Planit Vjetor, duke marrë parasysh nevojën për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të procesit të konsultimit publik.

Për secilin prej akteve në Planin Vjetor të Konsultimeve Publike, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat hartojnë një plan individual të konsultimeve publike.

Më poshtë jepet një përbledhje hap pas hapi e procesit të hartimit të Planit Vjetor të Konsultimeve Publike:

1. Pas miratimit të Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve nga Këshilli i Ministrave gjatë janarit të çdo viti, DZHM-ja u dërgon kërkesën të gjitha ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat të paraqesin plane konsultimi vjetor, duke përdorur modelin në dispozicion në Shtojcën 1a të këtij Udhëzuesi.
2. DZHM-ja organizon një takim koordinues (ose seancë *on-line*) me përfaqësues të të gjitha ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, anëtare të rrjetit të koordinatorëve për konsultime publike, me qëllim të sigurimit të një reagimi më efektiv dhe në kohë nga të gjitha këtyre institucioneve.
3. Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat përgatisin planin vjetor të konsultimeve dhe e paraqesin atë pranë DZHM-së.
4. DZHM-ja ofron komente për hartimin e planeve vjetore dhe i paraqet ato DRRP-së për të dhënë mendim.
5. Pas marrjes së mendimit nga DRRP-ja, DZHM-ja përcjell komentet tek ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat, me kërkesën për të paraqitur versionet përfundimtare të rishikuara të planeve vjetore.
6. DZHM-ja përgatit versionin përfundimtar të konsoliduar të Planit Vjetor të Konsultimeve, duke përfshirë planet përfundimtare të konsultimit të të gjitha ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat (me komente të përfshira të DZHM-së) dhe ia dërgon atë zyrtarisht të gjitha këtyre institucioneve, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrisë.
7. Plani Vjetor i konsoliduar i Konsultimeve Publike si dhe plani individual sektorial i konsultimit i ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat publikohen në faqen e internetit të se cilës ministri dhe institucioni qendror, në varësi të Kryeministrat, si dhe në Regjistrin Elektronik për Njoftim dhe Konsultimet Publike, në përputhje me standartet themelore të transparencës, hapjes dhe gjithëpërfshirjes së procesit të zhvillimit të politikave.

Kriteret për përfshirjen e akteve në Plan

Përveç projektligjeve të përfshira në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve, gjatë procesit të përzgjedhjes së akteve, akteve nënligjore ose nismave të politikave strategjike që do të përfshihen në projekt Planin Vjetor të Konsultimeve Publike, ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat duhet të marrin parasysh kriteret e mëposhtme:

- detyrimet e marra në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian;
- detyrimet që rrjedhin nga angazhime të ndryshme ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara më parë;
- detyrimet që rrjedhin nga masa të ndryshme të parashikuara në strategjitet sektoriale dhe ndërsektoriale;
- dispozitat e ligjit nr.146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", veçanërisht kufizimet përkatëse siç parashikohen në nenin 4 të ligjit;
- objektivat e përcaktuara në Programin e Qeverisë;
- përparësitë specifike të Kryeministrat, Këshillit të Ministrave;
- inputet dhe kërkesat nga organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara mund të shërbejnë si burim i rëndësishëm i informacionit për ekzistencën e një interesi të lartë publik për iniciativa të veçanta legislative dhe politike.

Për të vlerësuar nëse një projekt akt duhet të paraqitet për konsultim publik, është e nevojshme të merret në konsideratë një kombinim i kritereve të përjashtimit dhe përfshirjes, të renditura më poshtë:

Kriteret e përjashtimit, të përcaktuara si përjashtime në nenin 4 të ligjit:

- Çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë një sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror";
- Marrëveshje ndërkombëtare, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- Aktet administrative individuale dhe aktet me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;
- Aktet normative me fuqinë e ligjit të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- Emergjencat civile.

Kriteret e përfshirjes shërbejnë si bazë për të vlerësuar nëse projektakti i propozuar është me interes të lartë publik (sipas nenit 1 të ligjit), pra kur:

- ka grupe sociale/ekonomike që do të ndikohen nga politika e propozuar;
- ka organizata/grupe që do të përfshihen në zbatimin e politikës;
- ka organizata/subjekte që duhet të konsultohen në bazë të kërkesave ligjore përfushën e posaçme të politikës;
- ka grupe me interesa/qëllime të shpallura në politikën e propozuar;
- politika e propozuar prezanton detyrime/të drejta/përgjegjësi të reja për qytetarët ose personat juridikë;
- media tregon interes të lartë për çështjen e propozuar.

Kur vendoset se cili projektakt duhet të planifikohet për konsultime publike, përgjegjësia e ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, eshtë të deklarojnë qartë se cilat përjashtime ose kritere përjashtimi zbatohen, por edhe të vlerësojnë/testojnë aktin e propozuar sipas kriterieve të përfshirjes të cilat tregojnë ekzistencën e një interesit të lartë publik.

Formati i planit vjetor të konsultimeve publike

Formati i Planit Vjetor të Konsultimeve Publike përmban një tabelë (excel) me një numër të kategorive të renditura në vijim, të cilat duhet të plotësohen në përputhje me udhëzimet në vijim:

Informacion i përgjithshëm

- 1) **Numri** (numri përfaqëson numrin rendor që shoqëron secilin akt);
- 2) **Lloji i aktit** (vendimet e Këshillit të Ministrave ose ligjet; më konkretisht, për qëllimin e këtij plani, projekt aktet konsiderohen si projektligje dhe projekt-akte nënligjore, psh. dokumentet strategjike me interes të lartë publik);
- 3) **Data e miratimit** (në rast të përditësimet e planit gjatë viteve, vendosni datën e miratimit të aktit);
- 4) **Institucioni propozues** (paraqisni institucionin që propozon aktin);
- 5) **Titulli i projekt-aktit** (ju lutemi vendosni titullin e projekt-aktit të planifikuar për miratim në përputhje me Planin Kombëtar të Integrimit Evropian, si dhe Programin Vjetor Analistik të Përgjithshëm të Projektakteve, dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr.146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik");
- 6) **Koha e pritshme për miratimin e aktit** (ju lutemi shënoni tremujorin e planifikuar të miratimit të aktit);
- 7) **Referencia tek Plani i Përgjithshëm Analistik i Projektakteve** (ju lutemi tregoni nëse projektligji është përfshirë në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve);
- 8) **Referencia tek Plani Kombëtar i Integrimit Evropian** (ju lutemi tregoni nëse projektakti përfshihet në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian dhe në cilin kapitull);
- 9) **Referencia tek strategjitetë sektoriale/ndërsektoriale** (ju lutemi tregoni nëse projektakti përfshihet parashikuar si detyrim sipas ndonjë strategje sektoriale/ndërsektoriale);
- 10) **Periudha e pritshme e zbatimit të konsultimit publik** (ju lutemi vendosni tremujorin e planifikuar (periudhë tre mujore) të zbatimit të konsultimeve publike, duke marrë parasysh kërkesat e ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", më saktësisht, minimumi 20 ditë pune kohëzgjatje për konsultimet publike, si dhe 20 ditë pune për njoftim/ftesë paraprake për takime publike);
- 11) **Aktorët e targetuar** (ju lutemi tregoni palët e interesuara, grupet e synuara, që janë veçanërisht të rëndësishme për konsultimet publike, veçanërisht ata që preken nga politika, ata që do të përfshihen në zbatimin e politikës ose ata që kanë deklaruar objektivat, duke i shndërruar në subjekte me interes të drejtpërdrejtë në politikë);
- 12) **Metodat e konsultimit** (ju lutemi tregoni cilat metoda planifikoni të përdorni gjatë procesit të konsultimit publik, për shembull: konsultime *on-line* përmes Regjistrit Elektronik për Njoftime dhe Konsultime Publike, takime publike, sondazhe, etj.);
- 13) **Kontakti i personit/ave përgjegjës për menaxhimin e konsultimit publik** (për qëllim të koordinimit më të mirë dhe planifikimit të burimeve njerëzore të përshtatshme, ju lutemi tregoni emrin, kontaktet telefonike dhe e-mail të personit përgjegjës për zbatimin e konsultimeve publike).

Kriteret e përjashtimit

- 14) **Çështjet e sigurisë kombëtare**, për aq kohë sa ato përbëjnë një sekret shtetëror, në zbatim të ligjit për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse ky kriter i përashtimit është i zbatueshëm);
- 15) **Marrëveshjet ndërkombe**, marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse ky kriter i përashtimit është i zbatueshëm);
- 16) **Aktet administrative individualë aktet normative**, përvèç kur një ligj specifik parashikohet ndryshe (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse ky kriter i përashtimit është i zbatueshëm);
- 17) **Aktet normative me fuqinë e ligjit** të miratuar nga Këshilli i Ministrave (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse ky kriter i përashtimit është i zbatueshëm);
- 18) **Emergencat civile** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse ky kriter i përashtimit është i zbatueshëm);
- 19) **Argumentim shtesë** (ju lutemi siguron argumentim shtesë për përashtimin nga konsultimet publike që zbatohen në këtë rast);
- 20) **Përashtimi i statusit nga konsultimet publike** është i justifikuar (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar që përashtimi nga konsultimet publike bazohet në një justifikim të fortë);
- 21) **Përqindja e akteve për të cilat aplikohet përashtimi nga konsultimi** (kjo kolonë do të lejojë llogaritjen automatike të përqindjes së akteve për të cilat përashtimi nga konsultimet publike është i zbatueshëm/i justifikuar).

Kriteret e përfshirjes

- 22) **Ekzistenza e grupeve sociale/ekonomike që do të preken nga politika e propozuar** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse keni identifikuar ndonjë grup që do të preket nga opzionet e propozuara të politikës, negativisht ose pozitivisht, për shembull, subjektet e biznesit, sindikatat, OJQ-të, etj. që veprojnë në fushat e përfshira nga kjo politikë);
- 23) **Ekzistenza e organizatave/grupeve që do të përfshihen në zbatimin e politikës** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse ka organizata/grupe që do të përfshihen në zbatimin e politikës së propozuar, për shembull, njësitë e qeverisë vendore, përmes delegimit të kompetencave për ofrimin e shërbimeve të caktuara publike ose organizata të shoqërisë civile që zbatojnë projekte/programe me mbështetje nga buxheti i shtetit, etj.);
- 24) **Ekzistenza e organizatave/subjekteve që duhet të konsultohen për shkak të kërkesave legislative përfshinë e veçantë të politikave** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse akti i propozuar ka të bëjë me fushën e politikave ku ekziston një kërkesë legislative për konsultime publike, për shembull, detyrimet përfshirë të konsultuar me organet e vetëqeverisjes vendore dhe qendrore bazuar në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore ose detyrimet përfshirë të lejuar pjesëmarrjen e publikut në çështjet mjedisore, bazuar në konventën e Aarhus, etj.);
- 25) **Ekzistenza e grupeve me objektiv/interes të theksuar në politikën e propozuar** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse keni identifikuar ndonjë grup që ka shpallur objektiva/interesa në politikën e propozuar, qoftë përfshirë të kështjellës së tyre specifike në atë fushë ose sepse përfaqëson anëtarë/përfitues në atë fushë të politikës);
- 26) **Politika e propozuar prezanton detyrime/të drejta/përgjegjësi të reja për qytetarët ose personat juridikë** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse zgjidhjet e propozuara nga projektakti do të imponojnë ndonjë detyrim, përgjegjësi ose të drejtë të re përfshirë të konsultuar me organet e vetëqeverisjes vendore duke taksa të reja, duke ndryshuar kërkesat përfshirë të profesionin e punonjësve socialë, ose të ngjashme);
- 27) **Interesim i madh i medias për temën e propozuar** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse e njihni interesin e lartë të mediave përfshirë të projektligj / politikën e propozuar);
- 28) **Argumentim shtesë** (ju lutemi jepni argumentim shtesë mbi kriteret përfshirë të zbatueshme);
- 29) **Statusi - Akti konsiderohet të jetë me interes të lartë publik** (ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar se kriteret e aplikueshme të përfshirjes mbështesin ekzistencën e interesit publik dhe ka njëarye tëfortëpërealizimin e konsultimit publik);

30) Përqindja e akteve që konsiderohen me interes të lartë publik (Kjo kolonë lejon llogaritjen automatike të përqindjes së akteve për të cilat është përcaktuar interes i lartë publik bazuar në vlerësimin e kritereve përfshirëse).

Rekomandimi përfundimtar

- 31) Rekomandimi Përfundimtar** - Akti rekomandohet për konsultim publik (bazuar në vlerësimin e kritereve ekskluzive dhe përfshirëse, ju lutemi thoni po/jo për të konfirmuar nëse akti rekomandohet për konsultime publike);
- 32) Përqindja e akteve të rekomanduara për konsultim publik** (kjo kolonë llogarit automatikisht përqindjen e të gjitha akteve të rekomanduara për konsultim publik).

Shembulli i strukturës së tabelës excel që përmban të gjitha këto kategori tregohet më poshtë.

Model-Plani vjetor i konsultimeve publike

Shtojca 2: Modeli i Planit të Konsultimit Publik

1. Emri i aktit/politikës së propozuar:
2. Audiencia e synuar, lloji i konsultimeve (paraprak për projekt-aktet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

Audiencia e synuar	Lloji i konsultimeve: (1) konsultime paraprake, (2) konsultime për projekt-aktet	Metodat e konsultimit	Kanali i komunikimit për ftesat dhe shkëmbimin e informacionit
P.sh. Dhomë(t) e tregtisë	1 & 2	Takime individuale, seminare, konsultim me shkrim	Email

3. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri te raportimi)

Rendisni të gjitha aktivitetet e parashikuara të konsultimit me datën e përafërt të implementimit.

4. Burimet e kërkua

Përvashkuani nr. e personelit të kërkuar, mjetet e kërkua financiare, teknike etj.

5. Mbledhja e përgjigjeve

Përvashkuani si do të grumbulloni përgjigjet.

6. Monitorimi i procesit

Kjo matricë mund t'ju ndihmojë në monitorimin e vazhdueshëm, pasi përfshin treguesit dhe metodat më të zakonshme për matjen e nivelit të suksesit të proceseve të konsultimit. Në fazën e planifikimit, ju duhet të përcaktoni vlerën e planifikuar të treguesve sasiorë dhe metodave/mjetet që do të përdorni për të matur suksesin gjatë dhe në fund të procesit.

Treguesit dhe metodat për monitorimin e procesit		
Kuadri i procesit	Përshtatshmëria	Masat për përmirësimë (gjendja, si do ta përmirësoni procesin e pjesëmarrjes)
A u zbatuan aktivitetet sipas planit kohor të planifikuar?	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
A u zbatuan aktivitetet sipas burimeve të planifikuara financiare?	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
A u zbatuan aktivitetet sipas burimeve njerëzore të planifikuara?	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
Treguesit sasiorë		

Treguesit sasiorë <i>(përcaktimi i treguesve përmirësimi)</i>	Vlera e planifikuar <i>(përcaktimi i vlerës së treguesve)</i>	Vlera e arritur <i>(përcaktimi i vlerës së arritur)</i>	Përshtatshmëria	Masat përmirësimi <i>(gjendja, si do ta përmirësoni performancën)</i>
<i>(plotësoni në fazën e planifikimit të procesit)</i> <i>(plotësoni gjatë monitorimit)</i>				
<input type="checkbox"/> numri i metodave të konsultimit			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> numri i palëve të interesuara të përfshira			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> numri i pjesëmarrësve në aktivitet			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> numri i komenteve të marra			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> të tjera:			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
Mjetet përmirësimi				
<input type="checkbox"/> lista e pjesëmarrësve				
<input type="checkbox"/> raporti i aktivitetit				
<input type="checkbox"/> raporti i reagimeve				
<input type="checkbox"/> lista e komenteve të marra				
<input type="checkbox"/> të tjera:				
Treguesit cilësorë				
Treguesit cilësorë (zgjidhni treguesit cilësorë - merrni parasysh objektivat e procesit të pjesëmarrjes)	Gjetjet <i>(shprehni gjetjet tuaja)</i>		Masat përmirësimi <i>(gjendja, si do ta përmirësoni performancën)</i>	
<input type="checkbox"/> cilësia e metodave të konsultimit				
<input type="checkbox"/> përbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve				
<input type="checkbox"/> cilësia e komenteve dhe kontributeve të marra				
<input type="checkbox"/> treguesit sipas objektivave të procesit:				
Mjetet përmirësimi				
<input type="checkbox"/> pyetësori i vlerësimit				
<input type="checkbox"/> diskutim joformal me pjesëmarrësit				
<input type="checkbox"/> regjistrim i pikëpamjeve të pjesëmarrësve				
<input type="checkbox"/> raporti i aktivitetit				
<input type="checkbox"/> të tjera:				

Shtoja 3: Model për bazën e të dhënave të paletëve të interesit/ekspertëve

BAZA E TËDHËNAVE PËR PALËT E INTERESIT/EKSPERTËT LIDHUR ME KONSULTIMET PUBLIKE PËR PROJEKTAKTET DHE POLITIKAT E MINISTRISË

Shtojca 4: Modeli për Shënimin Shpjegues të Dokumentit të Konsultimit për Shpalljen e Projekt-Akteve

DOKUMENTI I KONSULTIMIT

Për projektligjin për _____

Përcaktoni kë do të ftoni të kontribuojë në konsultimin publik:

(Përcaktoni/shkruani kujt grupi i drejtosheni (veçanërisht) - për shembull: "Ministria e _____ po fton qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, sektorin e biznesit, komunitetin akademik dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar të kontribuojnë në konsultimet publike përprojektligjin për ndryshimet e ligjit për _____)

Kohëzgjatja e konsultimeve:

(Përcaktoni kohëzgjatjen e saktë të konsultimit publik ("Konsultimi publik do të zgjasë _____ ditë pune, nga _____ deri në _____. _____. 202_____.

Si duhet të përgjigjen:

(Shkruani se si mund të përgjigjen palët e interesuara/publiku në konsultime, për shembull: duke plotësuar formularin on-line në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP); duke plotësuar pyetësorin në internet, në dispozicion në adresën: _____; duke dërguar komente përmes postës elektronike: _____ (duke përdorur formularin online të disponueshëm në faqen e internetit të Ministrisë: _____); duke dërguar komente përmes postës së rregullt në adresën: _____; duke ndarë komente gjatë takimeve rajonale që do të mbahen sipas orarit vijues _____...)

Kontakti:

(Detajet e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultim publik dhe/ose të ndonjë personi tjeterë të cilit mund t'i bëhen pyetje apo t'i kërkohet informacion)

Datat dhe vendet e takimeve publike:

(Siguroni informacionin nëse planifikohen të organizohen takime publike)

Historiku i propozimit legjislativ

(Përshkruani pse ekziston nevoja për aktin e propozuar/të ndryshuar, dmth cila është gjendja aktuale, si rregullohet, cilat janë sfidat ekzistuese, problemet dhe mangësitë e praktikës dhe rregullit ekzistues, çfarë është bërë në të kaluarën.)

Propozimet

(Rendisni dhe përshkruani në një mënyrë të shkurtër dhe të përbledhur të gjitha propozimet dhe ndryshimet që dëshironi të paraqisni përmes projektaktit. Përdorni një gjuhë të thjeshtë.)

Pyetjet

(Rendisni pyetjet për të cilat po kërkoni reagime. Ato mund të kenë të bëjnë me propozimet tuaja (p.sh. 'A jeni dakord me propozimin për të ...', 'A jeni dakord që të ndërmerren veprime të mëtejshme për të parandaluar/rritur ...', 'A jeni dakord që ne ta kthejmë këtë në një vepër penale ...', 'A jeni dakord me përkufizimin tonë të ri', etj.) ose të përdoren thjesht për të mbledhur të dhëna shtesë që kërkoni (p.sh. 'Cili do të ishte ndikimi i propozimeve tona në biznesin tuaj, organizatat', 'A ka organizata juaj...?' etj.) Ju mund ta kufizoni gjatësinë e përgjigjeve për pyetjet individuale (p.sh. deri në 250/500 fjalë).

Shtojca 5: Udhëzues për ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit për përgatitjen e Raportit (gjashtë-mujor) Vjetor Sektorial për Konsultimet Publike

Hyrje

Raporti për rezultatet e konsultimeve publike për projektaktet ligjore dhe politike konsiderohet të jetë një nga hapat më thelbësorë që e bën procesin e konsultimit publik kuptimplotë dhe ka një ndikim të madh në besimin e qytetarëve në punën e organeve publike. Cilësia e reagimit të qeverisë ndaj inuteve dhe kontributeve të pranuara nga publiku i interesuar ka një ndikim të drejtpërdrejtë në motivimin dhe gatishmërinë e palëve të interesuara për të marrë pjesë në konsultime të hapura.

Përveç raporteve individuale të konsultimeve të përgatitura nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit për projektakte të ndryshme, ka pritshmëri në rritje nga qeveritë për të paraqitur ndikimin e përgjithshëm të konsultimeve publike në nivelin (gjashtë-mujor) vjetor dhe të shtjellojnë deri në çfarë mase kontributet nga qytetarët, OSHC-të, bizneset dhe përfaqësuesit e tjerë të publikut të interesuar janë marrë parasysh gjatë vitit të kaluar. Kjo është theksuar veçanërisht në kontekstin e procesit të pranimit në BE të vendeve kandidate dhe kërkeseve të reja të monitorimit të përparuar të progresit në fushën e reformës së administratës publike, veçanërisht në lidhje me cilësinë e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, por edhe të lidhura në cilësinë e mjedisit mundësues për punën dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

Ky Udhëzues synon të ndihmojë ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, në përbushjen e kërkeseve specifike të raportimit gjashtë-mujor dhe vjetor për konsultimet publike të kryera, si dhe të nxjerrë në pah aspektet kryesore që do të mbulohen nga raportet (gjashtëmujo) vjetore me model të sugjeruar që do të përdoren për këtë qëllim. Në pjesën e parë, do të sqarohet baza juridike për raportimin (gjashtëmujo) vjetor të ministrive dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, dhe më pas do të shtjellohet procesi i përgatitjes së raporteve (gjashtëmujo) vjetore, si dhe metoda e pikëzimit për matjen e cilësisë së performancës institucionale të ministrive dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Kjo do të ndiqet nga shpjegimi i formatit të raportimit me shtojcat përkatëse, që përbajnjë modelin e pjesëve përshkruuese të raportit (gjashtëmujo) vjetor, modelin për përbledhjen e të dhënave mbi konsultimet e kryera nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit, si dhe një model për raportet individuale të konsultimeve për projektaktet.

Kërkesat ligjore për përgatitjen e raporteve për konsultimet publike

Detyrimi ligjor i ministrive dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit për të përgatitur raporte vjetore për konsultimet publike përcaktohet në nenin 20 të ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i cili përcakton që organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe publikojnë raportet vjetore për transparencën e procesit të vendimmarrjes, të cilat duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- Numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës, gjatë vitit përkatës;
- Numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;

- Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- Numrin e takimeve publike të organizuara.

Raporti vjetor duhet të publikohet në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimet Publike dhe faqet e internetit të ministritive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit, por gjithashtu të shpërndahet në përputhje me nenin 11 të ligjit.

Përgatitja e raportit (gjashtëmujor) vjetor duhet të bazohet në të dhënrat e mbledhura nga raportet individuale të ministritive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit, të përgatitura për secilin prej akteve në kompetencën e ministritive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit, që janë miratuar ose për të cilat janë kryer konsultimet publike gjatë vijit (ose gjatë muajve në rastin e raporteve gjashtëmujore).

Cilësia e raporteve (gjashtëmujore) vjetore në masë të madhe varet nga cilësia e raporteve individuale të konsultimit për projektaktet dhe monitorimi sistematik i procesit të konsultimit publik. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se neni 19 i ligjit parashikon që projektaktet e paraqitura në Këshillin e Ministrave duhet të shoqërohen me raport individual, duke përfshirë një përbledhje të rekomandimeve të pranuara. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk pranohen, atëherë organi publik duhet të sigurojë arsyë të përbledhura të mospranimit dhe të informojë palët e interesuara në lidhje me të, përmes shpërndarjes së raportit.

Rregullorja e Këshillit të Ministrave përcakton që, në rastin e projektakteve, të cilat duhet të konsultohen me publikun, ministritë janë të detyruara të përgatisin një Shënim Shpjegues, i cili duhet të përbajë informacione për: “*personat dhe institucionet që kanë kontribuar në plotësimin e draftit, shpjegimet në lidhje me identifikimin e palëve të interesuara pjesëmarrëse në konsultim, kohëzgjatjen e procesit të konsultimit, çështjet e diskutuara dhe komentet e shprehura nga palët e interesuara, si dhe përfshirjen ose jo të komenteve të palëve të interesuara në projektin*” (pikat 18, shkronja “b” dhe 19, shkronja “ë”, të Rregullores).

Përveç raportit për rezultatet e konsultimeve publike të kërkua nga ligji, shënim i shpjegues duhet të shoqërohet me informacion në lidhje me pajtueshmërinë sipas kërkesave të ligjit për njoftimin dhe procesin e konsultimit publik, në përputhje me formatin e parashikuar në Shtojcën 1 të Udhëzuesit. Të gjitha këto dokumente shërbejnë si burim i dobishëm i të dhënavë për raportin (gjashtëmujor) vjetor. Në mënyrë të veçantë, Shtojca 1 përcakton formatin e informacionit mbi pajtueshmërinë me ligjin e njoftimit dhe konsultimin publik, duke përfshirë si vijon: emrin e ligjit; nëse ligji është subjekt i konsultimit publik dhe nëse jo, pse; emri i koordinatorit të konsultimit publik; forma e njoftimit; palët e përfshira në konsultimin publik; forma e konsultimit (marrja e komenteve dhe rekomandimeve); afati i paraqitjes së komenteve dhe rekomandimeve; A ka pasur ndonjë zgjatje/përsëritje të konsultimit; rishikimi i komenteve dhe rekomandimeve; publikimi i raportit për transparencën në procesin e vendimmarrjes; shqyrtimi i ankesave. Më poshtë jepet tabela e të dhënavë që gjendet në Shtojcën 1 të Rregullores së procedurave, ku plotësohet informacioni mbi raportin e publikuar.

ProjektLigji	Ligji është	Koordinatori	Forma e njoftimit	Palët e përfshira në	Forma e konsultimit	Afati i dorëzimit të	A ka pasur ndonjë	Shqyrtimi i komenteve	Raport mbi transparencën	Shqyrti mi i
--------------	----------------	--------------	----------------------	-------------------------	------------------------	-------------------------	----------------------	--------------------------	-----------------------------	-----------------

subjekt i konsultimit publik (Nëse jo, pse?)	Konsultimeve publike (Neni 10)	(Neni 11 paragrafi 1)	konsultimet publike (Neni 8)	(marrja e komenteve dhe rekomandimeve) (Neni 11 paragrafi 2)	komenteve dhe rekomandimeve (Neni 15)	zgjatje / përsëritje (Neni 16)	dhe rekomandimeve (Neni 16)	në procesin e vendimmarjes (Neni 20)	ankesave, nëse ka (Neni 21)
Neni 4 paragrafi 1)									

Raportet individuale për projektaktet si bazë për përgatitjen e raporteve (gjashtëmuore) vjetore

Meqenëse ligji vë theksin në përbledhjen e rekomandimeve të pranuara, kjo nënkupton që raportimi duhet të ndjekë qasjen e “grupimit” për analizën e komenteve të marra dhe raportimin e komenteve të pranuara/refuzuara si në raportet individuale të konsultimit dhe në raportet (gjashtëmuore) vjetore.

Për qëllim të demonstrimit të ndikimit të konsultimeve publike, pjesa më e rëndësishme e raportit individual për secilin projektakt është përbledhja e komenteve të marra dhe veçanërisht arsyetimi i komenteve të refuzuara. Komentet mund të paraqiten kolektivisht, pasi ato grumbullohen dhe merren në konsideratë.

Meqenëse raportet mbi rezultatet e konsultimeve për akte individuale sigurojnë bazën e raportit (gjashtëmuor) vjetor të ministrike dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat për konsultimet publike, është e rëndësishme që të harmonizohet përbajtja e të gjitha raporteve. Më poshtë jepet përbledhja e përbajtjes së **raportit të konsultimeve individuale** për secilin projektakt, në përputhje me rekomandimet e SIGMA-s. Ajo gjendet e bashkangjitur gjithashtu si Shtojca 5d e këtij Udhëzuesi.

1. Titulli i projektaktit
2. Kohëzgjatja e konsultimeve (*specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike*);
3. Metodat e konsultimit (*renditni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura - siç janë konsultimet elektronike, takimet publike, seancat e organeve këshillimore, etj.) dhe ofroni informacione mbi afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse ato janë organizuar*);
4. Palët e interesuara të përfshira (*shënoni të gjitha palët e interesuara, ose organizata ose individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit, duke përfshirë palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit*);
5. Pasqyra e komenteve të marra me arsyetimin e komenteve të pranuara/të refuzuara (*organizoni komentet/propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën; gruponi komente të ngashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për atë*).

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përbilldhni komente identike/të ngashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngashme)	Vendimi (ipranuar/ ipranuar pjesërisht/ i refuzuar)	Justifikimi

Nuk ka ndonjë afat të përcaktuar me ligj për botimin e raportit mbi rezultatet e konsultimeve publike në Regjistrin Elektronik, por rekomandohet botimi dhe shpërndarja e tij për të gjithë kontribuesit para se të dërgohet projektakti në procedurën e miratimit.

Kur projektakti me paketën shoqëruese të materialeve dërgohet nga ministritë në Këshillin e Ministrave për miratim, ai duhet të përfshijë raportin individual të detyrueshëm të konsultimit. DRRP-ja gjithashtu duhet të sigurojë që të gjitha projektaktet të shoqërohen nga raporti i konsultimit.

Procesi i përgatitjes së raportit (gjashtëmujor) vjetor të konsultimit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit

Përgatitja e raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore për konsultimet publike nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit menaxhohet nga koordinatori i caktuar për konsultime publike, me mbështetjen e të gjitha departamenteve përkatëse, proces i cili duhet të kalojë në hapat e mëposhtëm:

Hapat/aktivitetet kryesore për krijimin e raporteve (gjashtëmujor) vjetore të konsultimit

Aktiviteti	Afati
DZHM dërgon kërkesa për ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit për të paraqitur raportet (gjashtëmujor) vjetore	31 dhjetor për raportet vjetore 30 qershori për raportet gjashtëmujor
Koordinatorët në ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit: - mbledhin të gjitha raportet individuale për konsultimet e bëra për projektaktet, si dhe të dhënët për të gjitha aktet e miratuara gjatë vitit përkatës; - sintetizojnë informacionin, sipas kategorive të kërkua të formatin e rekomanduar të raportit (gjashtë-mujor) vjetor (përfshirë të dhëna për e-konsultimet elektronike të organizuara, takime publike, por edhe të dhëna për kontributet e mbledhura përmes seancave të organeve këshillimore	15 janar për raportet vjetore 10 korrik për raportin gjashtëmujor

ose grupeve të punës të mbajtura gjatë procesit të hapur të konsultimeve publike, etj.); -konsultojnë raportet e GMIP-ve ose grupeve tematike para përfundimit të projekt-raporteve (gjashtëmujor) vjetore	
Përgatitja e projekt-raportit (gjashtëmujor) vjetor dhe dërgimi i tij tek DZHM/DRRP për komente	20 janar për raportet vjetore 15 korrik për raportet gjashtëmujore
DZHM/DRRP jepin komente për projekt-raportet	25 janar për raportet vjetore 20 korrik për raportet gjashtëmujore
Miratimi i raportit (gjashtëmujor) vjetor nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratdhë dërgimi i tij tek DZHM/DRRP përmes njofitimit zyrtar	31 janar për raportet vjetore 25 korrik për raportet gjashtëmujore
Publikimi i raportit (gjashtëmujor) vjetor në regjistrin elektronik dhe në faqen e internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat	31 janar për raportet vjetore 25 korrik për raportet gjashtëmujore

Cilësia e raportit (gjashtë mujor) vjetor varet në masë të madhe nga vijimësia e mbledhjes së provave nga secili konsultim publik i kryer gjatë vitit dhe për secilën metodë konsultimi, si dhe nga cilësia e raporteve individuale për rezultatet e konsultimeve për projektligjet. Prandaj, rekomandohet që ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit të ruajnë dhe përditësojnë vazhdimit bazat e të dhënave për çdo konsultim individual, në përputhje me kërkesat e modelit të parashikuar në Shtojcën 5b.

Formati i raporteve të konsultimeve (gjashtë-mujor) vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit

Raporti (gjashtëmujor) vjetor i ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit përbëhet nga: i) Pjesa përshkuesee cila duhet të ndjekë strukturën e unifikuar (Shtojca 5a), si dhe ii) Tabela (Shtojca 5b) e cila përmban të gjitha të dhënat që janë përpunuar dhe shpjeguar më tej në këtë Udhëzues, dhe që duhet t'i bashkëlidhen pjesës përshkuese të raportit.

Meqenëse qëllimi i raportit (gjashtëmujor) vjetor për konsultimet publike e bëra nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit është të paraqesë ndikimin e përgjithshëm të konsultimeve publike gjatë vitit të kaluar (apo gjashtë mujorit), si dhe të demonstrojë nivelin e hapjes dhe transparencës së institucioneve publike, rekomandohet struktura e mëposhtme e pjesës përshkuese të tij:

1. Përbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat, rreziqet dhe mundësitet)

2. Analiza e konsultimeve të kryera në (gjashtë muaj) një vit

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike (Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara për një vit të caktuar në Programin Analistik, PKIE, Dokumente Strategjike Sektoriale)? Sa akte janë konsultuar dhe sa jo? Cilat janë

arsyet kryesore që aktet nuk u konsultuan (nëse ka të tilla) aktet e: a) Programit analistik, b) PKIE-së, c) Dokumentet Strategjike Sektoriale? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka raste të tilla)? Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)? A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)? Sa projektligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

2.2. Metodat e konsultimit (Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? Cilësoni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshillimore, etj.) Cila metodë konsultimi prodhoi numrin më të madh të komenteve? A organizuan ministritë/organet publike konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve (Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjessëkonsultimeve? Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit? A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?)

2.4 Palët e interest të përfshira (Sa palë të interesuara të jashtme, jo-qeveritare u emëruan anëtarë të organeve këshillimore ose grupeve të punës për hartimin e ligjeve, dokumenteve strategjikë dhe politikave të miratuar nga qeveria për vitin e caktuar? Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë të veçantë, OSHC, kompani, etj.) Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të kryera për projektet në një vit të caktuar? Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike - sa individë, sa persona juridikë (kompani, shoqata, etj.)? A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?)

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra (Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra - gjithsej dhe mesatare për çdo konsultim? Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan? Sa raporte të VNR-së u ndryshuan/përditësuan bazuar në inputet nga konsultimet publike? Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?)

2.8. Rezultatet e raporteve të konsultimeve (Sa raporte konsultimesh publikoi ministria? Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?)

Vetëvlerësimi i ministrisë/dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministri në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Për secilin akt që i nënshtronhet konsultimit publik jepni një rezultat bazuar në kartën e rezultateve të hartuar nga SIGMA - Shtojca 5c. Siguroni informacionin për rezultatin mesatar për të gjitha veprimet e ministrisë/organeve publike, në varësi të konsultimeve publike)

3. Sfidat, rreziqet kryesore dhe mundësítë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore, rreziqet dhe mundësítë në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve nga ministria/dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato vitin e ardhshëm?)

Përveç raportit narrativ, përbledhja e të gjitha të dhënavë përkatëse në Raportin (gjashtëmujor) Vjetor të Konsultimeve Publike duhet të prezantohet në tabelë (**Shtojca 5b**) që duhet të plotësohen si më poshtë:

1. **Numri** (numri paraqet numrin rendor që shoqëron secilin akt)

- 2. Lloji i Aktit** (*Ju lutemi specifikoni llojin e projekt-aktit: ligj, rregullore, udhëzim, urdhër, etj.*)
- 3. Titulli i projekt-aktit** (*Ju lutemi vendosni titullin e projekt-aktit të miratuar ose paraqitur për konsultim publik gjatë vitit*)
- 4. Projektligjet me raportin VNR-së** (*ju lutemi thoni nëse ky është një projektligj me raport VNR-je (Po / Jo); për qëllimin e këtij raporti, është e rendësishme të përcaktoni sa projektligje me raporte VNR-je janë konsultuar*)
- 5. Aktet e përfshira në a) Programin Analistik, b) PKIE, c) Dokumente strategjike sektoriale** (*ju lutemi specifikoni nëse aktet janë planifikuar për miratim në programin analistik, PKIE ose strategjitet sektoriale*)
- 6. Akti është konsultuar (Po ose Jo)** – (*Ju lutemi specifikoni nëse projekt-akti është paraqitur për konsultim publik. Nëse akti nuk është konsultuar, pjesa tjetër e formularit nuk plotësohet. Ju lutemi, jepni arsyen pse akti nuk është konsultuar, duke iu referuar përjashtimeve të nenit 4 të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik: a) çështje të sigurisë kombëtare, për sa kohë që ato përbëjnë sekret shtetëror, në zbatim të ligjit për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"; b) marrëveshje ndërkombëtare, marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe; c) akte administrative individuale dhe aktet normative nënligjore, pëveç rastit kur me një ligj specifik parashikohet ndryshe; c) akte normative me fuqi ligjore të miratuar nga Këshilli i Ministrave; d) emergjencia civile; e) raste të tjera përjashtimi të parashikuara me ligj.*)
- 7. Numri i aktorëve jo-qeveritarë të emëruar si anëtarë të organeve këshillimore ose grupeve të punës për hartimin e aktit** (*ju lutemi specifikoni numrin e aktorëve të jashtëm, jo-qeveritarë të caktuar si anëtarë të organeve këshillimore ose grupeve të punës për hartimin e ligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave të miratuara nga qeveria; gjithashtu siguronit listën e palëve të jashtme të interesit që janë emëruar si anëtarë të grupit të punës/organeve këshillimore për hartimin e këtij akti, nëse ka; se cilët palë të jashtme morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit, nëse ka; palët e interesuara të jashtme në këtë kontekst i referohen përfaqësuesve të palëve të interesuara jo-shtetërore, joqeveritare, siç janë organizatat e shoqërisë civile, ndërmarrjet, universitetet, ekspertët/konsulentët individualë, etj. Informacioni për përfshirjen e hershme të përfaqësuesve të publikut të interesuar në grupet e punës për hartimin e aktit është tregues shumë i rendësishëm i hapjes dhe gjithëpërfshirjes së përgjithshme të procesit të hartimit të politikave dhe gjithashtu mund të shërbejë si faktor i rendësishëm shpjegues përmungesën e interesit të disa palëve të interesuara më vonë në fazat e konsultimeve të hapura publike*)
- 8. Metodat e konsultimit** (*Ju lutemi vendosni shenjën X për secilën nga metodat e përmendura të përdorura gjatë konsultimeve publike - Regjistri elektronik, takimet publike, posta elektronike; komiteti konsultativ, ose specifikoni metoda të tjera, nëse ka*)
- 9. Numri i pjesëmarrësve në procesin e konsultimit** (*Ju lutemi specifikoni numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve në të gjitha metodat e konsultimit; vini re se për qëllimin e këtij raporti, "pjesëmarrësit" trajtohen ndryshe nga "pjesëmarrësit kontribues"; domethënë, gjatë takimeve publike ose seancave të komitetave këshillimore të mbajtura gjatë konsultimit publik të hapur, mund të ketë 100 pjesëmarrës, por vetëm 5-6 prej tyre në të vërtetë kontribuojnë me komente; gjithashtu, ju lutemi marrësit e njoftimeve me postë elektronike për pjesëmarrje në*

konsultime tē hapura ose ata që ftohen pēr tē marrē pjesë nē procesin e konsultimit, nuk trajtohen si pjesëmarrës)

10. **Numri i pjesëmarrësve kontribues** (*Ju lutemi specifikoni numrin e palëve tē interesuara që kontribuan nē konsultimin e hapur publik me komentin/et e tyre, përmes ndonjë prej metodave tē konsultimit*)
11. **Numri i komenteve tē marra** (*Ju lutemi specifikoni numrin e komenteve tē marra përmes takimeve publike dhe ato me shkrim deri nē afatin e përcaktuar nē ftesën zyrtare pēr tē marrē pjesë nē konsultime publike; ju lutem vini re se komentet/rekomandimet e vlerësuara zakonisht organizohen nē bazë tē çështjes që ato ngritën; komente tē ngashme bashkohen me listën e palëve tē interesuara/kontribuesve që i ngritën ato*)
12. **Numri i komenteve tē aprovuara plotësisht** (*Ju lutemi specifikoni numrin e komenteve dhe rekomandimeve tē palëve tē interesuara që janë miratuar plotësisht*)
13. **Numri i komenteve tē miratuara pjesërisht** (*Ju lutemi specifikoni numrin e komenteve dhe rekomandimeve tē palëve tē interesuara që janë miratuar pjesërisht*)
14. **Numri i komenteve tē refuzuara** (*Ju lutemi specifikoni numrin e komenteve dhe rekomandimeve tē palëve tē interesuara që janë refuzuar*)
15. **Numri i raporteve tē VNR-së që janë ndryshuar/përditësuar nē bazë tē informacionit/ tē dhënavë tē marra gjatë konsultimit publik** (*Ju lutemi specifikoni sa raporte tē VNR-së janë ndryshuar pēr shkak tē konsultimeve publike tē kryera*)
16. **Kohëzgjatja e procesit tē konsultimit** (*Ju lutemi specifikoni datat e fillimit dhe mbarimit tē konsultimeve publike, së bashku me numrin e ditëve tē punës; vini re se data e përfundimit tē konsultimit zakonisht konsiderohet si afati i publikuar zyrtarisht pēr paraqitjen e komenteve*)
17. **Publikimi i raportit tē konsultimit** (*Ju lutemi specifikoni nëse raporti i konsultimit është publikuar (po ose jo); Nëse po, ju lutemi përmendni datën dhe mënyrën e publikimit/shpërndarjes së raportit: pēr shembull, përmes regjistrat elektronik, postës elektronike, faqes së internetit tē ministrisë/dhe institucionet qendrore, nē varësi të Kryeministrit, etj.)*
18. **Pikët e performancës institucionale - Indeksi i cilësisë së konsultimeve** (*Ju lutemi jepni rezultatin e performancës institucionale pēr aktin që i nënshtrohet konsultimeve publike, bazuar nē tabelën e pikëve tē paraqitur nē Shtojcën 5c*)

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit.

1. Përbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësítë)

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

- 2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?
- 2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?
- 2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?
- 2.1.4. Për sa akte në: a) Programin Analistik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tillë)?
- 2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?
- 2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

2.2. Metodat e konsultimit

- 2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)
- 2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?
- 2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

- 2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?
- 2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?
- 2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

2.4. Palët e interesuara të përfshira

- 2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?
- 2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSCH, kompani, etj.)
- 2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimetëhapura të realizuarapër projekt-aktet në vitin e caktuar?
- 2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?
- 2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

- 2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?
- 2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

- 2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*
- 2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?*

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

- 2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*
- 2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njofimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (*Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?*)

Shkoja 5b: Pasqyrë e tabelës së Raportit (gjashtë-mujor) Vjetor të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit për Konsultimet Publike

¹⁻¹ Nëse akti nuk është konsultuar, pjesa tjeter e formularit nuk është e plotësuar. Jo lutemi, jepni arsyen pse akti nuk është konsultuar, duke iu referuar përiqësimeve nga neni 4 i ligjit përi njotim dhe konsultim publik.

2.	Urd hér	Urdhér pérproc edurat e prokuri mit pér blerjen e pajisjeve té sigurisé	Urdhér				Jo pérjashti m sipas nenit 4 (a) Čështje e sigurisé kombétar e	

Shtojca 5c: Tabela e pikëve- Indeksi i cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

Për qëllim të vetëvlerësimit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjt për njoftimin dhe konsultimin publik, më poshtë jepet lista e rezultateve e hartuar nga SIGMA. Kjo **tabelë pikësh** duhet t'i lejojë ministrisë të përcaktojë **një pikë për secilin akt që i nënshtronhet konsultimit publik**, por gjithashtu të sigurojë informacionin për **rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit**, në varësi të konsultimeve publike - në pjesën përshkruese të raportit.

Tabela e pikëve bazohet në vlerësimin e mëposhtëm, i cili është i përbërë nga dy pikë sa i përket cilësisë së performancës institucionale:

- një pikë nëse ekzistojnë prova për përbushjen e kërkesave të ligjt, dhe
- një pikë nëse informacioni është gjithëpërfshirës në nivelin e pritur.

0	1	2	3	4
Asnjë nga elementët nuk u plotësua	1-3 Pikë	4-5 Pikë	6-7 pikë	8 Pikë
Nuk ka asnjë informacion për konsultimin publik të projekt-aktit	Projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit qeveritar, por nuk ka pasur asnjë përfshirje të grupeve të interesit	Projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit qeveritar për të paktën 20 ditë pune, por nuk është hartuar asnjë raport mbi përfshirjen e grupeve të interesit dhe nuk ka prova të mjaftueshme për reagimet e tyre,	Projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raporti për përfshirjen e palëve të interesit dhe ka prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, por nuk ka asnjë informacion nëse reagimet janë reflektuar në projektakt	Projektligjet janë publikuar në sistemin e informacionit qeveritar, jepen informacione të mjaftueshme për konsultime të gjera me palët e interesit; ka prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, një numër i konsiderueshëm i reagimeve të palëve të interesit është pasqyruar në projektakt

Shtojca 5d: Struktura e raportit për rezultatet e konsultimeve publike për projektaktet të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit

1. Titulli i projektaktit

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsyen për shkurtimin e kohëzgjatjes.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshillimore..., dhe siguroni informacione përafatim kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërndi informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshillimore.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmblidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

Shtojca 6: Udhëzues për përgatitjen e raportit të performancës për konsultimet publike

Hyrje

Përgatitja e raportit të performancës për konsultimet publike mbi rezultatet e konsultimeve publike është një hap i rëndësishëm në ndërtimin e një sistemi solid të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të konsultimeve të kryera publike dhe demonstrimin e ndikimit të përgjithshëm të pjesëmarrjes së publikut në proceset e hartimit të politikave. Investimi i përpjekjeve shtesë në shtjellimin se deri në çfarë mase janë marrë parasysh kontributet nga qytetarët, OSHC-të, bizneset dhe përfaqësuesit e tjerë të publikut të interesuar gjatë vitit të kaluar, paraqet një hap të rëndësishëm në ndërtimin e besimit të publikut.

Mbledhja, analiza dhe prezantimi sistematik i të dhënave përkatëse mbi produktet dhe rezultatet e konsultimeve publike të kryera nga ministritë sjell një kuptim dhe vlerë shtesë për angazhimin e qytetarëve dhe palëve të interesit, por gjithashtu forcon potencialin për një kontroll qendror efektiv të cilësisë së konsultimeve dhe përhapjes së kulturës së hartimit të politikave të bazuara në prova. Theksimi në rritje i hapjes dhe transparencës së bërjes së politikave përshtatet në grupin e përgjithshëm të reformave që burojnë nga procesi i anëtarësimit në BE, veçanërisht në kontekstin e kërkesave në lidhje me reformën e administratës publike, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, si dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

Ky udhëzues synon të ndihmojë Kryeministrinë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe AKSHI-n në përbushjen e kërkesave specifike të hartimit të Raportit të performancës për konsultimet publike mbi konsultimet e kryera publike, si dhe të nxjerrë në pah aspektet kryesore që duhet të mbulohen nga ato raporte, përfshirë formatin/strukturën e sugjeruar të raportit.

Baza për zhvillimin e Raportit të performancës për konsultimet publike duhet të ndërtohet gjatë gjithë vitit, përmes koordinimit sistematik dhe monitorimit të konsultimeve publike të kryera nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe duke u siguruar që çdo konsultë individuale publike të mbështetet nga raporte të qëndrueshme, prova të rëndësishme dhe burime të verifikueshme të informacionit.

Në pjesën e parë të Udhëzuesit do të shtjellohet procesi i përgatitjes së Raportit të performancës për konsultimet publike, ndërsa në pjesën e dytë do të shpjegohet propozimi i strukturës së raportit. Kjo shoqërohet me një shtojcë që përmban pasaportën e treguesve, për një matje më të përparuar të progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik, së bashku me përshkrimin e hollësishëm metodologjik të matjes së treguesve të vendosur. Qëllimi i pasaportës së treguesve është të ofrojë detaje të mëtejshme operacionale në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe kërkesën e matjes dhe procesin e treguesve për të arritur një monitorim efektiv të progresit. Zbatimi i një sërë treguesve duhet të sigurojë një bazë solide për Kryeministrinë për të forcuar kornizën e monitorimit dhe për të përgatitur një progres raport vjetor më të përpunuar për zbatimin e standardeve të konsultimeve publike.

Projekt-pasaporta e treguesve mund të shërbejë edhe si një udhëzues për vendosjen e treguesve më të saktë dhe të përpunuar për t'u përdorur në dokumentet e ardhshme strategjike në fushat përkatëse të politikave (reforma e administratës publike, kuadri rregulator, bashkëpunimi qeveri-shoqëri civile, etj.). Në këtë kontekst, zbatimi i treguesve për të matur dhe monitoruar progresin kundrejt objektivave të përcaktuara duhet të përgatitet me kujdes, në përputhje me standartet

e monitorimit dhe raportimit dhe proceset e vendosura në dokumentin strategjik për të cilin po përgatitet.

Së fundmi, është e rëndësishme të përcaktohen qartë kërkesat specifike të të dhënave, procesi i llogaritjes dhe metodat e secilit tregues individual, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe nëpunësve në këtë proces, veçanërisht nevojitet bashkëpunim më i thelluar midis Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë, MEPJ e AKSHI-it, si dhe një koordinim i ngushtë ndërmjet Kryeministrisë dhe ministrike/institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit.

Procesi i përgatitjes së Raportit të performancës për konsultimet publike

Përgatitja e Raportit të performancës për konsultimet publike duhet të bazohet në një koordinim të ngushtë të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes (DZHM) dhe Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë (DRRP), MEPJ-së, AKSHI-it, si dhe ministrike dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit përgjegjëse për konsultimin publik.

Tabela më poshtë jep një përbledhje të hapave/aktiviteteve kryesore për përgatitjen e Raportit të performancës për konsultimet publike.

Aktiviteti	Afati
DZHM dërgon kërkesa tek ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit për të dorëzuar raporte (gjashtë-mujor) vjetore mbi konsultimet publike sipas modelit të dakordësuar	31 dhjetor për raportet vjetore 30 qershor për raportet gjashtë-mujor
Ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit i dërgojnë projekt-raportet (gjashtë-mujor) vjetore DZHM/DRRP për komente	20 janar për raportet vjetore 15 korrik për raportin gjashtë-mujor
DZHM/DRRP dërgon projekt-raportin me komente të mundshme.	24 janar për raportet vjetore 19 korrik për raportet gjashtë-mujore
DZHM/DRRP u dërgon ministrike dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit komentet mbi projekt-raportet.	25 janar për raportet vjetore 20 korrik për raportet gjashtë-mujore
Raportet (gjashtë-mujor) vjetore të miratuara nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministratit dërgohen te DZHM/DRRP përmes njoftimit zyrtar, si dhe linket e publikuara në regjistrin elektronik dhe faqen e internetit të ministrisë	31 janar për raportet vjetore 25 korrik për raportet gjashtë-mujore
DZHM/DRRP përgatit një raport të plotë (gjashtë-mujor) vjetor mbi konsultimet e kryera publike, bazuar në raportet (gjashtë-mujor) vjetore të ministrike dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit, dhe e paraqet atë në DRRP për komente	10 shkurt për raportin vjetor 29 korrik për raportin gjashtë-mujor

DZHM/DRRP finalizon raportin gjithëpërfshirës (gjashtë-mujor) vjetor për konsultimet e kryera publike	15 shkurt për raportin vjetor 31 korrik për raportin gjashtë-mujor
---	---

Cilësia e raportit vjetor të konsultimit të qeverisë qendrore varet kryesisht nga qëndrueshmëria e mbledhjes së provave nga secili konsultim publik i kryer gjatë vitit dhe për secilën metodë të konsultimit, si dhe nga cilësia e raporteve individuale për rezultatet e konsultimeve mbi projekt-aktet. Prandaj, u rekomandohet institucioneve të administrojnë dhe përditësojnë bazat e të dhënavë në mënyrë periodike për secilin konsultim individual. Kjo gjithashtu, përfshin konsultimin paraprak me palët e interesit mbi projekt-raportet e VNR-së, përmes takimeve me grupe ekspertësh dhe shoqata përfaqësuese në terren ose përmes konsultimeve paraprake të hapura me publikun.

Struktura e Raportit të performancës për konsultimet publike

Bazuar në raportet e konsultimit (gjashtë-mujor) vjetor të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit, shtojca përkatëse e raportit bashkëlidhur këtij Udhëzuesi, si dhe treguesit kryesorë të zgjedhur të performancës, por gjithashtu duke marrë parasysh komentet e mundshme në lidhje me konsultimet përraportin e VNR-së, DZHM në bashkërendim me DRRP në Kryeministri, MEPJ dhe AKSHI-in, përgatisin Raportin e performancës për konsultimet publike, i cili duhet të ndjekë strukturën e përgjithshme të dhënë më poshtë, në përputhje me treguesit kryesorë të përcaktuar.

Hyrja (qëllimi i raportimit; konteksti kombëtar dhe ndërkombëtar/BE; procesi i mbledhjes së të dhënavë; fusha dhe struktura e raportit)

Frekuencia e konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitet (përqindja e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave të miratuara nga qeveria të cilat kanë kaluar përmes konsultimeve publike)

Numri i konsultimeve publike për projektligjet me VNR (përqindja e të gjitha projektligjeve të përgatitura me VNR për të cilat janë zhvilluar konsultime publike)

Frekuencia e përdorimit të kritereve të përjashtimit/përjashtimeve nga konsultimet publike për akte në: a) Programin Analistik, b) PKIE, c) dokumentet strategjike sektoriale (përqindja e akteve në Programin Analistik për të cilat janë përdorur përjashtimet/kriteret e përjashtimit të nenit 4 të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik; përqindja e akteve në PKIE për të cilat janë përdorur përjashtimet/kriteret e përjashtimit të nenit 4 të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik; përqindja e akteve në strategjitet sektoriale për të cilat janë përdorur përjashtimet/kriteret e përjashtimit të nenit 4 të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik)

Kohëzgjatja e konsultimeve publike për projektligjet, dokumentet strategjike dhe politikat (përqindja e projektligjeve të konsultuara, dokumenteve strategjike dhe të politikave për të cilat konsultimi publik zgjati të paktën 20 ditë pune)

Përdorimi i Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për konsultime mbi projektligjet dhe strategjitet (përqindja e projektligjeve të konsultuara, dokumenteve strategjike

dhe të politikave për të cilat janë kryer konsultimet publike përmes Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike)

Organizimi i takimeve publike si mjet i konsultimit publik mbi projektligjet dhe strategjitë (përqindja e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave për të cilat u organizuan takime publike gjatë procesit të konsultimeve publike)

Shkalla e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, joqeveritarë të përfshirë në hartimin ose konsultimet mbi projektligjet, dokumentet strategjike dhe politikave si anëtarë të grupeve të punës/organeve këshillimore (numri i aktorëve joqeveritarë të përfshirë në konsultime mbi projektligjet dhe strategjitë si anëtarë të emëruar të grupeve të punës/organeve këshillimore)

Numri i pjesëmarrësve që kontribuojnë në konsultimet publike për projektligjet dhe strategjitë me komentet dhe rekomandimet e tyre (të dhënat e mbledhura me qëllim monitorimin e trendeve në rritjen/zvogëlimin e pjesëmarrësve/palëve të interesit që dërgojnë kontributet/komentet e tyre për konsultimet e hapura publike)

Raportimi mbi rezultatet e konsultimeve - përgjegjësia institucionale ndaj komenteve/rekomandimeve të marra për konsultimet publike mbi projektligjet dhe strategjitë (përqindja e projektligjeve dhe strategjive të konsultuara për të cilat janë publikuar raportet për rezultatet e konsultimeve publike, brenda numrit të përgjithshëm të projektligjeve dhe strategjive të konsultuara)

Shkalla e pranimit të kontributeve të palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitë (përqindja e numrit të përgjithshëm të komenteve/rekomandimeve të marra nga palët e interesuara që u pranuan nga institucionet)

Numri i raporteve të VNR-së që u ndryshuan/përditësuan bazuar në informacionin/të dhënat e marra gjatë konsultimit publik (vlerësimi i gatishmërisë së ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit për të ndryshuar ose përditësuar raportet e VNR-së bazuar në informacionin e marrë përmes konsultimeve publike)

Performanca institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (vlerësimi i nivelit të informacionit në dispozicion për përputhshmërinë e ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit me kërkesat kryesore të ligjit)

Niveli i kënaqësisë të palëve të interesuara/publikut me cilësinë e procesit të konsultimit publik (përqindja e pjesëmarrësve të anketuar të konsultimeve publike që janë të kënaqur me cilësinë e procesit të konsultimit, bazuar në sondazhet (dy) vjetore)

Përfundime dhe rekomandime (në fund të raportit duhet të paraqiten përfundimet që kanë të bëjnë me procesin e raportimit, progresin e përgjithshëm të arritur në zbatimin e standardeve, sfidat kryesore dhe mundësitetë për përmirësimin e zbatimit në periudhën e ardhshme; rekomandimet për hapat e ardhshëm që do të ndërmerrin).

Shtojca 6a: Pasaporta e treguesve për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik

1

Treguesi (propozoni titullin e treguesit)	Indeksi i frekuencës së konsultimit publik për projektligjet dhe strategjitë
Lloji i treguesit (Ndikimi / rezultati / produkti)	Produkti
Referencia e lidhur me dokumentet strategjike/ strategjité (Referencia me strategjítë sektoriale/në nivelin e qëllimit të politikës (emri / titulli i dokumentit)	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2020
Referencia e lidhur me SKZHI <i>(Referencia me Shtyllën SKZHI (vetëm))</i>	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
Referencia e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë (Referencia te qëllimi i politikës të lidhur me strategjítë sektoriale që është referuar në seksionin 3)	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2022
Qëllimi i politikës(Referencia tetitulli i qëllimit të politikës të lidhur me strategjítë sektoriale)	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
Objektivi Specifik (Referencia teobjektivi specifik/nëse ka)	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis
Treguesi/masa (Lloji)	Sasior
Burimi për monitorimin e treguesve të performancës(p.sh. raportet e vlerësimit të përgatitura nga Njësia e Planifikimit Strategjik, Institucioni, faqet e internetit, etj.)	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrite dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrite të linjës/ organeve publike
Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	Institucioni Drejtues (Njësia/ Drejtoria, etj.) që krijon dhe monitoron treguesin
	Institucionet Pjesëmarrëse
Metodologjia (Përshkruani metodologjinë e matjes së treguesit)	Ky tregues mat frekuencën e konsultimeve publike duke llogaritur përqindjen e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave (që kërkohej të paraqiteshin për konsultim publik) të miratuara nga Qeveria, të cilat kanë kaluar përmes konsultimeve publike. Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore nga Kryeministria bazuar në raportimin administrativ të ministrite dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat për konsultimet publike të kryera, si dhe bazuar në të dhënat e mbledhura përmes Regjistrit Elektronik, faqeve të internetit të ministrite dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, (për aktet e miratuara nga Qeveria) si dhe Fletorja Zyrtare.

Frekuencia e matjes	Frekuencia për vlerën e synuar sipas raportimit dhe monitorimit	Vjetore dhe gjashtë-mujore
	Frekuencia e matjes për vlerën aktuale	Vjetore
Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative / Në rritje		Në rritje
Treguesi aggregat		/
Formula e llogaritjes (Jepet formula përmënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)		<p>Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për Indeksin e frekuencës së konsultimit publik (IFPC) për projektligjet dhe strategjitë (IFPC = Përqindja e projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave të miratuara nga Qeveria të cilat kanë kaluar përmes konsultimeve publike) - duke përashtuar ato akte që përfshihen sipas nenit 4 të ligjit përkonsultimet publike.</p> <p style="text-align: center;">Numri i projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe politikave që kanë kaluar përmes procesit të konsultimit publik në një vit</p> <p style="text-align: center;">$\text{IFPC} = \frac{\text{Numri i përgjithshëm i projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave të miratuara nga qeveria që kërkohej të paraqiteshin përkonsultim publik}}{\text{Numri i përgjithshëm i projektligjeve, dokumenteve strategjike dhe të politikave të miratuara nga qeveria që kërkohej të paraqiteshin përkonsultim publik}} \times 100$</p>
Ndarja e të dhënavë (Treguesi aggregat)		Shtresa 1 Shtresa 2 Shtresa 3
Baza fillestare		2019 78.54%
Vlera / Synimet		2020 / 80% 2021/Trendi në rritje 2022/Trendi në rritje
Vlera e rishikuar/ Synimet		Viti / Vlera
Vlera / Synimet		Viti / Vlera
Referanca te Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)		16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
Fushat e lidhura me standartet e tjera		

Treguesi (propozoni titullin e treguesit)	Numri i konsultimeve publike të organizuara për projektligjet me VNR
Lloji i treguesit (Ndikimi / rezultati / produkti)	Produkti
Referencia e lidhur me dokumentet strategjike/ strategjité (Referencia me strategjítë sektoriale/në nivelin e qëllimit të politikës (emri / titulli i dokumentit)	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2022
Referencia e lidhur me SKZHI (Referencia me Shtyllën SKZHI (vetëm))	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
Referencia e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë (Referencia e qëllimit të politikës të lidhur me strategjítë sektoriale që është referuar në seksionin 3)	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2022
Qëllimi i politikikës(Referencia në titullin e qëllimit të politikës të lidhur me strategjítë sektoriale)	Politikëbërrja dhe cilësia e legjislacionit
Objektivi Specifik (Referencia me objektivin specifik/nëse është)	Sistemi transparent dhe gjithëpërfsirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafrimin me acquis
Treguesi/masa (Lloji)	Sasior
Burimi për monitorimin e treguesve të performancës(p.sh. raportet e vlerësimit të përgatitura nga Njësia e Planifikimit Strategjik, Institucioni, faqet e internetit, etj.)	Raporti vjetor i qeverisë qendrore për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës/ institucioneve të varësisë të Kryeministrisë
Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënavë	Institucioni Drejtues (Njësia/ Drejtoria, etj.) që krijon dhe monitoron treguesin
	Institucionet Pjesëmarrëse
Metodologja (Përshkruani metodologjinë e matjes së treguesit)	Ky tregues mat numrin e konsultimeve publike të mbajtura për projektligjet me VNR dhe përqindjen e projektligjeve me VNR që kaluan përmes konsultimeve publike nga numri i përgjithshëm i projektligjeve me VNR. Metodologja bazohet në mbledhjen e të dhënavë sasiore nga Kryeministria, bazuar në raportimin administrativ të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit në konsultimet publike të kryera, si dhe bazuar në të dhënat e mbledhura përmes Regjistrit Elektronik, faqeve të internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, (për aktet e miratuara nga Qeveria) si dhe Fletores Zyrtare
	Frekuenca për vlerën e synuar sipas
	Vjetore dhe gjashtë-mujore

Frekuencia e matjes	raportimit dhe monitorimit	
	Frekuencia e matjes për vlerën aktuale	Vjetore
Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative / Në rritje	Në rritje	
Treguesi aggregat		
Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për të matur rritjen e konsultimeve publike të mbajtura për projektligjet me VNR (si përqindje e të gjithë projektligjeve të përgatitura me VNR): $I_{VNR} = \frac{\text{Numri i projektligjeve të konsultuara me VNR në një vit}}{\text{Numri i përgjithshëm i projektligjeve të përgatitura me VNR}} \times 100$	
Ndarja e të dhënavë (Treguesi aggregat)	Shtresa 1	
	Shtresa 2	
	Shtresa 3	
Baza fillestare	2019	
Vlera / Synimet	2020 / Trendi në rritje	
	2021/Trendi në rritje	
	2022/Trendi në rritje	
Vlera e rishikuar/ Synimet	Viti / Vlera	
Vlera / Synimet	Viti / Vlera	
Referanca e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet	
Fushat e lidhura me standartet e tjera		

Treguesi (propozoni titullin e treguesit)	Indeksi i përdorimit të kritereve të përjashtimit/ përjashtimeve nga konsultimet publike për akte në Programin Analistik
Lloji i treguesit (Ndikimi / rezultati / produkti)	Produkti
Referencia e lidhur me dokumentet strategjike/ strategjité (Referencia me strategjítë sektoriale/në nivelin e qëllimit të politikës (emri / titulli i dokumentit)	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2022
Referencia e lidhur me SKZHI (Referencia me Shtyllën SKZHI (vetëm))	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit
Referencia e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë (Referencia e qëllimit të politikës të lidhur me strategjítë sektoriale që është referuar në seksionin 3)	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2022
Qëllimi i politikikës(Referencia në titullin e qëllimit të politikës të lidhur me strategjítë sektoriale)	Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit
Objektivi Specifik (Referencia me objektivin specifik/nëse është)	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe, i cili siguron përafraimin me acquis
Treguesi/masa (Lloji)	Sasior
Burimi për monitorimin e treguesve të performancës(p.sh. raportet e vlerësimit të përgatitura nga Njësia e Planifikimit Strategjik, Institucioni, faqet e internetit, etj.)	Raporti i performancëspër konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit, Registri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive të linjës/ institucioneve të varësisë të Kryeministrit
Institucionet përgjegjëse përmblledhjen e të dhënave	Institucioni Drejtues (Njësia/ Drejtoria, etj.) që krijon dhe monitoron treguesin
	Institucionet Pjesëmarrëse
Metodologja (Përshkruani metodologjinë e matjes së treguesit)	Ky tregues mat frekuencën e përdorimit të përjashtimeve nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit të përmendura në nenin 4 të ligjit për njofimin dhe konsultimin publik) për aktet e parashikuara në Planin vjetor Analistik të Projektakteve të Qeverisë (Programi Analistik). Kjo matet si përqindje e akteve të parashikuara në Programin Analistik për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit nga neni 4). Përjashtimet nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit për aktet që nuk kërkohen të konsultohen) përcaktohen në nenin 4 të ligjit, duke përcaktuar që dispozitat e ligjit nuk zbatohen gjatë proceseve të vendimmarres në lidhje me:

	a) çështjet e sigurisë kombëtare, për sa kohë që ato përbëjnë një sekret shtetëror, në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"; b) marrëveshjet ndërkombe, marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe; c) aktet administrative individuale dhe aktet normative administrative, perveç rasteve kur me një ligj specifik parashikohet ndryshe; d) aktet normative, me fuqinë e ligjit të miratuar nga Këshilli i Ministrave; d) emergjencia civile; e) raste të tjera të përjashtimit të parashikuara nga ligji. Metodologjia bazohet në mbledhjen sasiore të të dhënave nga Kryeministria, bazuar në raportimin administrativ të ministritive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit në konsultimet publike të kryera, si dhe bazuar në të dhënat e mbledhura përmes azhurnimit të Planit Vjetor të Konsultimeve Publike, Regjistrat Elektronik, fakteve të internetit të ministritive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit, (për aktet të miratuar nga Qeveria) si dhe Fletore Zyrtare.
Frekuencia e matjes	Frekuencia për vlerën e synuar sipas raportimit dhe monitorimit
	Frekuencia e matjes për vlerën aktuale
Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative / Në rritje	Në rënie
Treguesi aggregat	/
Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	Formula e mëposhtme e llogaritjes përdoret për Indeksin e përdorimit të kriterieve të përjashtimit/përjashtimeve nga konsultimet publike për aktet në Programin Analistik ($I_{EXCL-PA}$) Numri i akteve të parashikuara në Programin Analistik për të cilat janë përdorur përjashtime nga konsultimet publike (kriteret e përjashtimit sipas nenit 4) $I_{EXCL-PA} = \frac{\text{Numri i përgjithshëm i akteve të parashikuara në Programin Analistik}}{\text{Numri i përgjithshëm i akteve të parashikuara në Programin Analistik}} \times 100$
Ndarja e të dhënave (Treguesi aggregat)	Shtresa 1
	Shtresa 2
	Shtresa 3
Baza fillestare	2019
	/
Vlera / Synimet	2020 / Trendi në rënie
	2021 / Trendi në rënie
	2022 / Trendi në rënie
Vlera e rishikuar/ Synimet	Viti / Vlera
Vlera / Synimet	Viti / Vlera

Referenca e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
Fushat e lidhura me standartet e tjera	

Treguesi (propozoni titullin e treguesit)	Indeksi i përdorimit të kritereve të përjashtimit/ përjashtimeve nga konsultimet publike për akte në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE)	
Lloji i treguesit (Ndikimi / rezultati / produkti)	Produkti	
Metodologjia (Përshtakuani metodologjinë e matjes së treguesit)	Ky tregues vlerëson gatishmërinë e ministrike dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat për të ndryshuar ose përditësuar raportet e VNR-së bazuar në informacionin e marrë përmes konsultimeve publike. Treguesi illogaritet si përqindje e projektligjeve për të cilat raportet VNR-së janë ndryshuar ose përditësuarbazuar në informacionin/të dhënrat e marra përmes konsultimit publik (IVNR) Metodologjia bazohet në mbledhjen e të dhënave sasiore bazuar në raportet e ministrike dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat për konsultimet e kryera publike, si dhe të dhënat e mbledhura përmes RENJKP dhe faqeve të internetit të ministrike dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat.	

Frekuencia e matjes	Frekuencia për vlerën e synuar sipas raportimit dhe monitorimit	Vjetore dhe gjashtë-mujore
	Frekuencia e matjes për vlerën aktuale	Vjetore
Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative / Në rritje		Në rritje
Treguesi aggregat		/
Formula e llogaritjes (<i>Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve</i>)		Ky tregues llogaritet duke përdorur formulën e mëposhtme: Numri i projektligjeve për të cilat raportet e VNR-së janë ndryshuar ose azhurnuar bazuar në informacionin/të dhënrat e marra përmes konsultimit publik $\text{IVNR} = \frac{\text{Numri i përgjithshëm i projektligjeve të konsultuar me VNR}}{x 100}$
Ndarja e të dhënave (Treguesi aggregat)	Shtresa 1	
	Shtresa 2	
	Shtresa 3	
Baza fillestare	2019	
Vlera / Synimet	2020 /	
	2021/Trendi në rritje	
	2022/Trendi në rritje	
Vlera e rishikuar/ Synimet	Viti / Vlera	
Vlera / Synimet	Viti / Vlera	
Referanca te Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ)	16.7 Siguron vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfsirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet	
Fushat e lidhura me standardet e tjera		

Treguesi (propozoni titullin e treguesit)	Indeksi i cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e Ligjit për Njoftim dhe Konsultimet Publike	
Lloji i treguesit (Ndikimi / rezultati / produkti)	Produkti	
Referencia e lidhur me dokumentet strategjike/ strategjitet (Referencia testrategjite sektoriale/në nivelin e qëllimit të politikës (emri / titulli i dokumentit)	Strategja e Reformës së Administratës Publike 2015-2022	
Referencia e lidhur me SKZHI (Referencia teShtylla e SKZHI (vetëm))	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit	
Referencia e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë (Referencia te qëllimi i politikës të lidhur me strategjitet sektoriale që është referuar në seksionin 3	Objektivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2022	
Qëllimi i politikikës(Referencia në titullin e qëllimit të politikës të lidhur me strategjitet sektoriale)	Politikëbërrja dhe cilësia e legjislacionit	
Objektivi Specifik (Referencia teobjektivi specifik/nëse ka)	Sistemi transparent dhe gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhesiguron përafrimin me acquis	
Treguesi/masa (Lloji)	Sasior	
Burimi për monitorimin e treguesve të performancës(p.sh. raportet e vlerësimit të përgatitura nga Njësia e Planifikimit Strategjik, Institucioni, fajet e internetit, etj.)	Raporti i performancëspër konsultimet publike, raportet vjetore të ministrike dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, fajet e internetit të ministrike dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat	
Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave	Institucioni Drejtues (Njësia/ Drejtoria, etj.) që krijon dhe monitoron treguesin	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes
	Institucionet Pjesëmarrëse	Ministratë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat
Metodologjia (Përshkruani metodologjinë e matjes së treguesit)	Ky tregues vlerëson nivelin e informacionit të ofruar nga ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrat për përbushjen e kërkesave (kritereve) të përcaktuara në ligjin nr.146/2014, "Për njoftimin dhe Konsultimin Publik", përkatësisht: <ul style="list-style-type: none"> • Informacion mbi publikimin e informacionit në sistemet qeveritare të informacionit (Regjistri elektronik dhe programi i transparencës); • Konsultimet publike të mbajtura për të paktën 20 ditë pune; • Grupet e palëve të interesuara të përfshira në procesin e konsultimit; • Botimi në RENJKP i Raportit mbi numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të lëshuara nga grupet e interesuara dhe palët e interesuara; 	

	<ul style="list-style-type: none"> Informacion mbi komentet e pranuara/reflektuara kundrejt komenteve të paraqitura të disponueshme në Raport. <p>Përdoret një vlerësim me dy pikë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -një pikë nëse ekzistojnë prova mbi përbushjen e kërkesave të ligjit dhe -një pikë nëse informacioni është gjithëpërfshirës në nivelin e pritur. <p>Metodologjia ndjek qasjen e SIGMA-s në matjen e cilësisë së konsultimeve publike, dhe bazohet në mbledhjen e të dhënave bazuar në raportet e ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit përkonsultimet e kryera publike, si dhe të dhënat e mbledhura përmes RENJKP dhe faqeve të internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit.</p>															
Frekuencia e matjes	Frekuencia për vlerën e synuar sipas raportimit dhe monitorimit															
	Frekuencia e matjes për vlerën aktuale															
Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative / Në rritje	Në rritje															
Treguesi aggregat	/															
Formula e llogaritjes (Jepet formula përmënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	<p>Ky tregues llogaritet duke përdorur tabelën e pikëve të SIGMA pak më poshtë të përshtatur bazuar në vlerësimin vijues me dy pikë të cilësisë së performancës institucionale: (IPI)</p> <ul style="list-style-type: none"> -një pikë nëse ekzistojnë prova mbi përbushjen e kërkesave të Ligjit dhe -një pikë nëse informacioni është gjithëpërfshirës në nivelin e pritur. <table border="1"> <thead> <tr> <th>0</th><th>1</th><th>2</th><th>3</th><th>4</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Asnjë nga elementët nuk u përbush</td><td>1-3 pikë</td><td>4-5 pikë</td><td>6-7 Pikë</td><td>8 pikë</td></tr> <tr> <td>Asnjë informacion nuk është dhënë përkonsultim i publik</td><td>Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë</td><td>Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë</td><td>Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë</td><td>Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë</td></tr> </tbody> </table>	0	1	2	3	4	Asnjë nga elementët nuk u përbush	1-3 pikë	4-5 pikë	6-7 Pikë	8 pikë	Asnjë informacion nuk është dhënë përkonsultim i publik	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë
0	1	2	3	4												
Asnjë nga elementët nuk u përbush	1-3 pikë	4-5 pikë	6-7 Pikë	8 pikë												
Asnjë informacion nuk është dhënë përkonsultim i publik	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë	Projektligjet janë botuar në sistemin e informacionit qeveritar, është hartuar raport tipi përfshirjet e interesuarë të palëve të interesuarë												

					pjesë e mirë e reagimeve të palëve të interesuara pasqyrohet në projektakti n e ri
Treguesit llogariten si një rezultat mesatar i marrë për të gjitha aktet që janë subjekti konsultimeve publike në një vit kalendarak.					
Ndarja e të dhënave (Treguesi aggregat)	Shtresa 1				
	Shtresa 2				
	Shtresa 3				
Baza fillestare	2019				
	5,12				
Vlera / Synimet	2020 / Trendi në rritje				
	2021/Trendi në rritje				
	2022/Trendi në rritje				
Vlera e rishikuar/ Synimet	Viti / Vlera				
Vlera / Synimet	Viti / Vlera				
Referanca te Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfsirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet				
Fushat e lidhura me standartet e tjera					

Treguesi (propozoni titullin e treguesit)	Niveli i kënaqësisë së publikut me cilësinë e procesit të konsultimit publik²	
Lloji i treguesit (Ndiskimi / rezultati / produkti)	Ndiskimi	
Referencia e lidhur me dokumentet strategjike/ strategjitet (Referencia testrategjitet sektoriale/në nivelin e qëllimit të politikës (emri / titulli i dokumentit)	Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2015-2022	
Referencia e lidhur me SKZHI (Referencia në Shtyllën SKZHI (vetëm))	Lidhur me shtyllën: Mirëqeverisja & Demokracia dhe Sundimi i Ligjit	
Referencia e lidhur me qëllimin e politikës së Dokumentit të Strategjisë (Referencia e qëllimit të politikës të lidhur me strategjitet sektoriale që është referuar në seksionin 3	Objktivi 2 i Strategjisë së Reformës së Administratës Publike 2015-2020	
Qëllimi i politikës (Referencia në titullin e qëllimit të politikës të lidhur me strategjitet sektoriale)	Politikëbërsa dha cilësia e legjislacionit	
Objektivi Specifik (Referencia teobjektivi specifik/nëse ka)	Sistemi transparent dha gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i cili bazohet në politikat dhe siguron përafrimin me acquis	
Treguesi/masa (Lloji)	Sasior	
Burimi për monitorimin e treguesve të performancës (p.sh. raportet e vlerësimit të përgatitura nga Njësia e Planifikimit Strategjik, Institucioni, faqet e internetit, etj.)	Pyetesorët/sondazhet, Raporti i performancës për konsultimet publike, raportet vjetore të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit, Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, faqet e internetit të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministratit	
Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënavë	Institucioni Drejtues (Njësia/ Drejtoria, etj.) që krijon dhe monitoron treguesin	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe ekspertiza e dedikuar
	Institucionet Pjesëmarrëse	

²Ky tregues do të realizohet me mbështetjen e një asistence të dedikuar, e cila do ta analizojë dhe përpunojë atë në një mënyrë më kuptimplotë, si dhe do të realizojë pyetësorë/sondazhe të lidhura me këtë tregues. Ky tregues do të zbatohet kur ka burime të mjaftueshme për t'u realizuar.

Metodologjia (Përshkruani metodologjinë e matjes së treguesit)	<p>Ky tregues mat shkallën në të cilën përfaqësuesit e publikut të interesuar (pjesëmarrësit dhe kontribuesit në konsultimet publike) janë të kënaqur me cilësinë e procesit të konsultimit publik.</p> <p>Treguesi do të llogaritet bazuar në një të dhënë të Sondazhit Bazë që mund të kryhet deri në fund të vitit 2021/2022 dhe përmes sondazheve (dy) vjetore në vitet e ardhshme.</p> <p>Më poshtë jepen disa orientime për pyetjetqëmundtë përfshihen në studim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetjet demografike (gjinia, mosha, arsimi, profesioni, posti, niveli i të ardhurave, etj.) • Pjesëmarrja e mëparshme në konsultimet publike • Perceptimi në lidhje me cilësinë e përgjithshme të konsultimeve publike (shumë i dobët, i dobët, mesatar, i mirë, shumë i mirë) • Marrja e informacionit në kohë për konsultimet e planifikuara dhe të hapura publike • Qartësia e dokumenteve të publikuara për konsultimet publike • Lehtësia e perdorimit të regjistrat elektronik nga përdoruesit si mjet i konsultimit publik • Dhënia në kohe e informacionit për takimet e organizuara publike • Cilësia e përgjigjes së ministrive/ organeve qeveritare ndaj komenteve dhe rekomandimeve të dhëna 	
	<p>Sondazhi pritet të kryhet në internet dhe do të jetë anonim. Kampioni testues do të zhvillohet nga një ekspertizë e dedikuar në bashkëpunim me të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe duhet të përfshijë pjesëmarrësit e mëparshëm dhe kontribuesit në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme, Regjistrat elektronik, postës elektronike, takimeve publike, komiteteve konsultative, etj. Madhësia totale e 'kampionit duhet të përfshijë rreth 1000 palë të interesuara (rreth 100 aktorë të interesuar ku kontaktet do të dërgohen me e-mail nga secila ministri dhe institucion qendror, në varësi të Kryeministrit), përfaqësues të aktorëve të ndryshëm joqeveritarë nga sektorë të ndryshëm (shoqëria civile, akademikë, biznesi, media, etj.) si dhe rajone të ndryshme.</p>	
Frekuencia e matjes	Frekuencia për vlerën e synuar sipas raportimit dhe monitorimit	Vjetore ose dyvjeçare
	Frekuencia e matjes për vlerën aktuale	Vjetore ose dyvjeçare
Treguesi / Natyra e treguesit: Kumulative / Në rritje	Në rritje	
Treguesi aggregat	/	
Formula e llogaritjes (Jepet formula për mënyrën e llogaritjes së vlerës së këtyre treguesve)	Ky tregues llogaritet si përqindje e pjesëmarrësve të anketuar dhe kontribuesve të konsultimeve publike që janë të kënaqur me cilësinë e konsultimeve publike (duke e perceptuar cilësinë e konsultimeve si "të mirë" ose "shumë të mirë").	

	IKËNAQËSIA= Përqindja e pjesëmarrësve të anketuar të konsultimeve publike që janë të kënaqur me cilësinë e procesit të konsultimit.
Ndarja e të dhënave (Treguesi aggregat)	Shtresa 1
	Shtresa 2
	Shtresa 3
Baza fillestare	2019
Vlera / Synimet	2020 /Trendi në rritje
	2021/Trendi në rritje
	2022/Trendi në rritje
Vlera e rishikuar/ Synimet	Viti / Vlera
Vlera / Synimet	Viti / Vlera
Referenca e Qëllimeve të ZHvillimit të Qëndrueshem (QZHQ)	16.7 Siguroni vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet 16.6 Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet
Fushat e lidhura me standardet e tjera	

Raporti përbledhës mbi procesin e përgatitjes së Projekt Udhëzuesit për procesin e konsultimit publik dhe konsultimet ndërministrore të zhvilluara

Titulli i projektaktit / dokumentit të politikës

Projekturdhri për miratimin e Udhëzuesit për procesin e konsultimit publik

Kohëzgjatja e procesit të hartimit dhe konsultimit

Versioni fillestari i Udhëzuesit është përgatitur si pjesë e një projekti SIGMA, që mbështet zhvillimin e një sistemi të Vlerësimit të Ndiqimit Rregulator (VNR) në Shqipëri gjatë vitit 2019. Ai është rishikuar dhe zgjeruar në mënyrë thelbësore përmes aktiviteteve të finançuara nga projekti dyshëdhjetë mujor i Bashkimit Evropian "Ndiarma teknike për përmirësimin e kornizës rregulatorë dhe Konsultimet Publike", gjatë të cilit, zyrtarë përgjegjës nga ministritë, agjencitë dhe Kryeministrisë, kanë marrë pjesë në një sërë aktivitetesh për krijimin e kapaciteteve dhe në seancat e përbashkëta të punës për standartet e konsultimeve publike dhe testimin e modeleve të reja për planifikimin dhe raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike që nga shkurti deri në tetor 2020. Udhëzuesi i propozuar pasqyron mësimet e nxjerra dhe reagimet e marra nga ministritë, agjencitë dhe Kryeministria, gjatë zbatimit të projektit të asistencës teknike të BE-së.

Aktivitetet e konsultimit dhe krijimi i kapaciteteve në lidhje me projekt Udhëzuesin e procesit të konsultimit publik

Seminare të përbashkëta për koordinatorët në të gjitha ministritë, agjencitë dhe Departamentet përgjegjëse në Kryeministri (DZHM&DRRP)

Seminare për planifikimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike - 7 shkurt 2020

Seminare për zhvillimin e planeve të konsultimit dhe dokumenteve të konsultimit - 20 Shkurt 2020

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (me pjesëmarrjen e stafit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes)

Seminare *on-line* për planifikimin e konsultimeve publike - 16 qershor 2020

Seminare *on-line* për raportimin e rezultateve të konsultimeve publike - 17 qershor 2020

Ministria e Mbrojtjes

Seminare *on-line* për planifikimin e konsultimeve publike - 10 korrik 2020

Seminare *on-line* për raportimin e rezultateve të konsultimeve publike - 13 korrik 2020

Ministria e Brendshme

Seminare *on-line* për planifikimin dhe raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike - 13 korrik 2020

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Seminare *on-line* për planifikimin dhe raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike - 17 korrik 2020

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Seminare *on-line* për planifikimin dhe raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike - 27 korrik 2020

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Sesioni pune *on-line* për planifikimin dhe raportimin e rezultateve të konsultimeve publike - 29 korrik 2020

Ministria e Infrastrukturës dhe Enerjisë

Sesioni pune *on-line* për planifikimin dhe raportimin e rezultateve të konsultimeve publike - 3 gusht 2020

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Takim i përbashkët me DZHM&DRRP dhe AKSHI-t, me qëllim përmirësimin e Regjistrat Elektronik për Konsultimet Publike, sigurimin e mbledhjes në kohë të dhënave të kërkuara në Udhëzime dhe pasaportën e propozuar të treguesve, si dhe rritjen e ndërveprimit midis Regjistrat Elektronik dhe sistemeve të tjera të informacionit, të tilla si IPSIS.

Palët e interesuara të përfshira

Gjatë dhjetë muajve të testimit dhe rishikimit të Udhëzuesit, njësitë përkatëse të ZKM-së, të gjitha ministritë dhe AKSHI, janë përfshirë në testimin dhe sigurimin e reagimeve mbi draftin e Udhëzuesit. Si koordinator përgjegjës i procesit të hartimit të Udhëzuesit, Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisjen (DZHM) në Kryeministri, ka siguruar që Draft Udhëzuesi përfundimtar t'i paraqitet për komente Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), gjithashtu edhe Departamentit Rregulatori dhe Përputhshmërisë dhe AKSHI-t, me qëllim harmonizimin e qasjes për mbledhjen dhe monitorimin e informacionit të kërkuar në pasaportën e treguesve. Për më tepër, draft Udhëzuesi është dorëzuar për komente të mundshme pranë SIGMA-s, si dhe Delegacionit të BE-së në Shqipëri.

Pasqyrë e komenteve të marra me arsyetimin e komenteve të pranuara/refuzuara

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Arsyetimi
Përgjegjësia për monitorimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura për pasaportën e treguesve në konsultimet publike	Nevoja për ndarje të qartë të detyrave për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi konsultimet e kryera publike	DZHM dhe DRRP; MEPJ; AKSHI	Pranohet	DZHM përcaktohet si koordinator i procesit, me mbështetjen dhe kontributin e nevojshëm nga DRRP, MEPJ, AKSHI

Raporti përbledhës mbi procesin e përgatitjes së Projekt Udhëzuesit për procesin e konsultimit publik dhe konsultimet ndërministrore të zhvilluara

Titulli i projektaktit / dokumentit të politikës

Projekturdhri për miratimin e Udhëzuesit për procesin e konsultimit publik

Kohëzgjatja e procesit të hartimit dhe konsultimit

Versioni fillestari i Udhëzuesit është përgatitur si pjesë e një projekti SIGMA, që mbështet zhvillimin e një sistemi të Vlerësimit të Ndikimit Rregulator (VNR) në Shqipëri gjatë vitit 2019. Ai është rishikuar dhe zgjeruar në mënyrë thelbësore përmes aktivitetave të finançuara nga projekti dyshëdhjetë mujor i Bashkimit Evropian “Ndihma teknike për përmirësimin e kornizës rregulatorë dhe Konsultimet Publike”, gjatë të cilit, zyrtarë përgjegjës nga ministritë, agjencitë dhe Kryeministrisë, kanë marrë pjesë në një sërë aktivitetesh për krijimin e kapaciteteve dhe në seancat e përbashkëta të punës për standarde konsultimeve publike dhe testimin e modeleve të reja për planifikimin dhe raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike që nga shkurti deri në tetor 2020. Udhëzuesi i propozuar pasqyron mësimet e nxjerra dhe reagimet e marra nga ministritë, agjencitë dhe Kryeministria, gjatë zbatimit të projektit të asistencës teknike të BE-së.

Aktivitetet e konsultimit dhe krijimi i kapaciteteve në lidhje me projekt Udhëzuesin e procesit të konsultimit publik

Seminare të përbashkëta për koordinatorët në të gjitha ministritë, agjencitë dhe Departamentet përgjegjëse në Kryeministri (DZHM&DRRP)

Seminare për planifikimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike - 7 shkurt 2020

Seminare për zhvillimin e planeve të konsultimit dhe dokumenteve të konsultimit - 20 Shkurt 2020

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (me pjesëmarrjen e stafit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes)

Seminare *on-line* për planifikimin e konsultimeve publike - 16 qershor 2020

Seminare *on-line* për raportimin e rezultateve të konsultimeve publike - 17 qershor 2020

Ministria e Mbrojtjes

Seminare *on-line* për planifikimin e konsultimeve publike - 10 korrik 2020

Seminare *on-line* për raportimin e rezultateve të konsultimeve publike - 13 korrik 2020

Ministria e Brendshme

Seminare *on-line* për planifikimin dhe raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike - 13 korrik 2020

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Seminare *on-line* për planifikimin dhe raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike - 17 korrik 2020

Arsyetimi më i saktë të arsyeve për përjashtimin e akteve nga konsultimet publike	Lista e quartë e kritereve për përcaktimin e akteve / politikave me interes të lartë publik dhe justifikimin e përjashtimeve nga konsultimet publike bazuar në nenin 4 të ligjit për konsultimin publik	DZHM, koordinatorët në ministritë e linjës	Pranohet	Modeli për planin vjetor të konsultimeve publike të ministrive i ndryshuar, si dhe planin e performancës për konsultimet publike të qeverisë, i ndryshuar, për të përfshirë një seri kriteresh përjashtimi dhe përfshirje për konsultimet publike
---	---	--	----------	---

RELACION

PËR PROJEKTURDHRIN “PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK”

I. QËLLIMI I DRAFTIT DHE OBJEKTIVAT E SYNUARA PËR T’U ARRITUR

Projekturdhri i propozuar synon të kontribuojë në një zbatim më efektiv të standardeve të konsultimeve publike mbi projektatet ligjore dhe politikave, siç përcaktohet në ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimet publike”. Më posaçërisht, qëllimi i tij është të sigurojë udhëzime metodologjike për të harmonizuar planifikimin, komunikimin, menaxhimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e procesit të konsultimeve publike midis ministrive përgjegjëse, duke përfshirë përgatitjen e planeve vjetore më të përparuara të konsultimeve publike, si dhe raporteve (gjashtë mujore) për rezultatet e konsultimeve publike.

Nevoja për zhvillimin e udhëzuesit metodologjik për procesin e konsultimit publik, si dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë së konsultimeve të kryera është theksuar në mënyrë të përsëritur në Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, si në vitin 2019 dhe në vitin 2020, veçanërisht në kontekstin e kërkesave për krijimin e politikave gjithëpërfshirëse, të bazuara në të dhëna dhe zhvillimin legjislativ si pjesë e reformës së përgjithshme të administratës publike. Më konkretisht, Raporti i KE-së për vitin 2020 thekson se: “*Konsultimet publike kërkojnë për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit. Është arritur një progres në trajnimin e ministrive të linjës për të përdorur më mirë konsultimet publike, edhe pse nuk është miratuar një metodologji për konsultimet publike*”.

Për më tepër, përcaktimi i treguesve më të hollësishëm të performancës është i nevojshëm për të matur zhvillimin e procesit të konsultimit publik për t’iu përgjigjur një theksi gjithnjë në rritje për të pasur të dhëna përmarrjen në konsideratë të kontributeve nga organizatat e shoqërisë civile.

Gjatë vitit 2019, Kryeministria dhe ministritë kanë përfituar nga mbështetja e SIGMA-s në zhvillimin e draft udhëzuesit për procesin e konsultimit publik. Që nga nëntori i vitit 2019, përmes projektit të asistencës teknike të financuar nga BE “Përmirësimi i Kornizës Rregullatore dhe Konsultimeve Publike”, janë organizuar një sërë seminaresh dhe sesione të përbashkëta pune për koordinatorët e konsultimeve publike në ministri, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të ministrive për planifikim dhe menaxhim më efektiv të konsultimeve publike. Këto seminare gjithashtu, shërbyen për të testuar disa nga modelet e propozuara në draftin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik të përgatitur me mbështetjen e SIGMA-s. Përveç kësaj, janë realizuar edhe një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve që mbështesin këshillat konsultativë ose menaxhojnë platformat e konsultimit që synojnë dhe përmirësojnë pjesëmarrjen e palëve të interesuara përkatëse në procesin e hartimit të politikave - të tilla si: Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile), Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (Platforma e Bashkëqeverisjes), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (Platforma e Partneritetit të Integrimit Evropian), Këshilli Shqiptar i Investimeve, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. Në përgjithësi, me 159 pjesëmarrës u zhvilluan takime të dedikuara, sesione të përbashkëta pune dhe takime kushtuar udhëzimeve për konsultime publike.

Bazuar në mësimet e marra dhe reagimet e mbledhura nga ministritë, Kryeministria dhe ekipi i ekspertëve të projektit EU/Asistenca Teknike në bashkëpunim me të gjitha ministritë kanë përgatitur dhe pilotuar një grup udhëzimesh më të hollësishme me modele të përditësuara. Përmes këtij procesi, synohej të sigurohej një njohje më e fortë e udhëzimeve të reja për qeverinë qendrore dhe pritet të jenë të gatshme t'i zbatojnë ato në mënyrë më efektive pas miratimit dhe shpërndarjes së tyre zyrtare.

Në përgjithësi, zbatimi i këtyre udhëzimeve duhet të kontribuojë në përmirësimin e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin efektiv të konsultimeve publike, dhe veçanërisht për raportimin me cilësi më të mirë të rezultateve të konsultimeve publike. Është pikërisht cilësia e reagimit për pjesëmarrësit e konsultimeve publike që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në besimin dhe motivimin e palëve të interesuara për të marrë pjesë në konsultime të hapura dhe për të kontribuar në procesin e hartimit të politikave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË LIDHJE ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Ky projekturdhër nuk është planifikuar në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian 2020-2022. Sidoqoftë, zbatimi i udhëzuesit të Konsultimit Publik, i cili do të miratohet nga ky urdhër duhet të ketë një ndikim pozitiv në cilësinë e të gjitha akteve të konsultuara nga Programi i Përgjithshëm Analistik i Projektakteve dhe PKIE-së.

III. ARGUMENTIMI I DRAFTIT NË LIDHJE ME AVANTAZHET, PROBLEMET, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë pesë viteve të zbatimit të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimet publike”, janë identifikuar një numër sfidash të lidhje me interpretimin e harmonizuar dhe koherent të dispozitave të ligjit, veçanërisht në lidhje me përdorimin e përjashtimeve nga konsultimet publike, fushëveprimi dhe formati i dokumenteve të botuara në Regjistrin Elektronik për Njoftim dhe Konsultimet Publike, por edhe përbajtja dhe cilësia e raporteve individuale për rezultatet e konsultimeve publike, si dhe raportet vjetore të cilat duhet të pasqyrojnë performancën e përgjithshme dhe përputhshmërinë me standartet e përcaktuara të konsultimit.

Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2020 thekson se: “*është arritur progres në trajnimin e ministrive të linjës për të përdorur më mirë konsultimet publike, megjithëse nuk është miratuar një metodologji për konsultimet publike. Faqja e internetit-portali elektronik për konsultimet publike është funksional, por përdorimi i tij nga publiku mbetet i kufizuar. Funksioni i kontrollit të cilësisë në konsultimin publik mbetet i dobët dhe përqendrohet kryesisht në proces sesa në përbajtje*”.¹ Përveç kësaj, ky Raport thekson se megjithëse fushëveprimi i ligjit për konsultimin publik të vitit 2014 kërkon raportimin se si merren në konsideratë inputet nga organizatat e shoqërisë civile, ka pak të dhëna të përdorimit dhe efektivitetit të mekanizmave të dhënieve së përgjigjeve apo reagimeve mbi sugjerimet e publikut

¹ Shih Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2020: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf, faqe 15

Në përgjigje të gjetjeve të Raporteve Vjetore të Komisionit Evropian për vitin 2019 dhe 2020, si dhe kërkesave nga Grupi Special i BE-së për Reformën e Administratës Publike BE-Shqipëri, por edhe në funksion të kërkesave që burojnë nga mbështetja sektorial IPA e BE-së për Reformën e Administratës Publike, këto Udhëzime kanë potencialin për të përmirësuar cilësinë e përgjithshme të konsultimeve publike të kryera nga ministritë.

Veçanërisht, përmes zbatimit të qëndrueshëm të Udhëzimeve për konsultimet publike, pritet të arrihen objektivat e mëposhtme:

- zhvillimi i planeve vjetore të konsultimeve publike bazuar në identifikimin e qartë të argumenteve për përdorimin e përjashtimeve të mundshme nga konsultimet publike (të parashikuara në nenin 4 të ligjit), por gjithashtu duke marrë parasysh vlerësimin e akteve të planifikuara në lidhje me kriteret e “interesit të lartë publik”;
- përmirësimi i planifikimit të brendshëm për secilin konsultim publik individual mbi projektaktin përmes përgatitjes sistematike të planeve të konsultimit (me identifikimin e palëve të interesit, përzgjedjen e metodave/aktiviteteve të konsultimit, alokimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare, si dhe vendosjen e treguesve të matshëm për monitorimin e suksesit të procesi i konsultimit);
- përmirësimi i komunikimit të përbajtjes së konsultimit publik përmes zhvillimit dhe publikimit të dokumentit të konsultimit për secilin akt të konsultuar, që përmban detajet e nevojshme logistike për kohën dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve të konsultimit, por edhe informacion mbi sfondin, qëllimin dhe çështjet kryesore të përfshira nga konsultimi publik;
- zhvillimi sistematik i raporteve individuale mbi konsultimet e kryera publike mbi projektaktet;
- përcaktimi i një metode më të përparuar të raportimit vjetor dhe gjashtë mujor, për konsultimet publike të zbatuara nga ministritë;
- sigurimi i kontrollit të qëndrueshëm qendror të konsultimeve të kryera, përmes zhvillimit të raportit gjithëpërfshirës gjashtë mujor të qeverisë qendrore për konsultimet publike në përputhje me treguesit kryesorë të performancës;
- përmirësimi i koherencës ndërmjet mekanizmave dhe platformave të ndryshme të konsultimit të brendshëm dhe të jashtëm (IPSiS, Registri Elektronik për Njoftim dhe Konsultimet Publike, organe dhe grupe konsultative ndër-sektoriale, etj.) duke kontribuar në krijimin e një qasjeje të integruar për menaxhimin e konsultimeve publike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË TË KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMIT ME LEGJISLACIONIN VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Ky projektakt është hartuar në mbështetje të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË QASJES ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR AKTET NORMATIVE)

Procesi i pranimit në BE, i Republikës së Shqipërisë nënkuption miratimin e standardeve evropiane dhe mbrojtjen e vlerave evropiane në legjislacionin kombëtar të secilit shtet anëtar, i cili konsiderohet si procesi i evropianizimit. Ndër përparësitë e këtij procesi është reforma e

administratës publike ku konsultimet publike janë përbërës i rëndësishëm i politikës përfshirëse dhe të bazuar në prova dhe zhvillimit legjislativ, siç përcaktohet në parimet e administratës publike për vendet kandidate për BE dhe vendet kandidate potenciale miratuar nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me SIGMA². Për më tepër, kriteret politike në lidhje me përfshirjen e shoqërisë civile kërkojnë reagime më efektive për rezultatet e konsultimeve publike dhe raportimit se si janë marrë parasysh kontributet nga organizatat e shoqërisë civile. Standartet dhe parimet e përgjithshme të konsultimeve publike të promovuara në këto udhëzime janë kryesisht në përputhje me Parimet e Përgjithshme të Komisionit Evropian dhe Standartet Minimale për Konsultimin e Palëve të Interesuara.

Sidoqoftë, nuk ka një kornizë rregullatore, *acquis*, në BE për reformën e administratës publike ose konsultimet publike, prandaj ky draft nuk synon të transpozojë ose harmonizojë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË AKTIT

Urdhri përbëhet nga tre pikë që prezantojnë përgjegjësitë specifike të ministritve të linjës dhe Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në vënien në zbatim të udhëzuesit për konsultimet publike, në bashkëpunim me Departamentin Rregulator dhe të Përputhshmërisë, si dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në pikën e parë, projekturdhri përcakton miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij projekturdhri.

Në pikën e dytë, përcaktohen ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit, si institucione të ngarkuara për zbatimin e këtij udhëzuesi në kryerjen e konsultimit publik mbi projektligjet dhe projektet e dokumenteve strategjike.

Në pikën e tretë përcaktohet Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje në bashkëpunim me Departamentin Rregulator dhe të Përputhshmërisë si përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të udhëzuesit, për të siguruar qasje të harmonizuar në të gjitha fazat e procesit të konsultimit publik, në përputhje me procedurat dhe afatet kohore të përcaktuara në udhëzues.

Udhëzuesi i propozuar për miratim nëpërmjet këtij projekturdhri përmban trembëdhjetë kapituj.

Pas hyrjes që ofron informacion të përgjithshëm në lidhje me kuadrin dhe qëllimin e udhëzuesit, kapitulli i dytë përpunon shtyllat kryesore dhe parimet e konsultimeve publike të cilat duhet të futen në kulturën e punës së administratës publike.

Kapitulli i tretë merret me organizimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike, duke përpunuar përgjegjësitë e ministritve dhe institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit, lidhur me procedurat për mbikëqyrje dhe mbështetje, mekanizmat dhe koordinimin për procesin e konsultimit publik, si dhe hapat kryesorë në procesin e konsultimit publik.

²<http://www.sigmapublicadministration.eu/candidate-countries-and-potential-candidates.htm>

Kapitulli i katërt i kushtohet përgatitjes së planit vjetor të konsultimeve publike nga se cilii institucion, me theks në shpjegimin e qëllimit dhe rëndësisë së planifikimit vjetor të konsultimeve publike, procesin e hartimit të Planit Vjetor, si dhe kriteret për përfshirjen e akteve në Planin Vjetor.

Kapitulli i pestë “Plani i konsultimit individual për projektaktet” shpjegon planin e konsultimit: për se cilin akt: përcaktimi i afatit kohor, identifikimi i palëve kryesore të interesit, zgjedhja e metodave, sigurimi i burimeve të nevojshme, identifikimi i mënyrës së mbledhjes së përgjigjeve, parashikimi i monitorimit dhe vlerësimit.

Kapitulli i gjashtë “Përgatitja e një dokumenti konsultimi” shtjellon një pjesë shumë thelbësore të komunikimit të përbajtjes së konsultimeve publike me palët e interesuara dhe më gjerë me publikun, përmes një të ashtuquajturi “dokument konsultimi” i cili pritet të publikohet në Regjistrin Elektronik së bashku me projektaktin, shënimin shpjegues dhe, kur është e zbatueshme, raportin e VNR-së.

Kapitulli i shtatë përqendrohet në fillimin e konsultimeve dhe mënyrave të informimit të publikut të gjerë mbi konsultimet e hapura, duke përdorur Regjistrin Elektronik dhe mjete të tjera të komunikimit.

Kapitulli i tetë sqaron qasjen për mbledhjen dhe analizimin e komenteve dhe rekomandimeve, me theks në grupimin e komenteve sipas çështjeve të ngritura dhe/ose pyetjeve të vendosura në dokumentin konsultativ.

Kapitulli i nëntë sjell detaje në lidhje me raportimin mbi rezultatet e konsultimeve publike mbi projektaktet, dhe posaçërisht në lidhje me procesin e përgatitjes së raportit individual të konsultimit publik për se cilin projekt akt të konsultuar.

Kapitulli i dhjetë trajton vlerësimin e procesit të konsultimit publik, duke përfshirë vlerësimin e brendshëm ose vetëvlerësimin që do të kryhet në fund të procesit, në lidhje me treguesit themelorë të suksesit të procesit të konsultimit publik të përcaktuar në planin e konsultimit për se cilin akt.

Kapitulli i njëmbëdhjetë shpjegon procesin e përgatitjes së raporteve (gjysmë) vjetore të ministrive dhe institacioneve qendrore, në varësi të Kryeministrat përkonsultimet dhe përcakton strukturën e një raporti të tillë.

Kapitulli i fundit adreson përgatitjen e raportit gjashtë mujor të performancës, gjithëpërfshirës të qeverisë qendrore mbi konsultimet publike, me theks të veçantë në strukturën e raportit dhe treguesve kryesorë të performancës për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik.

Shtojcat e udhëzuesit sigurojnë modele dhe udhëzime më të hollësishme për hapat thelbësore në procesin e konsultimit publik, përfshirë një pasaportë të detauar të treguesve me udhëzime metodologjike për monitorimin e progresit në zbatimin e standardeve të procesit të konsultimit publik.

VII. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministrinë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit ngarkohen me zbatimin e këtij projektakti.

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë në Kryeministri janë përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të udhëzuesit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANE KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje (DZHM) në Kryeministri mori mbështetjen e ekspertëve të SIGMA-s dhe projektit të asistencës teknike të BE-së "Përmirësimi i Kornizës Rregullatore dhe Konsultimeve Publike". Në përgjithësi 159 pjesëmarrës morën pjesë në draftimin/pilotimin dhe konsolidimin e këtij udhëzuesi përmes seksioneve të përbashkëta pune dhe takimeve të dedikuara lidhur me udhëzuesin për konsultimet publike, të cilat u mbajtën nga viti 2019 nga asistenca e Sigmës dhe nga shkurti deri në nëntor 2020 përmes asistencës së BE-së, siç specifikohet në pjesën hyrëse.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Ky projekturdhër nuk ka kosto financiare për buxhetin e shtetit. Procedura që kërkon të ndiqet do të adresohet tek të gjithë aktorët në Kryeministri (Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë) si dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e saj.